Dr. Florenca Stafa

# LIBËR MËSUESI
# HISTORIA

# 5

Shtëpia botuese & Shtypshkronja FILARA
Tiranë, 2019

**2019**

**BOTIME SHKOLLORE**

**Titulli i librit:**
LIBËR MËSUESI HISTORIA 5

**Autor:**
Dr. Florenca Stafa

**Korrektor:**
Lavdie Bakiu

**Arti grafik:**
Studio grafike **FILARA**
**Punoi:**
Gazmir Myteberi

**ISBN:** 978-9928-179-32-3

**Botimi i parë FILARA**
Tiranë, 2019

© Shtëpia botuese **"FILARA"**

---

Shtypur në shtypshkronjën **"FILARA"**

**Adresa:**
Rruga "Sabaudin Gabrani"
Ish - kombinati "Misto Mame",
Tiranë

Cel: 069 33 30 983
Cel: 069 66 99 693
E-mail: filarabotime@yahoo.com
filarabotime@gmail.com
website: www.filarabotime.com

Librin e mësuesit dhe planin mësimor mund
t'i shkarkoni në formatin Word, PDF,
falas nga faqja jonë e internetit
www.filarabotime.com

LIBËR MËSUESI HISTORIA 5

# PËRMBAJTJA


NË VEND TË HYRJES ..... 5

PLANI SINTETIK ..... 7

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE ..... 8

KOHA MËSIMORE PËR ÇDO TEMATIKË ..... 12

PLANI VJETOR ..... 14

PLANIFIKIMI I PERIUDHËS SË PARË (SHTATOR-DHJETOR) ..... 22

PLANIFIKIMI I PERIUDHËS SË DYTË (JANAR-MARS) ..... 26

PLANIFIKIMI I PERIUDHËS SË TRETË (PRILL-QERSHOR) ..... 29

**PLANIFIKIMI MËSIMOR DITOR SIPAS TEMATIKAVE TË PROGRAMIT**

**TEMATIKA 1: Historia dhe burimet e saj**

**1.** Historia dhe historiani ndihmojnë të kuptojmë të shkuarën ..... 32

**2.** Burimet historike kanë rëndësi për të njohur të shkuarën ..... 33

**3.** Llojet e burimeve historike dhe historia gojore ..... 35

**4.** Rëndësia e hartës historke ..... 37

**5.** Periudhat historike dhe kronologjia ..... 38

**6.** Linja dhe llogaritja e kohës ..... 39

**Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 1 Tema**: Historia ime ..... 41

**Projekt kërkimor i sugjeruar. Ora e parë**. **Tema:** Zgjedhim temën e projektit ..... 42

**TEMATIKA 2: Shoqëritë e para njerëzore**

**1.** Njerëzit e parë ..... 43

**2.** Jeta e komuniteteve të para njerëzore në paleolit dhe mezolit ..... 45

**3.** Jeta e komuniteteve njerëzore në neolit ..... 47

**4.** Tipare të jetës së shoqërisë njerëzore nga koha e gurit në kohën e metaleve ..... 49

**5.** Tipare të jetës së paraardhësve të shqiptarëve në parahistori ..... 51

**6.** Shpikje të rëndësishme të njerëzve në parahistori ..... 53

**7.** Roli i gruas në parahistori ..... 55

**8.** Gjuha, arti, besimi dhe kultura në komunitetet e para njerëzore 57

**Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 2**

**Tema**: Fotomontazh për zhvillimin e banesave dhe veshjeve nga parahistoria deri sot 59

**Projekt kërkimor i sugjeruar. Ora e dytë (Shqyrtimi i materialeve të gjetura)**

**Tema:** Familja nga antikiteti deri sot 61

**TEMATIKA 3: Qytetërimet antike, themeli i kulturës europiane**

**1.** Koha dhe vendet ku lindën qytetërimet antike 62

**2.** Tipare të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të qytetërimeve antike 64

**3.** Ilirët dhe fqinjët e tyre 66

**4.** Kultura ilire 68

**5.** Trashëgimia e qytetërimeve antike 70

**6.** Arritjet e qytetërimeve antike në shkencë 72

**7.** Figura historike të qytetërimeve antike 74

**Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 3**

**Tema**: Lindja dhe përdorimi i kalendarit 76

**Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 4**

**Tema**: Qytetërimi Ilir 77

**Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 5**

**Tema**: Qyteterimet antike boterore 78

**Projekt kërkimor. Ora e tretë. Paraqitja e rezultateve për temën:** Familja nga antikiteti deri sot 79

**VLERËSIM PORTOFOLI (PERIUDHA E PARË, E DYTË DHE E TRETË)** 80

**KRITERET E VLERËSIMIT TË PORTOFOLIT** 81

**MODEL I PUNËS ME PROJEKT (PERIUDHA E PARË, E DYTË DHE E TRETË)** 83

**TEST NR.1 - PERIUDHA E PARË (SHTATOR - DHJETOR)** 86

**TEST NR.2 - PERIUDHA E DYTË (JANAR-MARS)** 90

**TEST NR.3 - PERIUDHA E TRETË (PRILL-QERSHOR)** 94

**ÇELËSI I PËRGJIGJEVE TË TESTEVE** 100

***NË VEND TË HYRJES***

***E/i dashur mësuese/mësues,***

Metodologjia e *librit të mësuesit HISTORI 5* është vënia e nxënësit në qendër të të nxënit me nevojat dhe kërkesat e tij të moshës.

Lënda e historisë në arsimin bazë fillon në shkallën e dytë të kurrikulës, përkatësisht në klasën e katërt dhe të pestë të arsimit fillor. Ajo zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë secila.

Programi i historisë, gjatë shkallës së dytë, ngjall imagjinatën, nxit kureshtjen e nxënësve dhe zhvillon identitetin e tyre përmes kuptimit të historisë në nivel personal, lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Nëpërmjet studimit të historisë dhe njohjes së ngjarjeve në të kaluarën, nxënësit kuptojnë dilemat, zgjedhjet dhe besimet e njerëzve në të shkuarën dhe sot, si dhe janë të aftë të pyesin dhe të përgjigjen për të tashmen, duke e lidhur atë me të shkuarën. Nxënësit aftësohen të kërkojnë, të vlerësojnë, të përdorin burimet, të identifikojnë interpretime të ndryshme për të shkuarën dhe të mësojnë që gjykimet e tyre të jenë të bazuara në burime e argumente. Ata vlerësojnë çfarë kanë mësuar, pse e kanë mësuar dhe mund të debatojnë për rëndësinë e saj.

Nxënësve u jepet mundësia të formojnë vetë modele dhe shprehi sipas përvojës së tyre, duke bërë përpjekje që të shmangen ngarkesat e panevojshme dhe të papërshtatshme për moshën.

Në librin e mësuesit trajtohen modele të organizimit të orës së mësimit, projekteve, veprimtarive praktike, vlerësimit të portofolit, por çdo mësues është i lirë të zgjedhë modelin e saj/tij të organizimit të orës, në varësi të temës mësimore.

Gjithashtu, për t’i ardhur ne ndihmë secilit mësues, në fund të librit të mësuesit, ju do të gjeni modele të testeve që do të zhvilloni me nxënësit sipas periudhave I, II, III. Krahas kësaj, do të keni një model të vlerësimit të portofolit të nxënësit, të cilën mund ta përdorni për secilën periudhë I, II, III, si dhe një model të hapave të hartimit të një ore pune me projekt.

Duke qenë se reformat kanë rritur kërkesat ndaj mësimdhënësve dhe të gjithë ne, të dashur kolegë, jemi vazhdimisht nën trysninë e kërkesave të shoqërisë, mendojmë se ky libër do të shërbejë për zhvillimin e kompetencave personale, qytetare, digjitale, të komunikimit dhe të shprehurit të nxënësve dhe për ndërtimin e punës sonë të përditshme, duke realizuar lidhjen e ***historisë*** me fushat e tjera.

Punë të mbarë, kolegë!

Autorja

**VITI SHKOLLOR:**

**MËSUES:**__________________________________________

**SHKOLLA:** __________________________________________

**APROVOI/ DREJTOR:**________________________________

**FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI**

**LËNDA: HISTORIA V**

**SHKALLA: II**

**VITI SHKOLLOR:**

**PLANI SINTETIK**

**NJOHURI TË REJA:____________________________ 21 ORË**

**VEPRIMTARI PRAKTIKE:________________________5 ORË**

**PROJEKT: ___________________________________ 3 ORË**

**TEST: ________________________________________ 3 ORË**

**VLERËSIM PORTOFOLI:_________________________ 3 ORË**

**TOTAL:_______________________________________ 35 ORË**

**Shënim:** Në tekstin e nxënësit janë zhvilluar ***7 orë veprimtari praktike të sugjeruara***.
Ju do të zhvilloni ***5 orë*** duke zgjedhur ato veprimtari praktike që keni mundësi të zhvilloni sipas kushteve konkrete të shkollës.

***REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE:***

**1. KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE E TË SHPREHURIT**

· Zhvillon te nxënesit kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, koncpetet dhe idetë;

· Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekese për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.

**2. KOMPETENCA E TË MENDUARIT**

· Zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik;
· Zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime dhe për të saktësuar vërtetësinë e burimeve;
· Zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja, të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskutueshme;
· Analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimet;
· Ndërton dhe interpreton grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike.
· Përdor numrat negativë dhe pozitivë për llogaritjen e kohës.

**3. KOMPETENCA E TË NXËNIT**

· Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;
· Parshtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime;
· Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim/aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
· Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike;
· Vlerëson pikëpamjet e ndryshme dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori;
· Identifikon përparësitë dhe mangësitë e tij në lidhje me zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit të tyre.

**4. KOMPETENCA PËR JETËN, SIPËRMARRJEN DHE MJEDISIN**

· Harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë;
· Zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori;
· Diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e së tashmes dhe prespektivat e së ardhmes.
· Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik, etj) për realizimin e një veprimtarie të përbashkët.

**5. KOMPETENCA PERSONALE**

· Kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak- pasojë, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.

· Përdor aftësitë e komunikimit, të punës në grup, etj duke prezantuar idetë e tij.

**6. KOMPETENCA DIXHITALE**

· Zhvillon kompetenca dixhitale për të gjetur, për të analizuar, për të komunikuar informacionin historik;

· Akseson një sërë burimesh dixhitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;

· Komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë;

· Bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar njohuritë historike.

**7. KOMPETENCA QYTETARE**

· Zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën, që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe i standarteve të ndryshme;

· Shqyrton burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme dhe shpjegon natyrën, shkaqet dhe pasojat e konflikteve dhe nënvarësinë kulturore;

· Kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme;

· Identifikon dallimet dhe ngjashmërinë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tija;

· Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështje njerëzore.

· Zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme;

· Kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të të tjerëve;

· Shpjegon origjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë materiale dhe shpirtërore;

· Shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

***REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË LËNDËS/FUSHËS***

**1. KËRKIMI HISTORIK**

· Identifikon dhe shqyrton, individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike historike ose çështje, duke bërë testimin e hipotezave;

· Reflekton në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike.

**2. PËRDORIMI I BURIMEVE**

· Shpjegon tipat e burimeve historike, si një domosdoshmëri në punën e historianit;

· Kërkon, duke vlerësuar burimet alternative, për ndërtimin e ngjarjes historike;

· Identifikon, zgjedh dhe përdor një sërë burimesh historike, duke përfshirë burime tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik;

· Vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike;

· Vlerëson historinë gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore e ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e nxënësve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në "historinë e shkuar".

**3. INTERPRETIMI HISTORIK**

· Kupton pse historianët dhe të tjerët i kanë interpretuar ngjarjet, njerëzit dhe situatat në mënyra të ndryshme nëpërmjet një sërë mediash;

· Shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme;

· Shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre.

**4. ANALIZA SHKAK- PASOJË**

· Analizon ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë;

· Shpjegon pasojat në përfundim të ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike.

**5. SHPJEGIMI DHE KOMUNIKIMI**

· Praqet shpjegime rreth së kaluarës që janë koherente, të strukturuara dhe të arsyetuara, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik;

· Komunikon njohuritë historike në mënyra të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik.

***<u>REZULTATET E TË NXËNIT TË KONCEPTEVE HISTORIKE</u>***

**1. KUPTIMI KRONOLOGJIK**

Kuptimi kronologjik është thelbësor në ndërtimin dhe në shpjegimin e ngjarjeve historike, ç`ka përfshin përdorimin e saktë të datave për të krijuar vijimësinë e ngjarjeve në një shqyrtim, duke përdorur termat dhe fjalorin e saktë kronologjik, si dhe duke ditur emrat dhe karakteristikat kryesore të periudhave të studiuara. Nxënësit duhet të identifikojnë ndryshimet brenda dhe gjatë periudhave, duke bërë lidhjet midis tyre.

**2. NDRYSHIMI DHE VAZHDIMËSIA**

Kuptimi i ndryshimit dhe i vazhdimësisë është i lidhur ngushtë me identifikimin dhe shpjegimin e ndryshimit, e vazhdimësisë brenda dhe përgjatë periudhave historike, si dhe me kuptimin e temave dhe çështjeve gjithëpërfshirëse të periudhave historike.

**3. SHUMËLLOJSHMËRIA KULTURORE, ETNIKE DHE FETARE**

Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare ka të bëjë me të kuptuarin e përvojave, ideve, besimit dhe vlerave të ndryshme të njerëzve dhe të shoqërive në të shkuarën dhe se si të gjitha këto kanë formësuar botën.

Nxënësit duhet të njihen me shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare të shoqërive të ndryshme. Shumëllojshmëria ekziston brenda dhe ndërmjet grupeve për shkak të dallimeve kulturore, etnike, rajonale, gjuhësore, sociale, ekonomike, teknologjike, politike dhe fetare. Njohja e kulturave duhet të arrihet nëpërmjet studimit të individëve dhe të grupeve të ndryshme shoqërore, si p.sh.: njohjes të pakicave kombëtare, të shoqërive evropiane dhe atyre joevropiane.

**4. RËNDËSIA**

Rëndësia ka të bëjë me konsiderimin dhe me vlerësimin e një ngjarjeje historike. Ajo vlerëson pse gjykimet në lidhje me rëndësinë e ngjarjeve historike, çështjeve dhe njerëzve kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Gjithashtu, ajo merr parasysh identifikimin e kritereve të përdorura për vlerësimin e rëndësisë së një çështje, ngjarjeje apo personazhi historik, si dhe vlerëson se si këto kritere dhe vlera janë përdorur në përshkrimet e së shkuarës dhe shpjegimin e së tashmes. Deklaratat rreth rëndësisë janë interpretime që mund të bazohen në vendime të kontestueshme rreth ngjarjeve, çështjeve dhe figurave historike, ato shpesh janë të lidhura me sistemet e vlerave të periudhës, në të cilën është shkruar interpretimi.

## KOHA MËSIMORE PËR ÇDO TEMATIKË

| Nr | Periudha I- 13 orë<br>SHTATOR-DHJETOR | | Periudha II- 11 orë<br>JANAR-MARS | | Periudha III- 11 orë<br>PRILL-QERSHOR |
|---|---|---|---|---|---|
| | **9 orë Njohuri të reja<br>1 orë Veprimtari praktike<br>1 orë Projekt<br>1 orë Test<br>1 orë Vlerësim portofoli** | | **7 orë Njohuri të reja<br>1 orë Veprimtari praktike<br>1 orë Projekt<br>1 orë Test<br>1 orë Vlerësim portofoli** | | **5 orë Njohuri të reja<br>3 orë Veprimtari praktike<br>1 orë Projekt<br>1 orë Test<br>1 orë Vlerësim portofoli** |
| **TEMATIKA1: HISTORIA DHE BURIMET E SAJ** | | | | | |
| **1** | Historia dhe historiani ndihmojnë të kuptojmë të shkuarën | **14** | Tipare të jetës së shoqërisë njerëzore nga koha e gurit në kohën e metaleve | **25** | Ilirët dhe fqinjët e tyre |
| **2** | Burimet historike kanë rëndësi për të njohur të shkuarën | **15** | Tipare të jetës së paraardhësve të shqiptarëve në parahistori | **26** | Kultura ilire |
| **3** | Llojet e burimeve historike dhe historia gojore | **16** | Shpikje të rëndësishme të njerëzve në parahistori | **27** | Trashëgimia e qytetërimeve antike |
| **4** | Rëndësia e hartës historike | **17** | Roli i gruas në parahistori | **28** | Arritjet e qytetërimeve antike në shkencë |
| **5** | Periudhat historike dhe kronologjia | **18** | Gjuha, arti, besimi dhe kultura në komunitetet e para njerëzore | **29** | Figura historike të qytetërimeve antike |
| **6** | Linja dhe llogaritja e kohës | **19** | **Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 2**<br>**Tema:** Fotomontazh për zhvillimin e banesave dhe veshjeve nga parahistoria deri sot | **30** | **Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 3.**<br>**Tema:** Lindja dhe përdorimi i kalendarit |
| **7** | **Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 1**<br>**Tema:** Historia ime | **20** | **Projekt kërkimor i sugjeruar. Ora 2**<br>**Tema:** Familja nga antikiteti deri sot | **31** | **Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 4.**<br>**Tema:** Qytetërimi Ilir |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **8** | **Projekt kërkimor i sugjeruar. Ora 1**<br>**Tema:** Zgjedhim temën e projektit | **21** | **Test nr. 2 Periudha e dytë** | **32** | **Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 5**<br>**Tema:** Qytetërimet antike botërore |
| **9** | **Test nr. 1 Periudha e parë** | | **TEMATIKA 3 QYTETËRIMET ANTIKE, THEMELI I KULTURËS EUROPIANE** | **33** | **Test nr. 3 Periudha e tretë** |
| | | **22** | Koha dhe vendet ku lindën qytetërimet antike | | |
| **TEMATIKA 2: SHOQËRITË E PARA NJERËZORE** | | **23** | Tipare të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të qytetërimeve antike | **34** | **Projekt kërkimor i sugjeruar Ora 3** (Paraqitja e rezultateve)<br>**Tema:** Familja nga antikiteti deri sot |
| **10** | Njerëzit e parë | | | | |
| **11** | Jeta e komuniteteve të para njerëzore në paleolit dhe mezolit | | | | |
| **12** | Jeta e komuniteteve njerëzore në neolit | **24** | ***Vlerësim portofoli* - Periudha e dytë** | **35** | ***Vlerësim portofoli* - Periudha e tretë** |
| **13** | ***Vlerësim portofoli*- Periudha e parë** | | | | |

| Nr. i orëve vjetore/ gjithsej | Orë sipas kohës mësim. | TEMA MËSIMORE | SITUATA E PARASHIKUAR E TË NXËNIT | METODOLOGJIA VEPRIMTARITË E NXËNËSVE | BURIME DHE MJETE MËSIMORE |
|---|---|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 1 HISTORIA DHE BURIMET E SAJ** | | | | | |
| 1 | 1 | **1. 1** Historia dhe historiani ndihmojnë të kuptojmë të shkuarën | **<u>Historiani.</u>** “Ata që shkruajnë për historinë quhen historianë. Historiani është një njeri që bën kërkime historike dhe shkruan për të kaluarën e njerëzimit. Ai shkruan, veçanërisht, për ato ngjarje apo figura historike, të cilat kanë sjellë ndryshime të mëdha në shoqëri’’. | Lexim i imët i tekstit, diskutim ditari dy pjesësh, punë e pavarur individuale. | Teksti mësimor, interneti, libra të ndryshëm historikë, ***Fletore pune vetëvlerësimi “Historia 5”*** etj. |
| 2 | 2 | **1.2** Burimet historike kanë rëndësi për të njohur të shkuarën | Historianët e ndërtojnë historinë e së shkuarës sipas burimeve historike. Të tilla janë: dokumentet e shkruara, ndërtimet, veprat e artit, enët prej qeramike, mjetet e punës e të jetesës, ditarët, revistat, dëftesat, fjalimet, intervistat, fotografitë, videot, të dhënat qeveritare, filmat, programet televizive, që i përkasin së kaluarës. Burimet bëhen prova historike vetëm kur me to merret historiani. | Hartë konceptesh, diskutim, pyetja sjell pyetjen | Teksti mësimor, interneti, ***Fletore pune vetëvlerësimi “Historia 5”*** etj. |
| 3 | 3 | **1.3** Llojet e burimeve historike dhe historia gojore | Burimet historike ndahen në dy lloje kryesore: burime parësore dhe burime dytësore. **Burim parësor** është një dokument apo një objekt fizik, që është shkruar ose është krijuar gjatë kohës që shqyrton historiani. **Burim dytësor** është një dokument apo një objekt fizik, që është shkruar dhe është krijuar duke u mbështetur në burime parësore apo origjinale. | Diskutim për çështjet paraprake, harta e konceptit, imagjinatë e drejtuar | Teksti mësimor, interneti, dokumente të ndryshme historike, ***Fletore pune vetëvlerësimi “Historia 5”*** etj. |
| 4 | 4 | **1.4** Rëndësia e hartës historike | **<u>Harta e Ilirisë.</u>** Në hartë tregohet ku shtrihej Iliria, emrat e fiseve ilire, vendet fqinje, lumenjtë, liqenet, detet dhe qytetet. Iliria paraqitet me ngjyrë jeshile për t’u dalluar nga vendet fqinje. Emrat e vendeve jepen ashtu si kanë qenë përdorur në periudhën historike, për të cilën harta është bërë. P.sh. në atë periudhë Durrësi quhej Dyrrah dhe jepet në hartë me këtë emër. | Përvijim i të menduarit, punë me hartën, diskutim. | Teksti mësimor, interneti, atlas historik, hartë mësimore, ***Fletore pune vetëvlerësimi “Historia 5”*** etj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **5** | **5** | **1.5** Periudhat historike dhe kronologjia | Lexojmë fragmentin:<br>Përcaktimi i kohës<br><br>Përcaktimi i kohës bazohet te ndarja që i kanë bërë historianët. Si viti bazë merret viti 0. Të gjitha ngjarjet historike që kanë ndodhur përpara kësaj date, te viti shënohet shkurtimisht p.e.s. P.sh. lindja e shkrimit shënohet 3500 vjet p.e.s. Ndërsa për ngjarjet që kanë ndodhur pas këtij viti shënohet thjesht data. Rënia e Perandorisë Romake ndodhi në vitin 476. | Di, Dua të di, Mësova më shumë | Teksti mësimor, interneti, libra të ndryshëm historikë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **6** | **6** | **1.6** Linja dhe llogaritja e kohës | Për të ndërtuar një histori të caktuar, duhen regjistruar datat dhe ngjarjet e saj të rëndësishme, sipas një radhë kronologjike. Ato mund të paraqiten në një linjë kohore, si kjo që shihni më poshtë.<br>Në të janë paraqitur sipas radhës kronologjike: periudhat historike të shoqërisë njerëzore; ngjarjet e rëndësishme që bëjnë dallimin nga njëra periudhë në tjetrën. | Hartë konceptesh, organizues grafik i informacionit, diskutim. | Teksti mësimor, interneti, libra të ndryshëm historikë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **7** | **1** | **1.7 Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 1**<br>**Tema**: Historia ime | Shohim në klasë një album fotografik, i cili përmban foto të periudhave të ndryshme të jetës së një individi, të një familjeje etj.<br>Çfarë vëmë re? | Punë individuale, punë në dyshe, turi i galerisë | Fotografi, certifikata lindjeje të siguruara nga Gjendja Civile ose të printura online |
| **8** | **1** | **1.8 Projekt kërkimor i sugjeruar - ora e parë**<br>**Tema**: **Zgjedhim temën e projektit:** Familja nga antikiteti deri sot | Familja është e rëndësishme për shoqërinë. Sa më e mirë të jetë familja, aq më e mirë do të jetë edhe shoqëria. Trashëgimia kulturore e familjes është e rëndësishme për t'u njohur. Duke e njohur atë, mund të ndërtojmë marrëdhënie të drejta në familje dhe kudo. Kjo ndihmon mirërritjen dhe shoqërinë ku jetojmë. | Bashkëbisedim, punë e pavarur individuale, diskutim | ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5",*** teksti, burime historike, histori personale |
| **9** | **1** | **1.9 Test me shkrim Periudha e parë Tematika 1**<br>Historia dhe burimet e saj | Keni vështirësi në përgjigjen e pyetjeve të testit që do t'ju zhvillojë mësuesja/mësuesi?<br>Punoni vetë testin e dhënë në tekstin mësimor, Historia 5. Vlerësojeni veten para se t'ju vlerësojë mësuesi. | | Teksti, Historia 5 |

| TEMATIKA 2: SHOQËRITË E PARA NJERËZORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **10** | **7** | **2.1** Njerëzit e parë | Njerëzit e parë u shfaqën në kontinentin e Afrikës. Si lindën dhe u zhvilluan njerëzit e parë? Si jetonin dhe silleshin ata? Çfarë tipesh njerëzore krijuan ata? Në cilat kontinente u vendosën ata? A kemi ne sot ngjashmëri me njerëzit e parë? Tregoni dallimet midis tyre. | Ndërtimi i shprehive mësimore, nxitja e diskutimit të ideve, nxitja e veprimtarisë krijuese | Teksti mësimor, interneti, atlas mësimor, hartë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **11** | **8** | **2.2** Jeta e komuniteteve të para njerëzore në paleolit dhe mezolit | Epoka e paleolitit, mezolitit dhe neolitit, epokat kur nuk ishte shpikur shkrimi përbëjnë parahistorinë. Për t'u njohur me jetën e njerëzve të kësaj kohe, ne bazohemi te kërkimet arkeologjike. Si vazhdon jeta në periudhën e paleolitit dhe të neolitit? Me çfarë aktivitetesh merrej njeriu? Si jetonin komunitetet e njerëzve të parë? | Diskutim për njohuritë paraprake, shënime mbi shënime, diagrama piramidale | Teksti mësimor, interneti, album me foto, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **12** | **9** | **2.3** Jeta e komuniteteve njerëzore në neolit | Një nxënës lexon rubrikën: Periudha e akullnajave mori fund rreth 10 000 vjet më parë. Klima filloi të ngrohej. Në këto kushte, komunitete të caktuara të njerëzve mësuan të kultivonin bimët dhe të zbusnin kafshët. Komunitetet ishin vendosur në Azi, Amerikën e Jugut, Europë, rreth Gjysmëhënës Pjellore, zonës pranë lumenjve Tigër dhe Eufrat, që përfshin vendet e sotme të Irakut, Sirisë dhe Egjiptin pranë lumit Nil, që sot quhet Lindja e Afërt. | Diskutimi i ideve, punë në grupe, nxitja e veprimtarisë krijuese | Teksti mësimor, interneti, hartë mësimore, atlas, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **13-Fund PI** | **1** | **2.4 Vlerësim portofoli - Periudha e parë** | Mësuesit bëjnë vlerësimin e punimeve të nxënësve, pjesë e ***"Portofoli i të nxënit, Historia 5"*** | Vlerësim sipas kritereve të dhëna nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA. | ***"Portofoli i të nxënit, Historia 5"*** |
| **14 Fillon PII** | **1** | **2.5** Tipare të jetës së shoqërisë njerëzore nga koha e gurit në kohën e metaleve | Nxënësit lexojnë në klasë rubrikën:"Gjatë përdorimit të zjarrit njerëzit zbuluan mineralet. Ata vunë re se gurë të veçantë, në vendin ku ndiznin zjarrin, bëheshin të lëngshëm. Kur zjarri shuhej, gurët ishin bërë prapë të fortë. Ata panë se lëngu i shkrirë, kur ftohej, merrte formën e enës ku hidhej. Kështu mësuan se, në temperatura të larta, gurëve të veçantë mund t'u jepnin formën që dëshironin". | Diskutimi i ideve, Të lexuarit ndërveprues Nxitja e veprimtarisë krijuese | Teksti mësimor, interneti, literaturë nga biblioteka e shkollës, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **15** | **2** | **2.6** Tipare të jetës së paraardhësve të shqiptarëve në parahistori | Historia e shqiptarëve është ndër më të vjetrat midis popujve të tjerë. Një gjë të tillë e dëshmojnë gjetjet e vendbanimeve të paleolitit dhe neolitit përgjatë territorit të vendit tonë. Ku i ndeshim këto vendbanime. Ç'janë vendbanimet shpellore? Po ato palafite? Tregoni disa veprimtari të komuniteteve të kësaj periudhe? | Parashikimi: Përgatitja për të nxënë Diskutimi i ideve | Teksti mësimor, interneti, atlas mësimor, hartë mësimore, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **16** | **3** | **2.7** Shpikje të rëndësishme të njerëzve në parahistori | "Zjarri u ndryshoi jetën njerëzve. Pjekja e mishit bëri që trupi i njeriut të zhvillohej nga ana fizike dhe mendore. Duke qëndruar rreth zjarrit, hanin, çlodheshin, krijonin mjete, pastronin lëkurët për t'i veshur dhe për t'u mbrojtur nga të ftohtët." | Hartë mendimesh, punë në çift, plotësim harte, shpjegim termash dhe konceptesh, tabelë konceptesh, diskutim. | Teksti mësimor, interneti, album arkeologjik, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **17** | **4** | **2.8** Roli i gruas në parahistori | Nuk ka ndarje të prerë të punës, që këtë punë e bën vetëm burri dhe atë punë e bën vetëm gruaja. Ka ndarje të punës midis njerëzve, por jo midis njerëzve me gjini të ndryshme. Kur është e nevojshme, ata edhe **"**zihen**"** se kush do të bëjë këtë apo atë punë. | Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore. | Teksti mësimor, album arkeologjik, interneti, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** |
| **18** | 5 | **2.9** Gjuha, arti, besimi dhe kultura në komunitetet e para njerëzore | Kultura përmbledh të gjitha mjetet dhe modelet e sjelljes së një shoqërie (banesa, vegla, armë, zbukurime dhe mënyra se si punojnë, çfarë besojnë, si e kanë zhvilluar artin, shkencën etj.) të krijuara në një vend e kohë të caktuar. Ajo trashëgohet nga njëri brez në tjetrin. | Hartë konceptesh, punë në çift, vrojtim i pavarur i fotove të temës mësimore | Teksti mësimor, album arkeologjik, interneti, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **19** | 1 | **2.10 Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 2. Tema:** Fotomontazh për zhvillimin e banesave dhe veshjeve nga parahistoria deri sot | Shtëpitë tona kanë ndryshuar në vazhdimësi. Ne, shpesh, bëjmë ndryshime në mjediset tona për t'i bërë ato sa më të rehatshme e funksionale. Ju ka ndodhur që të ndryshoni pamjen e shtëpisë suaj apo të vendoseni në një banesë tjetër? Përse? | Diskutim, punë në grupe, prezantim | Letër, lapsa me ngjyra, ngjitës, kompjuter, videoprojektor etj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **20** | **1** | **2.11 Projekt kërkimor i sugjeruar. Ora e dytë. Shqyrtimi i materialeve të gjetura**<br>**Tema:** Familja nga antikiteti deri sot | Shohim një album fotosh ose librin e fëmijërisë së një shoqeje/ shoku të klasës. Diskutojmë si ka evoluar familja. | Diskutim, punë në grupe, sugjerime | Teksti mësimor, burime historike, histori personale, enciklopedi për fëmijë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **21** | **1** | **2.12 Test me shkrim Periudha e dytë Tematika 2.** Shoqëritë e para njerëzore | Keni vështirësi në përgjigjen e pyetjeve të testit që do t'ju zhvillojë mësuesja/mësuesi?<br>Punoni vetë testin e dhënë në tekstin mësimor, Historia 5. Vlerësojeni veten para se t'ju vlerësojë mësuesi. | | ***Teksti, Historia 5*** |
| **TEMATIKA 3 QYTETËRIMET ANTIKE, THEMELI I KULTURËS EUROPIANE** | | | | | |
| **22** | **6** | **3.1** Koha dhe vendet ku lindën qytetërimet antike | **Qytetërimi** është periudha në të cilën njerëzit kaluan nga organizimi fisnor në jetën qytetare: krijuan qytetet dhe shtetet e para, shkruajtën ligjet, filloi të shkruhej historia etj. | Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore, punë me hartë | Teksti mësimor, album arkeologjik, interneti, hartë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **23** | **7** | **3.2** Tipare të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të qytetërimeve antike | ***Sumerët e Babilonisë*** ishin ndoshta të parët që ndërtuan një kalendar. Ata përdorën fazat e hënës duke numëruar 12 muaj hënorë, të cilët përbënin një vit. Për të bërë diferencën midis vitit hënor dhe vitin e stinëve, ata shtuan një muaj tjetër në kalendar, çdo katër vjet.<br>Egjiptianë e hershëm, grekët dhe popujt semitikë kopjuan këtë kalendar. Më vonë egjiptianët përshtatën një kalendar që përkon pothuaj saktësisht me stinët. | Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore, punë me hartë | Harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **24 Fund PII** | **1** | **3.3 *Vlerësim portofoli Periudha e dytë*** | Mësuesit bëjnë vlerësimin e punimeve të nxënësve, pjesë e ***"Portofoli i të nxënit, Historia 5"*** | Vlerësim sipas kritereve të dhëna nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA. | ***"Portofoli i të nxënit, Historia 5"*** etj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **25**<br>**Fillon**<br>**P III** | **1** | **3.4** Ilirët dhe fqinjët e tyre | ... Stërgjyshi i fisit ilir ishte Kadmasi; gruaja e tij ishte Harmonia – themelues legjendar i Tebës, që në formën e gjarprit u shpërngul e shkoi më vonë në krahinën e fisit ilir të Enkelejve, në lindje të Bokës dhe Kotorrit. Djali i tyre është quajtur Ilirikos... *(shkëputur nga Leksikon fq. 692)* | Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore, punë me hartë | Harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **26** | **2** | **3.5** Kultura ilire | Dalmatika është një petk i gjatë e i gjerë, me rrip të vendosur në ije. Mbi këtë petk hidhej krahëve një copë si shall. Petku kapej në krahun e majtë, ndërkohë që krahu i djathë mbetej i pambuluar. | Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore, punë me hartë | Harta, teksti mësimor, internet, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **27** | **3** | **3.6** Trashëgimia e qytetërimeve antike | Shoqëritë e qytetërimeve antike kanë lënë një trashëgimi të pasur kulturore, që shërben për të kuptuar si është zhvilluar shoqëria njerëzore. | Punë në grupe, diskutim, shpjegim termash dhe konceptesh, tabelë konceptesh. | Harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **28** | **4** | **3.7** Arritjet e qytetërimeve antike në shkencë | Mendohet të ketë zbuluar parimin e dendësisë dhe pluskimit, i njohur si "Parimi i Arkimedit", që sipas gojëdhënës, e zbuloi ndërsa ai po lahej në vaskë (doli jashtë nëpër rrugë duke bërtitut "Eureka" (e gjeta). | Hartë konceptesh, shpjegim termash, diskutim, | Harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **29** | **5** | **3.8** Figura historike të qytetërimeve antike | Figurat historike të qytetërimeve antike janë të shumta. Ju do të mësoni disa prej tyre. | Shpjegim, tabela e koncepteve, lexim i drejtuar | Harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike dhe figurave historike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** |
| **30** | **1** | **3.9 Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 3** Lindja dhe përdorimi i kalendarit | Çdo familje sot e përdor kalendarin. Po edhe ju vetë e përdorni atë. Për çfarë ju ndihmon kalendari? | Brainstorming, punë në grupe, diagrama e Venit | Letër, lapsa me ngjyra, ngjitës, interneti, fjalorë |
| **31** | **1** | **3.10 Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 4** Qytetërimi ilir | Qytete ilire në territorin e sotëm të vendit tonë janë të shumtë. Të tillë janë: Bylisi, Amantia, Lisusi, Schodra, Theranda etj. Kërkoni të dhëna për një qytet ilir në internet, libra apo duke pyetur më të rriturit. Në se keni mundësi vizitojeni atë. Përshkruajeni me fjalët tuaja pamjen e një qyteti ilir. | Braistorming, punë në grupe, diskutim | Plastelinë, letër, lapsa me ngjyra, kompjuter, videoprojektor |
| **32** | **1** | **3.11 Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 5** Qytetërimet antike botërore | Nëse dikush do t'ju kërkonte t'i sugjeronit për të vizituar një qytetërim të vjetër, cilin do t'i sugjeronit dhe përse? | Parashikim me terma paraprake, punë në grupe, diagrami i Venit | Letër, teksti, fjalor enciklopedik |
| **33** | **1** | **3.12 Projekt kërkimor - ora e tretë. Paraqitja e rezultateve të projektit** Familja nga antikiteti deri sot | Nëse keni punuar një ese historike përshkruese, album, ekspozitë, raport, poster, PowerPoint etj., sigurohuni që të keni mjetet dhe mjedisin e nevojshëm për paraqitje cilësore të rezultateve të projektit. | Paraqitje individuale ose në grup | Letër me format të madh, kompjuter/ laptop, videoprojektor |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **34** | **1** | **3. 13 Test me shkrim**<br>**Periudha e tretë**<br>**Tematika 3**<br>Qytetërimet antike, themeli i kulturës europiane | Keni vështirësi në përgjigjen e pyetjeve të testit që do t'ju zhvillojë mësuesja/mësuesi?<br>Punoni vetë testin e dhënë në tekstin mësimor, Historia 5.<br>Vlerësojeni veten para se t'ju vlerësojë mësuesi. | | Teksti, Historia 5 |
| **35** | **1** | **3.14 Vlerësim portofoli**<br>**Periudha e tretë** | Mësuesit bëjnë vlerësimin e punimeve të nxënësve, pjesë e ***"Portofoli i të nxënit, Historia 5"*** | Vlerësim sipas kritereve të dhëna nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA. | "Portofoli i të nxënit, Historia 5" |

**PLANIFIKIMI I PERIUDHËS SË PARË**

**(SHTATOR-DHJETOR) 13 orë gjithsej**

**TEMATIKA 1. HISTORIA DHE BURIMET**

Kjo tematikë i aftëson nxënësit të demostrojnë njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime mbi rëndësinë e historisë dhe historianëve në ndërtimin dhe kuptimin e ngjarjeve të së shkuarës. Nxënësi vlerëson gamën e burimeve historike dhe të informacionit, si: dokumentet, burimet e shkruara, historinë gojore, mediat e ndryshme, pikturat, muzetë, galeritë, fotografitë, muzikën dhe internetin, si baza për studimin dhe përshkrimin e një ngjarjeje historike. Ata aftësohen të vlerësojnë kërkimin historik dhe burimet historike si pjesë themelore në punën e historianit.

**Nëpërmjet kësaj tematike, nxënësit mësojnë të punojnë si historianë, mësojnë organizimin kronologjik të historisë dhe kryejnë veprime për llogaritjen e kohës.**

| Nr. i orëve vjetore gjithsej | Nr. i orëve PI | TEMAT MËSIMORE | SITUATA E PARASHIKUAR E TË NXËNIT | METODOLOGJIA VEPRIMTARITË E NXËNËSVE | BURIMET DHE MJETET MËSIMORE |
|---|---|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 1 HISTORIA DHE BURIMET E SAJ** | | | | | |
| **1** | **1** | **1. 1** Historia dhe historiani ndihmojnë të kuptojmë të shkuarën | **Historiani**<br>“Ata që shkruajnë për historinë quhen historianë. Historiani është një njeri që bën kërkime historike dhe shkruan për të kaluarën e njerëzimit. Ai shkruan, veçanërisht, për ato ngjarje apo figura historike, të cilat kanë sjellë ndryshime të mëdha në shoqëri’’. | Lexim i imët i tekstit, diskutim ditari dy pjesësh, punë e pavarur individuale. | Teksti mësimor, interneti, libra të ndryshëm historikë, ***Fletore pune vetëvlerësimi “Historia 5”*** etj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **2** | **2** | **1.2** Burimet historike kanë rëndësi për të njohur të shkuarën | Historianët e ndërtojnë historinë e së shkuarës sipas burimeve historike. Të tilla janë: dokumentet e shkruara, ndërtimet, veprat e artit, enët prej qeramike, mjetet e punës e të jetesës, ditarët, revistat, dëftesat, fjalimet, intervistat, fotografitë, videot, të dhënat qeveritare, filmat, programet televizive, që i përkasin së kaluarës. Burimet bëhen prova historike vetëm kur me to merret historiani. | Hartë konceptesh, diskutim, pyetja sjell pyetjen | Teksti mësimor, interneti, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **3** | **3** | **1.3** Llojet e burimeve historike dhe historia gojore | Burimet historike ndahen në dy lloje kryesore: burime parësore dhe burime dytësore. Burim parësor është një dokument apo një objekt fizik, që është shkruar ose është krijuar gjatë kohës që shqyrton historiani. Burim dytësor është një dokument apo një objekt fizik, që është shkruar dhe është krijuar duke u mbështetur në burime parësore apo origjinale. | Diskutim për çështjet paraprake, harta e konceptit, imagjinatë e drejtuar | Teksti mësimor, interneti, dokumente të ndryshme historike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **4** | **4** | **1.4** Rëndësia e hartës historike | <u>**Harta e Ilirisë**</u><br>Në hartë tregohet ku shtrihej Iliria, emrat e fiseve ilire, vendet fqinje, lumenjtë, liqenet, detet dhe qytetet. Iliria paraqitet me ngjyrë jeshile për t'u dalluar nga vendet fqinje.<br>Emrat e vendeve jepen ashtu si kanë qenë përdorur në periudhën historike, për të cilën harta është bërë. P.sh. në atë periudhë Durrësi quhej Dyrrah dhe jepet në hartë me këtë emër. | Përvijim i të menduarit, punë me hartën, diskutim. | Teksti mësimor, interneti, atlas historik, hartë mësimore, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **5** | **5** | **1.5** Periudhat historike dhe kronologjia | Lexojmë fragmentin:<br><u>Përcaktimi i kohës</u><br>Përcaktimi i kohës bazohet te ndarja që i kanë bërë historianët. Si viti bazë merret viti 0. Të gjitha ngjarjet historike që kanë ndodhur përpara kësaj date, te viti shënohet shkurtimisht p.e.s. P.sh. lindja e shkrimit shënohet 3500 vjet p.e.s. Ndërsa për ngjarjet që kanë ndodhur pas këtij viti shënohet thjesht data. Rënia e Perandorisë Romake ndodhi në vitin 476. | Di, Dua të di, Mësova më shumë | Teksti mësimor, interneti, libra të ndryshëm historikë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **6** | **6** | **1.6** Linja dhe llogaritja e kohës | Për të ndërtuar një histori të caktuar, duhen regjistruar datat dhe ngjarjet e saj të rëndësishme, sipas një radhë kronologjike. Ato mund të paraqiten në një linjë kohore, si kjo që shihni më poshtë.<br>Në të janë paraqitur sipas radhës kronologjike: periudhat historike të shoqërisë njerëzore; ngjarjet e rëndësishme që bëjnë dallimin nga njëra periudhë në tjetrën. | Hartë konceptesh, organizues grafik i informacionit, diskutim. | Teksti mësimor, interneti, libra të ndryshëm historikë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **7** | **1** | **1.7 Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 1**<br>**Tema**: Historia ime | Shohim në klasë një album fotografik, i cili përmban foto të periudhave të ndryshme të jetës së një individi, të një familjeje etj.<br>Çfarë vëmë re? | Punë individuale, punë në dyshe, turi i galerisë | Fotografi, certifikata lindjeje të siguruara nga Gjendja Civile ose të printura online |
| **8** | **1** | **1.8 Projekt kërkimor i sugjeruar - ora e parë**<br>**Tema**: **Zgjedhim temën e projektit:** Familja nga antikiteti deri sot | Familja është e rëndësishme për shoqërinë. Sa më e mirë të jetë familja, aq më e mirë do të jetë edhe shoqëria. Trashëgimia kulturore e familjes është e rëndësishme për t'u njohur. Duke e njohur atë, mund të ndërtojmë marrëdhënie të drejta në familje dhe kudo. Kjo ndihmon mirërritjen dhe shoqërinë ku jetojmë. | Bashkëbisedim, punë e pavarur individuale, diskutim | ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5",*** teksti, burime historike, histori personale |
| **9** | **1** | **1.9 Test me shkrim Periudha e parë Tematika 1** Historia dhe burimet e saj | Keni vështirësi në përgjigjen e pyetjeve të testit që do t'ju zhvilloj mësuesja/mësuesi?<br>Punoni vet testin e dhënë në tekstin mësimor, Historia 5. Vetëvlerësojeni veten para se t'ju vlerësojë mësuesi. | | Teksti, Historia 5 |

| TEMATIKA 2: SHOQËRITË E PARA NJERËZORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **10** | **7** | **2.1** Njerëzit e parë | Njerëzit e parë u shfaqën në kontinentin e Afrikës. Si lindën dhe u zhvilluan njerëzit e parë? Si jetonin dhe silleshin ata? Çfarë tipesh njerëzore krijuan ata? Në cilat kontinente u vendosën ata? A kemi ne sot ngjashmëri me njerëzit e parë? Tregoni dallimet midis tyre. | Ndërtimi i shprehive mësimore, nxitja e diskutimit të ideve, nxitja e veprimtarisë krijuese | Teksti mësimor, interneti, atlas mësimor, hartë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **11** | **8** | **2.2** Jeta e komuniteteve të para njerëzore në paleolit dhe mezolit | Epoka e paleolitit, mezolitit dhe neolitit, epokat kur nuk ishte shpikur shkrimi përbëjnë parahistorinë. Për t'u njohur me jetën e njerëzve të kësaj kohe, ne bazohemi te kërkimet arkeologjike. Si vazhdon jeta në periudhën e paleolitit dhe të neolitit? Me çfarë aktivitetesh merrej njeriu? Si jetonin komunitetet e njerëzve të parë? | Diskutim për njohuritë paraprake, shënime mbi shënime, diagrama piramidale | Teksti mësimor, interneti, album me foto, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **12** | **9** | **2.3** Jeta e komuniteteve njerëzore në neolit | Një nxënës lexon rubrikën: Periudha e akullnajave mori fund rreth 10 000 vjet më parë. Klima filloi të ngrohej. Në këto kushte, komunitete të caktuara të njerëzve mësuan të kultivonin bimët dhe të zbusnin kafshët. Komunitetet ishin vendosur në Azi, Amerikën e Jugut, Europë, rreth Gjysmëhënës Pjellore, zonës pranë lumenjve Tigër dhe Eufrat, që përfshin vendet e sotme të Irakut, Sirisë dhe Egjiptin pranë lumit Nil, që sot quhet Lindja e Afërt. | Diskutimi i ideve, punë në grupe, nxitja e veprimtarisë krijuese | Teksti mësimor, interneti, hartë mësimore, atlas, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **13** | **1** | **2.4 Vlerësim portofoli Periudha e parë** | Mësuesit bëjnë vlerësimin e punimeve të nxënësve, pjesë e ***"Portofoli i të nxënit, Historia 5"*** | Vlerësim sipas kritereve të dhëna nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA. | ***"Portofoli i të nxënit, Historia 5"*** |

**PLANIFIKIMI I PERIUDHËS SË DYTË**

**(JANAR-MARS) 11 orë gjithsej**

**TEMATIKA 2. SHOQERITË E PARA NJERËZORE**

Kjo tematikë i aftëson nxënësit të demostrojnë njohuri, aftësi/ shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi qytetërimin botëror në parahistori, shoqërinë parahistorike dhe veprimtarinë e njeriut (homosapiens) mbi natyrën si një proces evolutiv. Tematika përshkruan kushtet e jetesës së njerëzve në periudhën e gurit, ndryshimet e këtyre kushteve si rezultat i shpikjes së bronzit dhe hekurit.

Nxënësit mësojnë për evolucionin e kulturave të para në territoret shqiptare, besimin dhe artet, fundin e parahistorisë dhe fillimin e historisë së qytetërimeve.

| Nr. i orëve vjetore | Nr. i orëve PII | TEMA MËSIMORE | SITUATA E PARASHIKUAR E TË NXËNIT | METODOLOGJIA VEPRIMTARITË E NXËNËSVE | BURIME DHE MJETE MËSIMORE |
|---|---|---|---|---|---|
| **14** | **1** | **2.5** Tipare të jetës së shoqërisë njerëzore nga koha e gurit në kohën e metaleve | Nxënësit lexojnë në klasë rubrikën:"Gjatë përdorimit të zjarrit njerëzit zbuluan mineralet. Ata vunë re se gurë të veçantë, në vendin ku ndiznin zjarrin, bëheshin të lëngshëm. Kur zjarri shuhej, gurët ishin bërë prapë të fortë. Ata panë se lëngu i shkrirë, kur ftohej, merrte formën e enës ku hidhej. Kështu mësuan se, në temperatura të larta, gurëve të veçantë mund t'u jepnin formën që dëshironin''. | Diskutimi i ideve, Të lexuarit ndërveprues Nxitja e veprimtarisë krijuese | Teksti mësimor, interneti, literaturë nga biblioteka e shkollës, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5" etj.*** |
| **15** | **2** | **2.6** Tipare të jetës së paraardhësve të shqiptarëve në parahistori | Historia e shqiptarëve është ndër më të vjetrat midis popujve të tjerë. Një gjë të tillë e dëshmojnë gjetjet e vendbanimeve të paleolitit dhe neolitit përgjatë territorit të vendit tonë. Ku i ndeshim këto vendbanime. Ç'janë vendbanimet shpellore? Po ato palafite? Tregoni disa veprimtari të komuniteteve të kësaj periudhe? | Parashikimi: Përgatitja për të nxënë Diskutimi i ideve | Teksti mësimor, interneti, atlas mësimor, hartë mësimore, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"etj.*** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **16** | **3** | **2.7** Shpikje të rëndësishme të njerëzve në parahistori | "Zjarri u ndryshoi jetën njerëzve. Pjekja e mishit bëri që trupi i njeriut të zhvillohej nga ana fizike dhe mendore. Duke qëndruar rreth zjarrit, hanin, çlodheshin, krijonin mjete, pastronin lëkurët për t'i veshur dhe për t'u mbrojtur nga të ftohtët." | Hartë mendimesh, punë në çift, plotësim harte, shpjegim termash dhe konceptesh, tabelë konceptesh, diskutim. | Teksti mësimor, interneti, album arkeologjik, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **17** | **4** | **2.8** Roli i gruas në parahistori | Nuk ka ndarje të prerë të punës, që këtë punë e bën vetëm burri dhe atë punë e bën vetëm gruaja. Ka ndarje të punës midis njerëzve, por jo midis njerëzve me gjini të ndryshme. Kur është e nevojshme, ata edhe **"**zihen**"** se kush do të bëjë këtë apo atë punë. | Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore. | Teksti mësimor, album arkeologjik, interneti, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **18** | **5** | **2.9** Gjuha, arti, besimi dhe kultura në komunitetet e para njerëzore | Kultura përmbledh të gjitha mjetet dhe modelet e sjelljes së një shoqërie (banesa, vegla, armë, zbukurime dhe mënyra se si punojnë, çfarë besojnë, si e kanë zhvilluar artin, shkencën etj.) të krijuara në një vend e kohë të caktuar. Ajo trashëgohet nga njëri brez në tjetrin. | Hartë konceptesh, punë në çift, vrojtim i pavarur i fotove të temës mësimore | Teksti mësimor, album arkeologjik, interneti, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **19** | **1** | **2.10 Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 2. Tema:** Fotomontazh për zhvillimin e banesave dhe veshjeve nga parahistoria deri sot | Shtëpitë tona kanë ndryshuar në vazhdimësi. Ne, shpesh, bëjmë ndryshime në mjediset tona për t'i bërë ato sa më të rehatshme e funksionale. Ju ka ndodhur që të ndryshoni pamjen e shtëpisë suaj apo të vendoseni në një banesë tjetër? Përse? | Diskutim, punë në grupe, prezantim | Letër, lapsa me ngjyra, ngjitës, kompjuter, videoprojektor |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **20** | **1** | **2.11 Projekt kërkimor i sugjeruar - ora e dytë. Shqyrtimi i materialeve të gjetura**<br>**Tema:** Familja nga antikiteti deri sot | Shohim një album fotosh ose librin e fëmijërisë së një shoqeje/ shoku të klasës. Diskutojmë si ka evoluar familja. | Diskutim, punë në grupe, sugjerime | Teksti mësimor, burime historike, histori personale, enciklopedi për fëmijë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **21** | **1** | **2.12 Test me shkrim Periudha e dytë Tematika 2.**<br>Shoqëritë e para njerëzore | Keni vështirësi në përgjigjen e pyetjeve të testit që do t'ju zhvilloj mësuesja/mësuesi?<br>Punoni vet testin e dhënë në tekstin mësimor, Historia 5. Vetëvlerësojeni veten para se t'ju vlerësojë mësuesi. | | ***Teksti, Historia 5*** |
| **TEMATIKA 3 QYTETËRIMET ANTIKE, THEMELI I KULTURËS EUROPIANE** | | | | | |
| **22** | **6** | **3.1** Koha dhe vendet ku lindën qytetërimet antike | **Qytetërimi** është periudha në të cilën njerëzit kaluan nga organizimi fisnor në jetën qytetare: krijuan qytetet dhe shtetet e para, shkruajtën ligjet, filloi të shkruhej historia etj. | Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove mësimore, punë me hartë | Teksti mësimor, album arkeologjik, interneti, hartë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **23** | **7** | **3.2** Tipare të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të qytetërimeve antike | ***Sumerët e Babilonisë*** ishin ndoshta të parët që ndërtuan një kalendar. Ata përdorën fazat e hënës duke numëruar 12 muaj hënorë, të cilët përbënin një vit. Për të bërë diferencën midis vitit hënor dhe vitin e stinëve, ata shtuan një muaj tjetër në kalendar, çdo katër vjet.<br>Egjiptianë e hershëm, grekët dhe popujt semitikë kopjuan këtë kalendar. Më vonë egjiptianët përshtatën një kalendar që përkon pothuaj saktësisht me stinët. | Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore, punë me hartë | Harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. |
| **24** | **1** | **3.3 *Vlerësim portofoli Periudha e dytë*** | Mësuesit bëjnë vlerësimin e punimeve të nxënësve, pjesë e ***"Portofoli i të nxënit, Historia 5"*** | Vlerësim sipas kritereve të dhëna nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA. | ***"Portofoli i të nxënit, Historia 5"*** |

**PLANIFIKIMI I PERIUDHËS SË TRETË**

**(PRILL-QERSHOR) 11 orë gjithsej**

## TEMATIKA 3. QYTETËRIMET ANTIKE, THEMELI I KULTURËS EUROPIANE

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime mbi lindjen dhe përhapjen e qytetërimeve. Kjo tematikë trajton tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të qytetërimeve antike, shoqërinë dhe jetën e përditshme, artin, kulturën, shkencën dhe besimin e këtyre qytetërimeve. Linja trajton gjithashtu dhe tipare të jetës së përditshme në qytetërimin ilir. Ajo vlerëson rëndësinë e artit antik si pjesë e trashëgimisë kulturore botërore.

| Nr. i orëve | Nr. i orëve PIII | TEMA MËSIMORE | SITUATA E PARASHIKUAR E TË NXËNIT | METODOLOGJIA VEPRIMTARITË E NXËNËSVE | BURIME DHE MJETE MËSIMORE |
|---|---|---|---|---|---|
| **25** | **1** | **3.4** Ilirët dhe fqinjët | ... Stërgjyshi i fisit ilir ishte Kadmasi; gruaja e tij ishte Harmonia – themelues legjendar i Tebës, që në formën e gjarprit u shpërngul e shkoi më vonë në krahinën e fisit ilir të Enkelejve, në lindje të Bokës dhe Kotorrit. Djali i tyre është quajtur Ilirikos... *(shkëputur nga Leksikon fq. 692)* | Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore, punë me hartë | Harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** |
| **26** | **2** | **3.5** Kultura ilire | Dalmatika është një petk i gjatë e i gjerë, me rrip të vendosur në ije. Mbi këtë petk hidhej krahëve një copë si shall. Petku kapej në krahun e majtë, ndërkohë që krahu i djathë mbetej i pambuluar. | Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore, punë me hartë | Harta, teksti mësimor, internet, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **27** | **3** | **3.6** Trashëgimia e qytetërimeve antike | Shoqëritë e qytetërimeve antike kanë lënë një trashëgimi të pasur kulturore, që shërben për të kuptuar si është zhvilluar shoqëria njerëzore. | Punë në grupe, diskutim, shpjegim termash dhe konceptesh, tabelë konceptesh | Harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** |
| **28** | **4** | **3.7** Arritjet e qytetërimeve antike në shkencë | Mendohet të ketë zbuluar parimin e dendësisë dhe pluskimit, i njohur si "Parimi i Arkimedit", që sipas gojëdhënës, e zbuloi ndërsa ai po lahej në vaskë (doli jashtë nëpër rrugë duke bërtitut "Eureka" (e gjeta). | Hartë konceptesh, shpjegim termash, diskutim | Harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** |
| **29** | **5** | **3.8** Figura historike të qytetërimeve antike | Figurat historike të qytetërimeve antike janë të shumta. Ju do të mësoni disa prej tyre. | Shpjegim, tabela e koncepteve, lexim i drejtuar | Harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike dhe figurave historike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** |
| **30** | **1** | **3.9 Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 3** Lindja dhe përdorimi i kalendarit | Çdo familje sot e përdor kalendarin. Po edhe ju vetë e përdorni atë. Për çfarë ju ndihmon kalendari? | Brainstorming, punë në grupe, diagrama e Venit | Letër, lapsa me ngjyra, ngjitës, interneti, fjalorë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **31** | **1** | **3.10 Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 4**<br>Qytetërimi ilir | Qytete ilire në territorin e sotëm të vendit tonë janë të shumtë. Të tillë janë: Bylisi, Amantia, Lisusi, Schodra, Theranda etj. Kërkoni të dhëna për një qytet ilir në internet, libra apo duke pyetur më të rriturit. Në se keni mundësi vizitojeni atë. Përshkruajeni me fjalët tuaja pamjen e një qyteti ilir. | Braistorming, punë në grupe, diskutim | Plastelinë, letër, lapsa me ngjyra, kompjuter, videoprojektor |
| **32** | **1** | **3.11 Veprimtari praktike e sugjeruar nr. 5**<br>Qytetërimet antike botërore | Nëse dikush do t'ju kërkonte t'i sugjeronit për të vizituar një qytetërim të vjetër, cilin do t'i sugjeronit dhe përse? | Parashikim me terma paraprake, punë në grupe, diagrami i Venit | Letër, teksti, fjalor enciklopedik |
| **33** | **1** | **3.12 Projekt kërkimor - ora e tretë.**<br>**Paraqitja e rezultateve të projektit**<br>Familja nga antikiteti deri sot | Nëse keni punuar një ese historike përshkruese, album, ekspozitë, raport, poster, PoëerPoint etj., sigurohuni që të keni mjetet dhe mjedisin e nevojshëm për paraqitje cilësore të rezultateve të projektit. | Paraqitje individuale ose në grup | Letër me format të madh, kompjuter/ laptop, videoprojektor |
| **34** | **1** | **3. 13 Test me shkrim**<br>**Periudha e tretë**<br>**Tematika 3**<br>Qytetërimet antike, themeli i kulturës europiane | Keni vështirësi në përgjigjen e pyetjeve të testit që do t'ju zhvilloj mësuesja/mësuesi?<br>Punoni vet testin e dhënë në tekstin mësimor, Historia 5. Vetëvlerësojeni veten para se t'ju vlerësojë mësuesi. | | Teksti, Historia 5 |
| **35** | **1** | **3.14 Vlerësim portofoli**<br>**Periudha e tretë** | Mësuesit bëjnë vlerësimin e punimeve të nxënësve, pjesë e ***"Portofoli i të nxënit, Historia 5"*** | Vlerësim sipas kritereve të dhëna nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA. | "Portofoli i të nxënit, Historia 5" |

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Historia dhe historiani ndihmojnë të kuptojmë të shkuarën | **Situata e të nxënit**<br>**<u>Historiani</u>**<br>“Ata që shkruajnë për historinë quhen historianë. Historiani është një njeri që bën kërkime historike dhe shkruan për të kaluarën e njerëzimit. Ai shkruan, veçanërisht, për ato ngjarje apo figura historike, të cilat kanë sjellë ndryshime të mëdha në shoqëri’’. | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**1. Tregon** ç’është historia dhe historiani.<br>**2. Dallon** rëndësinë e kërkimit historik si pjesë themelore e punës së historianit.<br>**3. Vlerëson** rëndësinë e historisë për të kuptuar ngjarjet e sotme. | **Fjalë kyçe:** historia, historiani, kërkime historike, figurë historike, interpretim | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore:** teksti mësimor, interneti, libra të ndryshëm historikë, ***Fletore pune vetëvlerësimi “Historia 5”*** etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, Qytetaria | | |
| **Metodolologjia:** Lexim i imët i tekstit, diskutim ditari dy pjesësh, punë e pavaruar individuale. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Në fillim të orës së mësimit mësuesi/ja ngarkon për të lexuar çështjet e mësimit disa nxënës me qëllim që të njohin konceptet, elementet kryesore dhe fjalët kyçe. Çështjet që do të trajtohen do të jenë: ‘’Historia dhe roli i saj’’ dhe ‘’Puna e historianit në ndërtimin e historisë. Më pas, nxënësveju ngarkohet për të lexuar situata e të nxënit për historinët dhe rolin e tyre në veprimtarinë e përditshme.

**<u>Historianët</u>**

‘’Ata që shkruajnë për historinë quhen historianë. Historiani është një njeri që bën kërkime historike dhe shkruan për të kaluarën e njerëzimit. Ai shkruan, veçanërisht, për ato ngjarje apo figura historike, të cilat kanë sjellë ndryshime të mëdha në shoqëri’’.

Mësuesi/ja, shkruan në tabelë disa pyetje për të nxitur rrjetin e diskutimit. Pyetjet:

**1.** Çfarë është historiani?
**2.** Për çfarë shkruan ai?
**3.** Si ndihmon historiani për të njohur të shkuarën?
**4.** A njihni ju ndonjë historian?

Pas përgjigjeve të nxënësve, nën drejtimin e mësuesit, rilexohet edhe një herë në teskt pasazhi rreth punës që bën historiani për ndërtimin e historisë.

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Në këtë pjesë të orës së mësimit, nxënësit punojnë në mënyrë të pavaruar ditaret e të nxënit. Në fletore ata shpjegojnë termat: historia, historiani, kërkime historike, figurë historike, interpretim.

**Shembull: Figurë historike** Është një njeri i shquar në histori. I tillë është p.sh. Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Rëndësia e figurave të tilla qëndron në veprën e tyre, që e ka ndihmuar shoqërinë të zhvillohet.

Disa prej punimeve i prezantojmë dhe diskutojmë në klasë.

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna, aktivizimin në orën e mësimit.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Kërkoni të dhëna për historianët që kanë shkruar për Gjergj Kastriotin Skënderbeun, si figurë të rëndësishme historike.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Burimet historike kanë rëndësi për të njohur të shkuarën | **Situata e të nxënit**<br>Historianët e ndërtojnë historinë e së shkuarës sipas burimeve historike. Të tilla janë: dokumentet e shkruara, ndërtimet, veprat e artit, enët prej qeramike, mjetet e punës e të jetesës, ditarët, revistat, dëftesat, fjalimet, intervistat, fotografitë, videot, të dhënat qeveritare, filmat, programet televizive, që i përkasin së kaluarës. Burimet bëhen prova historike vetëm kur me to merret historiani. | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**1. Tregon** rëndësinë e përdorimit të burimeve historike.<br>**2. Shpjegon** rëndësinë e burimeve historike.<br>**3. Dallon** burimet historike që ndihmojnë në punën e historianit. | **Fjalë kyçe:** burime historike, dokumentet e shkruara, veprat e artit, ditarët, prova historike, certifikata | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore:** teksti mësimor, interneti, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, temat e mëparshme mësimore. | | |
| **Metodolologjia:** Hartë konceptesh, diskutim, pyetja sjell pyetjen. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Mësuesi/ja fillon orën e mësimit me situatën e të nxënit duke treguar për rolin burimeve historike dhe historianit në trajtimin dhe shkrimin e historisë. Për këtë qëllim, lexojmë situatën e të nxënit.

Historianët e ndërtojnë historinë e së shkuarës sipas burimeve historike. Të tilla janë: dokumentet e shkruara, ndërtimet, veprat e artit, enët prej qeramike, mjetet e punës e të jetesës, ditarët, revistat, dëftesat, fjalimet, intervistat, fotografitë, videot, të dhënat qeveritare, filmat, programet televizive, që i përkasin së kaluarës. Burimet bëhen prova historike vetëm kur me to merret historiani.

Më pas mësuesi/ja orienton nxënësit të punojnë me tekstin në mënyrë individuale duke lexuar në dy grupe:

**Grupi i parë:**

Burimet historike

**Grupi i dytë:**

Rëndësia e burimeve historike

Pasi është lexuar në mëyrë individuale teksti, nxënësit diskutojnë në çift dhe më pas plotësojnë së bashku me mësuesin tabelat e hartës së koncepteve.

| Burimet Historike | Rëndësia e burimeve historike |
|---|---|
| Historia ndërtohet mbi bazën e burimeve historike.<br>Burime historike janë: dokumentat e shkruara, ndërtimet,veprat e artit, etj.<br>Burimi historik është i rëndësishëm për historinë e një vendi dhe të komnitetit.<br>Të tjera burime konsiderohen edhe ditarët, revisat, intervistat, fotografitë, videot, të dhënat qeveritare, etj. | Burimet bëhen provë historike vetëm kur me to merret historiani.<br>Burime janë ato që historiani dëshiron të studiojë<br>Burim me rëndësi është edhe dokumenti i Shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë<br>Certefikata e lindjes është burim historik, sepse tregon emrin tuaj edhe vendin ku keni lindur.<br>Certefikata, bashkë me objektet dhe dokumentet e tjera shërbejnë për të shkruar historinë vetjake dhe familjare. |

Pas përfundimit të ndërtimit të hartës së koncepteve, diskutojmë në klasë rreth problemeve të trajtuara.

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Në këtë fazë të mësimit, nxënësit, duke shfrytëzuar hartën e koncepteve, përforcojnë njohuritë e dhëna nëpërjet përgjigjeve të pyetjeve të njëpasnjëshme.
**1.** Ç'janë burimet historike?
**2.** Përse i shfrytëzon historiani ato?
**3.** Rendisni disa burime historike.
**4.** Cilat burime përdorin më shpesh historianët?

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësve mbështetet pjesëmarrjen aktive gjatë orës së mësimit, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna, kërkimin historik, etj.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Kërkoni në shtëpi burime historike si fotografi, letra, ditarë, objekte. Shënoni me disa fjali origjinën dhe funksionin e tyre.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Llojet e burimeve historike dhe historia gojore | **Situata e të nxënit.** Burimet historike ndahen në dy lloje kryesore: burime parësore dhe burime dytësore. Burim parësor është një dokument apo një objekt fizik, që është shkruar ose është krijuar gjatë kohës që shqyrton historiani. Burim dytësor është një dokument apo një objekt fizik, që është shkruar dhe është krijuar duke u mbështetur në burime parësore apo origjinale. | | |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**1. Tregon** shumëllojshmërinë e burimeve historike, si bazë kërkimi për përshkrimin e një ngjarjeje historike.<br>**2. Klasifikon** llojet e burimeve historike, duke dalluar burimet parësore nga ato dytësore.<br>**3. Shpjegon** rëndësinë e burimeve për shkrimin e historisë. | **Fjalë kyçe**: burime historike, burime parësore, burime dytësore, ligjet, historia gojore, librat, autobiografitë, dëftesë shkolle |
| **Burimet dhe mjetet mësimore:** teksti mësimor, interneti, dokumente të ndryshme historike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** temat e mëparshme, TIK, Gjuhët dhe komunikimi |

**Metodolologjia:** Diskutim për çështjet paraprake, harta e konceptit, imagjinatë e drejtuar.

**Organizimi i orës së mësimit:**

Diskutojmë duke provuar njohuritë paraprake. Për këtë qëllim, u kërkojmë nxëënsve t'u përgjigjet pyetjeve:

**1.** Ku shfaqën njerëzit e parë?
**2.** Çfarë karakteristikash kishin hominidët?
**3.** Si do t'i përshkruanit njerëzit e parë?
**4.** Kur u nisën emigrimin e tyre hominidët dhe ku u vendosën ata?
**5.** Ç'dini rreth homo sapiensin?

Nxënësit shprehin mendimet dhe idetë e tyre, të cilat diskutohen bashkarisht në klasë.

Më pas, për të mësuar konceptet kryesore, leksikun dhe elementet e mësimit, u paraqesim nxënësve një hartë koncepti mbi burimet historike. Pasi njihen me skemën, ata nisin dhe lexojnë në mënyrë individuale çështjet si: "Llojet e burimeve historike", "Burimet parësore", "Burimet dytësore". Pas leximit, i lejojmë të diskutojnë në dyshe dhe të punojnë në mënyrë të pavarur hartën e konceptit.




| |
|---|
| **Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Për të përforcuar njohuritë e dhëna, angazhojmë nxënësit duke i vënë në rolin e historianit. Disa prej tyre duhet të shfrytëzojnë për shkrimin e historisë burimet parasore, ndërsa grupi tjetër burimet dytësore. Reflektimet e lojës me rolin e historianit i ndajmë dhe i prezantojmë në klasë. |
| **Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësve mbështetet në pjesëmarrjen aktive gjatë orës së mësimit, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna gjatë reflektimit dhe në arsyetim. |
| **Detyra dhe punë e pavarur:** Pyesni të moshuarit rreth historive të rëndësishme të familjes. Shkruajeni me pak rreshta historinë dhe llojin e burimit. |
| |

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td colspan="2">Lënda: Histori</td><td>Shkalla: II</td><td>Klasa: V</td></tr>
<tr><td>Tema mësimore: Rëndësia e hartës historike</td><td colspan="4">Situata e të nxënit<br><u>Harta e Ilirisë</u><br>Në hartë tregohet ku shtrihej Iliria, emrat e fiseve ilire, vendet fqinje, lumenjtë, liqenet, detet dhe qytetet. Iliria paraqitet me ngjyrë jeshile për t'u dalluar nga vendet fqinje. Emrat e vendeve jepen ashtu si kanë qenë përdorur në periudhën historike, për të cilën harta është bërë. P.sh. në atë periudhë Durrësi quhej Dyrrah dhe jepet në hartë me këtë emër.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:<br>1. Mëson të lexojë një hartë historike.<br>2. Tregon elementët dhe simbolikën e saj në përshkrimin e ngjarjeve historike.<br>3. Vlerëson rëndësinë e hartës historike.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe: hartë, hartë historike, simbole, legjenda e hartës, harta e Ilirisë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe mjetet mësimore:<br>teksti mësimor, interneti, atlas historik, hartë mësimore, Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Qytetaria, Tik, Gjuhët dhe komunikimi</td></tr>
<tr><td colspan="5">Metodolologjia: Përvijim i të menduarit, punë me hartën, diskutim.</td></tr>
<tr><td colspan="5">Organizimi i orës së mësimit:<br>Nxënësit ndahen në tre grupe dhe secilit grup i kërkohet që të lexojë për pak minuta çështjet e mësimit:<br>Grupi I: Harta historike<br>Grupi II: Simbolet dhe legjenda e hartës<br>Grupi III: Harta e Ilirisë<br>Pasi nxënësit kanë lexuar çështjet, u kërkohet të ndërtojnë njohuritë e reja në fletore për secilin grup.<br>Më pas, nxënësit përfshihen në rrjetin e diskutimit mbi njohuritë që morën. Nëpërmjet pyetjeve që drejton mësuesi, ata nxiten të lexojnë, mendojnë, reflektojnë dhe nxjerrin përfundime duke këmbyer ide dhe mendime në diskutimin e gjerë që zhvillohet në klasë. Pyetjet:<br>1. Çfarë është harta historike?<br>2. Ç'janë simbolet e saj?<br>3. Ç'përban legjenda e hartës?<br>Punohet në mënyrë të pavarur. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të vëzhgojnë me imtësi hartën e Ilirisë që paraqitet në tekstin mësimor. Nën drejtimin e tij, nxënësit shohin në hartë shtrirjen e fiseve ilire, emrat e tyre, vendet fqinje, me të cilët kufizohej Ilira, lumenjtë, liqenet, detet dhe qytetet. Po kështu, shihen edhe emrat e vendeve që jepen ashtu si kanë qenë përdorur në periudhën historike, për të cilën harta është bërë.</td></tr>
<tr><td colspan="5">Përforcimi (konsolidimi i të nxënit): Pasi përfundojnë punën praktike me hartën, nxënësit diskutojnë rreth elementeve të simbolikës dhe legjendës që hasën në të. Në fund, ata paraqesin opinionin e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="5">Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve mbështetet në aktivizimin e tyre në orën e mësimit, në përgjigjet e dhëna, në studimin e hartës, diskutimet në klasë.</td></tr>
<tr><td colspan="5">Detyra dhe punë e pavarur: Kërkoni dhe grumbulloni të dhëna rreth fisit ilir që ka jetuar pranë qytetit apo krahinës suaj.</td></tr>
</table>

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt. ______________________**

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Periudhat historike dhe kronologjia | **Situata e të nxënit. Lexojmë fragmentin:**<br>**<u>Përcaktimi i kohës</u>**<br>Përcaktimi i kohës bazohet te ndarja që i kanë bërë historianët. Si viti bazë merret viti 0. Të gjitha ngjarjet historike që kanë ndodhur përpara kësaj date, te viti shënohet shkurtimisht p.e.s. P.sh. lindja e shkrimit shënohet 3500 vjet p.e.s. Ndërsa për ngjarjet që kanë ndodhur pas këtij viti shënohët thjesht data. Rënia e Perandorisë Romake ndodhi në vitin 476. | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**1. Përcakton** periudhat historike.<br>**2. Shpjegon** Parahistorinë, Antikitetin, Mesjetën, Periudhën Moderne dhe Periudhën Bashkëkohore.<br>**3. Vendos** ngjarjet historike sipas kronologjisë. | **Fjalë kyçe:** para erës sonë, era jonë, periudha e parahistorisë, periudha e historisë, shkrimi, kronologjia, periudha antike, mesjeta, periudha moderne, periudha bashkëkohore | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore** : teksti mësimor, interneti, libra të ndryshëm historikë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Temat e mëparshme, Gjuhët dhe komunikimi | | |
| **Metodolologjia:** Di, Dua të di, Mësova më shumë. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Për të përgatitur nxënësit për procesin e të nxënit, aplikojmë këtë metodë. Fillimisht ndërtojmë në tabelë një organizues grafik prej tre kolonash dhe më pas secili prej tyre e ndërton në fletore. Duke u bazuar te ky organizues, i pyesim nxënësit se çfarë dinë rreth kronologjisë në histori dhe ndarjes së saj në periudha historike. Njohuritë paraprake rreth temës nxënësit i shkruajnë në kolonën e parë.
Ndërkohë që nxënësit përgatiten të lëxojnë çështjet e mësimit, u kërkojmë se çfarë duan të dinë më shumë rreth këtyre problemeve. Më pas, gjithë këtë informacion të marrë e rregjistrojmë në kolonën e mesit.
Ndërkohë, nxënësit vihen të punojnë duke lexuar indivudualisht ememenëtët, konceptet dhe shprehitë e mësimit. Pasi përfundojnë u kërkohet të kategorizojnë njohuritë e marra në kolonën e tretë.

| **Di** | **Dua të di** | **Mësova** |
|---|---|---|
| Historianin dhe punën e tij<br>Historine dhe rolin e saj<br>Burimet<br>Ngjarjet | Kronologjinë<br>Periudhat historike<br>Lindjen e shkrimit | Kronologjia është vendosja e ngjarjeve historike sipas kohës kur kanë ndodhur<br>Koha e gurit, antikiteti, mesjeta, periudha moderne, periudha bashkëkohore.<br>Shkrimi lindi 3500 vjet p.e.s<br>Lindja e shkrimit ndau periudhën e parahistorisë nga ajo e historisë. |

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Nxënësit vihen të lexojnë përmbledhjen dhe u përgjigjen pyetjeve rreth saj, që i ndihmojnë në të kuptuarin e temës. I pyesim nxënësit për informacionin që kanë zbuluar dhe në bazë të punimeve të tyre, mësuesi/ja, ndërton në tabelë një organizues grafik të përgjithshëm.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për angazhimin në punën me shkrim dhe në diskutimet e zhvilluara.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Kërkoni të dhëna për lindjen e shkrimit dhe ndërtoni një ide të thjeshtë për të.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Linja dhe llogaritja e kohës | **Situata e të nxënit.**<br>Për të ndërtuar një histori të caktuar, duhen regjistruar datat dhe ngjarjet e saj të rëndësishme, sipas një rradhe kronologjike. Ato mund të paraqiten në një linjë kohore, si kjo që shihni më poshtë. Në të janë paraqitur sipas rradhës kronologjike: periudhat historike të shoqërisë njerëzore; ngjarjet e rëndësishme që bëjnë dallimin nga njëra periudhë në tjetrën. | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**1. Ndërton** linjën kohore, duke vendosur në të periudhat dhe ngjarjet historike.<br>**2. Zhvillon** llogaritjen e kohës në histori.<br>**3. Tregon** ç'është historia dhe historianët.<br>**4. Identifikon** me vitet ngjarjet, zhvillimet dhe personazhet historike. | **Fjalë kyçe:**periudhë historike, ngjarje historike, shekuj, mijëvjeçarë, viti 1, linjë kohore, kronologji | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore:** teksti mësimor, interneti, libra të ndryshëm historikë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Temat e mëparshme, Tik, Gjuhët dhe komunikimi | | |
| **Metodolologjia:** Hartë konceptesh, organizues grafik i informacionit, diskutim. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Mësuesi/ja, në fillim të orës së mësimit, lexon dhe diskuton situatën e të nxënit: *Për të ndërtuar një histori të caktuar, duhen rregjistruar datat dhe ngjarjet e saj të rëndësishme, sipas një rradhe kronologjike. Ato mund të paraqiten në një linjë kohore, si kjo që shihni më poshtë. Në të janë paraqitur sipas rradhës kronologjike: periudhat historike të shoqërisë njerëzore; ngjarjet e rëndësishme që bëjnë dallimin nga njëra periudhë në tjetrën.*

Më pas, nxënësit njihen me konceptet bazë të mësimit si:

llogaritje e kohës, linja kohore, shekulli, mijëvjeçar, periudhë historike, ngjarje historike, viti 1, kronologji. Në këtë fazë mësuesi/ja ndërton për secilën çështje nga një tabelë, ku të secilit tipar. Më pas ata ndahen në tre grupe, ku secili grup punon në mënyrë individuale dhe të pavarur me tekstin. Më pas, diskutohet në dyshe rreth tipareve ku nxënësit renditin elementët përbërës.

| Linja e kohës | Linja kohore | Llogaritja e kohës |
|---|---|---|
| Linja e kohës është skema ku paraqiten zhvillimet historike.<br>Në linjën e kohës bëjnë pjesë periudhat dhe ngjarjet historike të shoqërisë. | Linja kohore ëshë paraqitja grafike e kronologjisë së zhvillimit të ngjarjeve historike.<br>Në linjën kohore shohim se si është zhvilluar historia njerzore | Llogaritja e kohës shërben për të ditur ditët, muajt, vitet, shekujt dhe mijëvjeçarët që kanë ndodhur ngjarjet historike.<br>Shumë popuj e llogarisin kohën sipas përvojës së tyre<br>Llogaritja e kohës nis nga viti 1. |

Për të përforcuar njohuritë e dhëna, punojmë në mënyrë individuale ditarin dy pjesësh sipas skemës së caktuar.

| Nr. | Konceptet | Elementët përbërës |
|---|---|---|
| 1 | Periudhë historike | Periudha historike është një kohë e veçantë për historianët për shkak të ngjashmërive që ajo ka brenda saj. |
| 2 | Ngjarje historike | Ngjarjet historike janë zhvillime të rëndësishme që bëjnë dallimin nga njëra periudhë në tjetrën. |
| 3 | Viti 1 | Viti 1 është viti që historianët bazohen për të ndërtuar kronologjinë e historisë. Popuj të ndryshëm marrin si vitin 1 një ngjarje të ndryshme. Europianët e quajnë si vitin 1, vitin e lindjes së Jezusit. Ndërsa arabët përdorin si vitin 1, vitin largimit të Muhametit në Medinë. |
| 4 | Shekull | Shekulli është njësi matëse e kohës në histori dhe ka njëqind vjet. Numrat e shekujve shkruhen me numra romakë, p.sh.shekullin e njëzetë e një e shkruajmë shek. XXI. Viti 2019 është pjesë e shek. XXI. |
| 5 | Mijëvjeçar | Mijëvjeçari është matës i kohës në histori, i barabartë me 1 000 vjet ose 10 shekuj. |

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Nxënësit vihen të lexojnë disa prej punimeve në klasë. I pyesim nxënësit për informacionin që kanë shkruar dhe në bazë të tyre, mësuesi/ja, ndërton një rrjet të shkurtër diskutimi me pyetje të formuluara vetë.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për angazhimin në punën me shkrim dhe në diskutimet e zhvilluara.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Përshkruani me disa fjali një ngjarje historike.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore: Veprimtari praktike Nr.1**<br>Historia ime | **Situata e të nxënit:**<br>Shohim në klasë një album fotografik, i cili përmban foto të periudhave të ndryshme të një individi ose disa individëve.<br>Çfarë vëmë re? |
| **Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:** | **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:** |
| **Kompetenca e të menduarit:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Zhvillon** mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit.<br>**Kompetenca e të nxënit:**<br>**2. Përzgjedh** të dhëna nga burime të ndryshme, i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.<br>**Kompetenca dixhitale:**<br>**3. Zhvillon** kompetenca dixhitale për të gjetur, për të komunikuar informacionin historik. | - Përzgjedh burimet historike në ndërtimin e historisë vetjake.<br>- Mbledh burime dhe i klasifikon ato sipas llojit të tyre.<br>- Paraqet historinë vetjake mbështetur në burime historike.<br><br>**Fjalë kyçe:** dokumente të shkruara, ditare, objekte, histori të rrëfyera<br><br>**Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:** Artet, Gjuhët dhe komunikimi. |

| |
|---|
| **Burimet:** fotografi, certifikata lindjeje të siguruara nga Gjendja Civile ose të printura online. |
| **Metodologjia:** Punë individuale, punë në dyshe, turi i galerisë. |
| **Organizimi i mësimit:**<br>**Hapi I:** Udhëzoj klasën që çdo material të sjellë për ndërtimin e historisë së tij ta rendisë sipas një linje kronologjike.<br>**Hapi II**: Në një moment të dytë, udhëzoj klasën që të bashkëpunojnë në dyshe me shokun ngjitur ose edhe sipas preferencës që mund të kenë për të ndërtuar historitë e tyre sipas një linje kronologjike. Kjo i ndihmon mjaft fëmijët të ndreqin ndonjë difekt që mund të kenë shfaqur në hapin e parë.<br>**Hapi III:** Pasi nxënësit kanë shkëmbyer historitë e tyre me shokun, udhëzohen që të gjitha punimet e tyre që mund të jenë me postera, albume fotosh, vizatime etj, t'i vendosin në një kënd të klasës dhe të zhvillojnë turin e galerisë, duke shkuar tek historia e secilit. Me një laps në dorë ata mund të bëjnë shënime tek historia e shokut/ shoqes që i ka lënë impresione më të mëdha. |
| **Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për burimet që shfrytëzojnë, materialin që përzgjedhin dhe mënyrën e shfrytëzimit të materialit duke u bazuar në kërkesat e dhëna. |
| **Detyra dhe punë e pavarur:** Nuk parashikohen. |

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore: Projekt kërkimor. Ora e parë**<br>Zgjedhim temën e projektit | | **Situata e të nxënit:**<br>bashkëbisedim, sjellja e shembujve dhe reflektim | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>**Nxënësi:**<br>1. **Përzgjedh** temën e projektit.<br>2. **Harton** projektin sipas temës. | | **Fjalë kyçe:** projekt, temë projekti, marrëdhënie në familje, qytetërim antik | |
| **Mjetet dhe burimet:** bllok shënimesh, teksti, burime historike, histori personale | | **Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:** Gjuha dhe komunikimi, TIK | |
| **Metodologjia:** Bashkëbisedim, punë e pavarur individuale, diskutim. | | | |
| **Organizimi i orës së mësimit:**<br>**Hapi I:** Parashtroj përpara nxënësve rëndësinë e zhvillimit të një pune me projekt, e cila mund të realizohet në mënyrë individuale ose në grup. Shpjegoj që tema e projektit që do të përzgjidhet, do të jetë e shtrirë gjatë gjithë vitit shkollor, ku sipas periudhave (I, II, III) do të përcaktohen qartë hapat që do të ndiqen.<br>**Hapi II:** Për të përcaktuar temën e projektit kërkoj nga nxënësit që secili të shkruajë një temë dhe të argumentojë përse mendon të realizojmë atë. Për t'i ardhur në ndihmë nxënësve, u sugjeroj atyre disa alternativa. Nxënësit ftohen të shprehin idetë e tyre duke i shkruar në tabelë temat që kanë menduar dhe këtu nis diskutimi për përzgjedhjen e tyre.<br>**Hapi III:** Duke marrë parasysh dhe sugjerimin e mësueses, nxënësit vendosin për temën dhe përcaktojnë detyrat që do të zhvillojnë deri në orën e dytë të projektit, në periudhën e dytë.<br>Sugjerohet tema: **"Familja nga antikiteti deri sot"**. | | | |
| **Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen me fjalë motivuese për idetë e dhëna. | | | |
| **Detyrë: Për orën e dytë të projektit**<br>**1- Shkrimi i projektit për temën e caktuar**<br>Projekti duhet të përshkruajë si ka qenë familja në shoqëritë e qytetërimit antik deri sot. | | | |
| **2- Puna kërkimore**<br>Mbledhja e të dhënave (intervista me të rritur, kërkimi në internet, foto, dorëshkrime, piktura, vizatime, veshje, objekte gatimi etj.) | | | |

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Njerëzit e parë | **Situata e të nxënit:** Njerëzit e parë u shfaqën në kontinentin e Afrikës. Si lindën dhe u zhvilluan njerëzit e parë? Si jetonin dhe silleshin ata? Çfarë tipesh njerëzore krijuan ata? Në cilat kontinente u vendosën ata? A kemi ne sot ngjashmëri me njerëzit e parë? Tregoni dallimet midis tyre. | | |

| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:** | **Fjalë kyçe**: Lusi, hominidë, savanë, homo erektus, australopitek, homo sapiens, Njeriu i Neandertalit, Njeriu i Kromanjonit, etj. |
|---|---|
| **Nxënësi:**<br>1. **Identifikon** vendlindjen e njerëzve të parë.<br>2. **Përshkruan** mënyrën e jetësës së njerëzve të parë.<br>3. **Tregon** përhapjen e hominidëve drejt kontinenteve të tjera.<br>4. **Analizon** mënyrën se si u zhvillua homo sapiensi. | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore:** teksti mësimor, interneti, atlas mësimor, hartë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Qytetaria, Gjuhët dhe komunikimi, TIK |

**Metodolologjia:** Ndërtimi i shprehive mësimore, nxitja e diskutimit të ideve, nxitja e veprimtarisë krijuese.

**Organizimi i orës së mësimit**
**Parashikimi: Përgatitja për të nxënë'**

Nxënësit ndahen në tre grupe dhe secilit grup i kërkohet që të lexojë për pak minuta çështjet e mësimit:

**Grupi I:** Vendlindja e njerëzve të parë është Afrika.

**Grupi II:** Hominidët filluan të largohen nga vendlindja.

**Grupi III:** Si u zhvilluan njerëzit e parë.

Pasi nxënësit kanë lexuar pjësën parkatëse të nëntemës, u kërkohet të ndërtojnë njohuritë e reja në fletore për secilin grup.

Nxënësit përfshihen në një rrjet diskutimi mbi njohuritë paraprake që kanë marrë. Nëpërmjet pyetjeve që drejton mësuesi, ata nxiten të lexojnë, të mendojnë, të reflektojnë dhe të nxjerrin përfundime duke këmbyer ide dhe mendime në diskutimin e gjerë që zhvillohet në klasë. E gjithë veprimtaria zhvillohet mbi bazën e pyetjeve.

**1.** Ku u gjetën skeletet e njeriut të parë?

**2.** Ku jetonte homo sapiensi?

**3.** Si do t'i përshkruanit njerëzit e parë?

**4.** Kur u shfaqën për herë të parë hominidët dhe pse?

**5.** Kur u largua për herë të parë homo erektusi nga Afrika dhe si?

**6.** Ç'dini homo sapiensin?

Paralelisht mësuesi shënon në tabelë edhe konceptet kryesore të mësimit, të cilat i shpjegon. Të tillë janë: Lusi, hominidë, savanë, homo erektus, australopitek, homo sapiens.

**Përforcimi (konsolidim i të nxënit):** Në këtë fazë, nxënësve u jepën për të shpjeguar shkurtimisht fjalët kyçe (konceptet kryesore) të temës mësimore: Njerëzit e parë. Në mënyrë individuale, ata punojnë në fletore duke përshkruar me disa fjali termat:

Lusi________________________________________________________________________

Hominidë____________________________________________________________________

Savanë______________________________________________________________________

Homo erektus________________________________________________________________

Australopitek_______________________________________________________________

Homo sapiens________________________________________________________________

**Shembull:** Lusi është skeleti më i vjetër i hominidëve. Ai është zbuluar në Afar të Etiopisë në Afrikën Lindore dhe i përket një femre që shkencëtarët e kanë quajtur me këtë emër. Ajo ka jetuar rreth 4 milionë vjet më parë dhe skeleti i saj është 106.7 cm i gjatë.

Në fund, disa prej punimeve të nxënësve i lexojmë dhe diskutojmë në klasë.

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësve mbështetet në angazhimin gjatë fazave të ndryshme të orës së mësimit, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna, në argumentimin e zhvilluar.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Përshkruani me anë të vizatimit Lusin dhe homo sapiensin.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Jeta e komuniteteve të para njerëzore në paleolit dhe mezolit | **Situata e të nxënit:** Historia shfaqet me parahistorinë, periudhën kur nuk ekzistonte shkrimi. Të tilla ishin epokat e paleolitit, mezolitit dhe neolitit. Për t'u njohur me jetën e njerëzve të kësaj kohe, ne bazohemi te kërkimet arkeologjike. Si vazhdon jeta në periudhën e paleolitit dhe të neolitit? Me çfarë aktivitetesh merrej njeriu? Si jetonin komunitetet e njerëzve të parë? | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**Nxënësi:**<br>1. **Tregon** faktorët që ndikuan në krijimin e komuniteteve.<br>2. **Përshkruan** veprimtaritë e para të njeriut.<br>3. **Shpjegon** jetën e komuniteteve të para. | **Fjalë kyçe**: paleolit, mezolit, homo habilis, zjarr, komunitetet e para, nomadë. | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore**: teksti mësimor, interneti, album me foto, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"***etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Qytetaria, Gjuhët dhe komunikimi, TIK. | | |
| **Metodololologjia:** Diskutim për njohuritë paraprake, shënime mbi shënime, punë me tekstin. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Prezantojmë temën e re nëpërmjet situatës së të nxënit, ku tregojmë kulturat parahistorike të paleolitit (gurit të vjetër) dhe mezolitit (gurit të mesëm). Më pas, nxënësve u kërkohet t'u përgjigjet pyetjeve mbi njohuritë paraprake.

**1.** Ku shfaqën njerëzit e parë?

**2.** Çfarë karakteristikash kishin hominidët?

**3.** Si do t'i përshkruanit njerëzit e parë?

**4.** Kur u nisën emigrimin e tyre hominidët dhe ku u vendosën ata?

**5.** Ç'dini rreth homo sapiensin?

Nxënësit shprehin mendimet dhe idetë e tyre, të cilat diskutohen bashkarisht në klasë.

Nxënësit hapin tekstet dhe lexojnë në heshtje për disa minuta çështjet:

**1.** Komunitetet e para njerëzore

**2.** Jeta e komuniteteve të para

**3.** Rëndësia e komuniteteve fqinje

Pas përfundimit të leximit, nxënësit punojnë individualisht skemën:

| Homo Erektus | Homo Sapiens |
|---|---|
| **Ngjashmëritë** | **Dallimet** |
| Përdornin vegla prej guri.<br>Ishin gjuetarë dhe mbledhës bimësh.<br>Përdornin zjarrin për t'u ngrohur dhe për të pjekur mishin.<br>Jetonin në shpella. | Shpiku sëpatën prej guri.<br>Bëri harkun dhe shigjetën.<br>Gjuante kafshë të madha si mamuthët, bizonët, hipopotamët.<br>Bëri tendat e para për banim. |

Gjatë plotësimit të skemës për ngjashmëritë dhe dallimet, mësuesi/ja ndjek punën e nxënësve dhe i nxit të shohim librin, të konsultohen dhe të shkëmbejnë ide me njëri-tjetrin. Më pas, ata lejohen të prezantojnë punimet dhe të diskutojnë rreth tyre.

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Në këtë pjesë të orës së mësimit do të punojmë me tekstin mbi bazën e përgjigjeve të dhëna nga nxënësi. Duke vëzhguar fotot e temës mësimore i përshkruajmë ato duke treguar vendbanimet parahistorike, vizatimet e shpellave, jetesën e njerëzve të parë dhe veprimtaritë e tyre.

Nxënësit përfshihen në këtë fazë në veprimtari si: të lexuarit dhe të shkruarit. Për këtë qëllim, ata punojnë skemën e mëposhtme, ku bëjnë kategorizimin e titujve duke i vendosur në piramidë në kategorinë përkatëse.

| **Komunitetet e para njerëzore** | | |
|---|---|---|
| **Jetesa, marrëdhëniet shoqërore, veprimtaritë e njerëzve të parë** | | |
| **Paleoliti** | **Homo Erektusi** | **Homo Sapiensi** |
| **1.** Njerëzit zhvilluan veprimtari të ndryshme. | **1.** Shpiku zjarrin. | **1.** E kishte trurin më të madh. |
| **2.** Ju përshtatën klimës. | **2.** Me zjarrin ngrohej. | **2.** Truri ishte afërsisht 1 350 $cm^3$. |
| **3.** U afruan me njëri tjetrin. | **3.** Nisi të përdorte mishin e pjekur. | **3.** Jetonte në komunitet. |
| **4.** Përdorën veglat prej guri. | **4.** Shpiku sëpatën, harkun, shigjetën. | **4.** Nuk e kuptonte se ishte njeri. |

Opinionet e formuluara nga nxënësit i prezantojmë në klasë.

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësve mbështetet në pjesëmarrjen aktive në klasë, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna, arsyetimin dhe argumentimin e zhvilluar, etj.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Përshkruani me anë të vizatimit një nga veprimtaritë kryesore të komuniteteve të para njerëzore të paleolitit.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:** Jeta e komuniteteve njerëzore në neolit | **Situata e të nxënit:** Një nxënës lexon rubrikën: Periudha e akullnajave mori fund rreth 10 000 vjet më parë. Klima filloi të ngrohej. Në këto kushte, komunitete të caktuara të njerëzve mësuan të kultivonin bimët dhe të zbusnin kafshët. Komunitetet ishin vendosur në Azi, Amerikën e Jugut, Europë, rreth Gjysmëhënës Pjellore, zonës pranë lumenjve Tigër dhe Eufrat, që përfshin vendet e sotme të Irakut, Sirisë dhe Egjiptin pranë lumit Nil, që sot quhet Lindja e Afërt. | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Shpjegon** faktorët që ndikuan në ndryshimin e veprimtarive të komuniteteve të para.<br>**2. Përshkruan** veprimtaritë e komunitetit të bujqve dhe blegtorëve.<br>**3. Tregon** në hartë vendosjen e komuniteteve njerëzore. | **Fjalë kyçe**: akullnaja, bujqësia, blegtoria, drithëra, ndarja e punës, poçeria. | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore**: teksti mësimor, interneti, hartë mësimore, atlas, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** etj. | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Qytetaria, Gjuhët dhe komunikimi. | | |
| **Metodolologjia:** Diskutimi i ideve, punë në grupe, nxitja e veprimtarisë krijuese. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Mësuesi/ja cakton një nxënës që të lexojë rubrikën e situatës së të nxënit dhe më pas nxit rrjetin e diskutimit nëpërmjet pyetjeve:

**1.** Kur përfundoi periudha e akullnajave?
**2.** Çfarë veprimtarie nisën të kryenin njerëzit?
**3.** Ku jetonin komunitetet e periudhës së neolitit?

Më pas nxënësit ndahen në tre grupe të ndyshëm ku secili lexon një prej çështjeve të mësimit:

**Grupi I**: Kultivimi i bimëve, lindja e bujqësisë.
**Grupi II**: Zbutja e kafshëve, lindja e blegtorisë.
**Grupi III**: Ndarja e punës.

Gjatë leximit, çdo nxënës mban shënimet përkatëse sipas skemës. Heqim një vijë vertikale në mes të fletës së fletores, ku majtas shënojmë nëntemën dhe djathtas sqarimet dhe shënimet përkatëse.

| | |
|---|---|
| **Kultivimi i bimëve, lindja e bujqësisë** | Për të plotësuar nevojat për ushqim, lindi bujqësia. Drithërat e para ishin gruri dhe elbi.<br>Rajoni i parë bujqësor ishte Gjysmëhëna Pjellore. Në Kinë u kultivua orizi, ndërsa në Amerikë misri. |
| **Zbutja e kafshëve, lindja e blegtorisë** | Nga zbutja e kafshëve të egra ëe kapeshin në gjueti, lindi blegtoria. U zgjodhën kafshët e përshtatshme për t'u zbutur. Ndër kafshët e para që u zbutën ishin qentë dhe delet. Më pas ishin derrat, dhitë, buajtë dhe shpendët. |
| **Ndarja e punës** | Me lindjen e bujqësisë dhe blegtorisë, nisi ndarja e punës. U krijuan tre komunite si: bujqit, blegtorët dhe gjuetarët e mbledhësit e bimëve. Më vonë, lindi dhe zejtaria. |

Në fund, u kërkohet nxënësve të lexojnë pjesët e caktuara nga secili grup. Më pas, jepen komentet përkatëse nga mësuesi/ja duke i inkurajuar nxënësit për punimet e tyre.

**Paleoliti**

Pas punës, angazhohen disa nxënës në tabelë për të prezantuar punimet e tyre, ku nëpërmjet diskutimit dhe refleksioneve, zhvillojmë përforcimin e njohurive të dhëna.

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Për të parë se sa i kanë asimiluar nxënësit njohuritë e marra u kërkojmë të plotësojnë në fletore një skemë të thjeshtë rreth tipareve te përbashkëta dhe të veçanta rreth paleolitit dhe neolitit.
Paleoliti dhe neoliti-kanë të përbashkët sepse njerëzit merreshin me gjueti, veglat e punës ishin prej guri, lindi dhe u zhvillua matriarkati, u zbulua zjarri.
Neoliti ndryshon nga neoliti sepse në këtë periudhë lindi bujqësia, blegtoria, ndarja e punës, zejtaria. Pas punës mësuesi prezanton në në tabelë rezultatet përgjithësuese të punës së nxënësve

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësve mbështetet në aktivizimin e tyre në orën e mësimit, në përgjigjet e dhëna, në pjesëmarrjen në diskutime, bashkëpunimin në grup, etj.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Vizatoni një hartë të Gjysmëhënës Pjellore dhe vendosni në të popujt që jetojnë sot.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: II</td><td>Klasa: V</td></tr>
<tr><td>Tema mësimore: Tipare të jetës së shoqërisë njerëzore nga koha e gurit në kohën e metaleve</td><td colspan="3">Situata e të nxënit: Nxënësit lexojnë në klasë rubrikën:<br>“Gjatë përdorimit të zjarrit njerëzit zbuluan mineralet. Ata vunë re se gurë të veçantë, në vendin ku ndiznin zjarrin, bëheshin të lëngshëm.<br>Kur zjarri shuhej, gurët ishin bërë prapë të fortë. Ata panë se lëngu i shkrirë, kur ftohej, merrte formën e enës ku hidhej. Kështu mësuan se, në temperatura të larta, gurëve të veçantë mund t’u jepin formën që dëshironin’’.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:<br>Nxënësi:<br>1. Përshkruan epërsitë që solli ndarja e punës dhe përdorimi i metaleve në zhvillimin e shoqërisë njerëzore.<br>2. Tregon ndryshimet në mënyrat e jetesës së shoqërisë njerëzore nga koha e gurit në atë të hekurit.<br>3. Shpjegon faktorët që çuan në krijimin e qeverisjes dhe qytetërimit.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: paleolit, neolit, metale, piktura shkëmbore, matriarkat, bakër, bronz, hekur, patriarkat.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet dhe mjetet mësimore: tekst mësimor, interneti, literaturë nga biblioteka e shkollës, Fletore pune vetëvlerësimi “Historia 5” etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>Qytetaria, TIK, Gjuhët dhe komunikimi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodolologjia: Diskutimi i ideve, të lexuarit ndërveprues, nxitja e veprimtarisë krijuese.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>Mësuesi/ja angazhon nxënësit për të aktivizuar njohuritë paraprake përpara mësimit të ri. Nëpërmjet pyetjeve ai/ajo zbulon se çfarë dinë nxënësit për ato që kanë mësuar nga periudhat e paleolitit dhe neolitit. Pyetjet:<br>1. Çfarë mendoni për Homo Erektusin?<br>2. Ç’ mund të thoni për Homo Habilis dhe Homo Sapiensin?<br>3. Tregoni llojet e veprimtarive të para të njeriut?<br>4. Rendisni disa nga veprimtaritë e njeriut në neolit?<br>5. Si lindi bujqësia dhe blegtoria?<br>Në këtë fazë u kërkojmë nxënësve të lexojnë tekstin dhe të plotësojnë skemën e mëposhtëme. Në diagramën piramidale vendosim tiparet kryesore të secilës rubrikë:</td></tr>
</table>

**Mësuesi/ja paraqet përpara nxënësve situatën:**
Gjatë përdorimit të zjarrit njerëzit zbuluan mineralet. Ata vunë re se gurë të veçantë, në vendin ku ndiznin zjarrin, bëheshin të lëngshëm. Kur zjarri shuhej, gurët ishin bërë prapë të fortë. Ata panë se lëngu i shkrirë, kur ftohej, merrte formën e enës ku hidhej. Kështu, mësuan se në temperatura të larta, gurëve të veçantë mund t'u jepin formën që dëshironin.
Më pas, nxënësve u drejtohet pyetja: Imagjinoni për disa minuta dhe përshkruajeni situatën. Pas meditimit, nxënësit shkëmbejnë mendime, ide dhe përshkruajnë atë që imagjinuan. Gjatë kësaj faze për çështje të ndryshme zhvillohen pyetje dhe diskutime. Në fund, përpara se të bëhet përshkrimi përfundimtar, lexohet e gjithë çështja.

| **Tiparet e jetës shoqërore në priudhën e gurit dhe metaleve** | | |
|---|---|---|
| **Paleoliti** | **Neoliti** | **Metalet** |
| **1.** Njeriu i paleolitit nuk siguronte ushqim të mjaftueshëm.<br>**2.** Njerëzit nuk kishin vendbanime të përhershme, ndarje gjinore dhe darje të detyrave.<br>**3.** Njerëzit paleolitikë kanë lënë vepra arti, në muret e shpellave që përshkruajnë jetën e tyre. | **1.** Njerëzit kaluan nga gjuetia në zbutjen dhe shumimin e kafshëve dhe në kultivimin e bimëve.<br>**2.** Komunitetet siguruan burime të vazhdueshme ushqimi dhe vendbanimet të qëndrueshme.<br>**3.** Lindi artizanati, ku njerëzit nisën të bënin armë dhe stoli.<br>**4.** Nga këmbimi i tepricave të prodhimit nisi aktivitetin e saj tregtia.<br>**5.** Rolet gjinore ndryshuan, ku roli i grave, krahas punëve të shtëpisë dhe bujqësisë, u forcua edhe në komunitet. Kjo periudhë u quajt matriarkat. | **1.** Nerëzit zbuluan mineralet.<br>**2.** Minerali i bakrit ishte i pari që u zbulua. Më pas, u zbuluan bronzi dhe hekuri<br>**3.** Me metale njerëzit filluan të bëjnë mjete pune, armë, stoli, enë, etj.<br>**4.** Gjatë epokës së metaleve, u rrit prodhimi bujqësor dhe blegtoral, ku meshkujt luanin rolin kryesor në komunitet.<br>**5.** Lindi patriarkati, qytetet e para, qeverisja dhe qytetërimi. |

**Përforcimi (konsolidim i të nxënit):** Në këtë pjesë të orës së mësimit diskutojmë nëpërmjet pyetjeve:
**1.** Identifikoni veçoritë e tri periudhave historike.
**2.** Cilat janë format e para të organizimit shoqëror?
**3.** Përse materialet e veglave të punës i dhanë emrin epokës?

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësve mbështetet në aktivizimin e tyre në orën e mësimit, në përgjigjet e dhëna, në pjesëmarrjen në diskutime, ndërtimin e njohurive të reja, shfaqjen e mendimit kritik, etj.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Mblidhni të dhëna dhe krahasoni njeriun e qytetëruar dhe njeriun e paqytetëruar.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

<table>
<tr><td colspan="2">Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td colspan="2">Lënda: Histori</td><td>Shkalla: II</td><td>Klasa: V</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Tipare të jetës së paraardhësve të shqiptarëve në parahistori</td><td colspan="4">Situata e të nxënit: Historia e shqiptarëve është ndër më të vjetrat midis popujve të tjerë. Një gjë të tillë e dëshmojnë gjetjet e vendbanimeve të paleolitit dhe neolitit përgjatë territorit të vendit tonë. Ku i ndeshim këto vendbanime. Ç'janë vendbanimet shpellore? Po ato palafite? Tregoni disa veprimtari të komuniteteve të kësaj periudhe?</td></tr>
<tr><td colspan="3">Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:<br>Nxënësi:<br>1. Tregon gjurmë të parahistorisë në territoret shqiptare.<br>2. Shpjegon fillimet e qytetërimit në truallin shqiptar.<br>3. Përshkruan në hartë vendbanimet e paraardhësve tanë.</td><td colspan="3">Fjalë kyçe: strall, Konispol, Tren, shpella, palafite, parmendë, pellazgë.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, interneti, atlas mësimor, hartë mësimore, Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5" etj.</td><td colspan="3">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:. Qytetaria, TIK, Gjeografia.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Metodolologjia: Diskutim për njohuritë paraprake, lexim i drejtuar, punë me hartën.</td></tr>
<tr><td colspan="6">Organizimi i orës së mësimit:<br>Mësuesi/ja shënon në tabelë termat paleolit, neolit, piktura shkëmbore, bakër, metale, etj, dhe u kërkon nxënësve të mendojnë dhe të reflektojnë rreth tyre. Më pas, për t'i saktësuar plotësisht këto koncepte, përqendrohemi në diskutim duke u dhënë përgjigje pyetjeve:<br>1. Ç'dini rreth paleolitit?<br>2. A nisi arti me pikturat shkëmbore?<br>3. Ç'mund të thoni për zhvillimet dhe veprimtaritë e njerëzve në neolit?<br>4. Ç'përfaqësonte minerali i bakrit?<br>5. Rendisni disa nga zbulimet e periudhës së metaleve?<br>Në këtë fazë mësuesi/ja sugjeron pjesën që duhen lexuar në tekst duke e prezantuar te nxënësit:<br>Nga materialet e zbuluara në vendbanimet parahistorike rezulton se trualli i banuar sot nga shqiptarët filloi të popullohej që në kohën e paleolitit (mbi 100 000 vjet më parë). Gjurmët e hershme i përkasin paleolitit të mesëm dhe mezolitit. Vendbanimet më të hershme gjenden në: Gajtan (Shkodër), në malin e Dajtit, Xarë (Sarandë), Shën Marinë (Sarandë), Konispol, etj. Banorët e paleolitit të truallit tonë, nga pamja fizike, ishin si njeriu i Neandertalit.<br>Pasi përfundon leximi, mësuesi/ja i orienton nxënësit të mbajnë shënime duke u bazuar te pyetjet: Për çfarë bën fjalë ky pasazh? Përse ndodhi kështu? Çfarë provash kemi? Nxënësit bëjnë parashikimin e vet mbi pjesën.</td></tr>
</table>

| Tiparet e jetës shoqërore në periudhën e gurit dhe të metaleve | | |
|---|---|---|
| **Çfarë ka ndodhur** | **Çfarë provash keni** | **Si vijon historia** |
| | | |

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Punohet në mënyrë të pavarur. Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve nga një fletë pune, ku është paraqitur në mënyrë të përgjithshme harta e Shqipërisë. Nxënësit vendosin në hartë me simbole dhe emra vendbanimet e paleolitit dhe neolitit. Në fund ata paraqesin opinionin e tyre.

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësve mbështetet në aktivizimin e tyre në orën e mësimit, në përgjigjet e dhëna, pjesëmarrjen në diskutime, plotësimin e tabelës, ndërtimin e hartës.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Pyesni mësuesin. Cili është vendbanimi parahistorik që ndodhet pranë vendbanimit tuaj? Mbidhni disa të dhëna rreth tij.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Shpikje të rëndësishme të njerëzve në parahistori | **Situata e të nxënit: Jeta pranë zjarrit**<br>"Zjarri u ndryshoi jetën njerëzve. Pjekja e mishit bëri që trupi i njeriut të zhvillohej nga ana fizike dhe mendore. Duke qëndruar rreth zjarrit, hanin, çlodheshin, krijonin mjete, pastronin lëkurët për t'i veshur dhe për t'u mbrojtur nga të ftohtët." | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Rendit** shpikjet më të rëndësishme të njerëzve në parahistori.<br>**2. Përshkruan** si njerëzit populluan zonat e reja mjedisore.<br>**3. Vlerëson** rolin e shpikjeve në zhvillimin e shoqërisë njerëzore. | **Fjalë kyçe**:<br>çekiç, varkat primitive, tendat, zjarri, shpellat, kasollet, metalet, homo erectusi | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore**: libri i Historisë, interneti, album arkeologjik, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5" etj.*** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Gjeografia; temat ku trajtohet periudha e parahistorisë. | | |
| **Metodolologjia:** Hartë mendimesh, punë në çift, plotësim harte, shpjegim termash dhe konceptesh, tabelë konceptesh, diskutim. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Në fillim të orës së mësimit, mësuesi/ja lexon ose u kërkon nxënësve të lexojnë situatën e të nxënit, ku jepet informacion për jetën pranë një prej shpikjeve më të rëndësishme të njeriut në parahistori, zjarrit:

**Jeta pranë zjarrit**

*"Zjarri u ndryshoi jetën njerëzve. Pjekja e mishit bëri që trupi i njeriut të zhvillohej nga ana fizike dhe mendore. Duke qëndruar rreth zjarrit, hanin, çlodheshin, krijonin mjete, pastronin lëkurët për t'i veshur dhe për t'u mbrojtur nga të ftohtët."*

Mësuesi/ja, shkruan në dërrasë tri drejtimet e zhvillimit të njerëzve në parahistori:

1. Krijimi dhe përdorimi i mjeteve të punës dhe armëve.
2. Krijimi i mënyrave të reja të jetesës sipas kushteve mjedisore.
3. Popullimi i zonave të reja mjedisore.

Për të konkretizuar më mirë, mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë për shpikjet si: vegla pune, armë dhe mënyra të reja jetese. Ndërsa nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur pjesën e caktuar, ndërton në një tabelë, ku mund të shënohen shpikjet dhe shpjegimi përkatës për to. Shpjegimi do të realizohet nga nxënësit pasi të kenë mbaruar leximin.

| Nr. | Shpikja | Rëndësia e shpikjes në përmirësimin e jetës së njeriut të parahistorisë |
|---|---|---|
| **1** | Çekiçi | Përdorej për të goditur arrat dhe si armë në gjuetinë e kafshëve të vogla. |
| **2** | Thika prej guri | Përdorej për therjen e kafshëve dhe punimin e lëkurëve të tyre. |
| **3** | Gjilpëra | Shërbente për prodhimin e veshjeve (duke qepur lëkurët e kafshëve). |
| **3** | Varkat | Mundësonin lëvizjen nëpër lumenj. |
| **4** | Zjarri | I mundësonte njeriut të ngrohej, ta përdorte për të ngrohur, pjekur ushqimin dhe për t'u mbrojtur nga kafshët e egra. |
| **5** | Tendat | Ishin prej lëkure, kockash, prej degëve të pemëve dhe ndihmonin për t'u strehuar. |
| **6** | Kasollet | Ndërtoheshin me shkopinj, kallama, degë pemësh dhe mbuloheshin me bar, ose degë pemësh. |
| **7** | Kultivimi i bimëve dhe kafshëve | I siguronte njeriut ushqimin kur nuk gjendej në natyrë. |
| **8** | Zbulimi i metaleve | Përmirësoi veglat e punës dhe armët, pasi metali është i fortë dhe i siguronte njerëzve më shumë ushqim dhe banesa më të mira. |

Pasi është plotësuar tabela nën drejtimin e mësuesit, por dhe informacioni i marrë nga plotësimi i saj, ndërtohet një hartë mendimesh mbi Homo erectusin, hominidin e parë që kapërceu mjediset e savanës afrikane për t'u përhapur dhe jetuar në zona të reja mjedisore.

Homo erectus

U vendos në Azi dhe Europë.

Jetesa në këto mjedise më të ftohta u mundësua nga zbulimi i zjarrit dhe përdorimi i shpikjeve të tjera si gjilpëra, kultivimi i bimëve e kafshëve, përdorimi i veglave të punës prej metali.

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Në këtë pjesë të orës së mësimit, përgjigjet do të jepen nga nxënësit duke vrojtuar fotot në temën mësimore dhe duke përshkruar për to nga një rezultat që solli për shoqërinë njerëzore në parahistori.

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësit mbështetet në pergjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.

**Detyra dhe punë e pavarur** Vlerësoni dhe shkruani se cila shpikje e njerëzve të parahistorisë është më e rëndësishme sipas jush dhe përse mendoni kështu?

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Roli i gruas në parahistori | **Situata e të nxënit:**<br>Të dhënat arkeologjike zbulojnë në sërë rolesh që mund të kenë luajtur të dyja gjinitë në shoqërinë parahistorike. Nuk ka ndarje të prerë të punës, që këtë punë e bën vetëm burri dhe atë punë e bën vetëm gruaja.<br>Ka ndarje të punës midis njerëzve, por jo midis njerëzve me gjini të ndryshme. Kur është e nevojshme, ata edhe "zihen" se kush do të bëjë këtë apo atë punë. | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Përshkruan** rolin e gruas në periudhat e parahistorisë paleolit dhe neolit.<br>**2. Shpjegon** arsyet e respektimit të barazisë gjinore.<br>**3. Vlerëson** kontributin e gruas në zhvillimin e shoqërisë njerëzore. | **Fjalë kyçe:** gruaja, barazi gjinore**,** detyra amtare, figurinë femërore | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore:**<br>teksti mësimor, album arkeologjik, interneti, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"etj.*** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Qytetaria; Temat mësimore të tekstit, të cilat trajtojnë periudhat historike dhe jetën e komuniteteve në parahistori. | | |
| **Metodolologjia:** Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Mësuesi/ja fillon orën e mësimit me situatën e të nxënit duke treguar për rolin e dy gjinive në shoqërinë parahistorike mbështetur në situatën e shkëputur nga teksti:

*Të dhënat arkeologjike zbulojnë në sërë rolesh që mund të kenë luajtur të dyja gjinitë në shoqërinë parahistorike. Nuk ka ndarje të prerë të punës, që këtë punë e bën vetëm burri dhe atë punë e bën vetëm gruaja.*

*Ka ndarje të punës midis njerëzve, por jo midis njerëzve me gjini të ndryshme. Kur është e nevojshme, ata edhe "zihen" se kush do të bëjë këtë apo atë punë.*

Më pas mësuesi/ja orienton nxënësit të punojnë me tekstin në mënyrë individuale duke lexuar në dy grupe:

**Grupi i parë:**

Gruaja në paleolit

**Grupi i dytë:**

Gruaja në neolit

Pasi nxënësit kanë lexuar në mënyrë të pavarur tekstin, ata lejohen të diskutojnë në çift. Leximi i tyre mundëson që të ndajnë mendimet duke u përgatitur për ndërtimin e hartës së koncepteve e cila plotësohet nga mësuesi me sugjerimet e nxënësve.

| Gruaja në paleolit | Gruaja në peolit |
|---|---|
| Gratë ishin gjuetare si burrat;<br>nuk kishin ndarje pune,<br>burrat dhe gratë mblidhnin bimë së bashku;<br>barazia mes gjinive ishte përparësi për të mbijetuar;<br>ndarja e punëve nuk bëhej në bazë të dallimeve burrë-grua, por në bazë të aftësive të secilit për të bërë punë. | Gratë dhe burrat jetonin në komunitete të caktuara;<br>ata mbollën bimët dhe zbutën kafshë duke shtuar punët në komunitet;<br>meqenëse gruaja lindte fëmijë dhe i rriste ata, përpunimi qumështit, leshit, yndyrës ishte pjesë e punës së saj'<br>prodhimi i enëve prej balte bëhej kryesisht nga gratë;<br>përgatitja e ushqimit ishte një nga përgjegjësite e grave;<br>gratë kujdeseshin për përgatitjen e veshjeve'<br>zbulimi i metaleve filloi ta dobësojë rolin e gruas në familje, pasi burrat siguronin ushimin kryesor të familjes. |

Pas përfundimit të ndërtimit të hartës së koncepteve për rolin e gruas në paleolit dhe neolit, mësuesi/ja orienton nxënësit të studiojnë fotot e temës mësimore duke shkruar në fletore nga një fjali për foton se çfarë shprehin ato. Nxënësit, nga njohuritë e marra duke shfrytëzuar dhe hartën e koncepteve, duhet të identifikojnë edhe periudhën historike që paraqesin fotot: paleolit ose neolit.
Pasi kanë përfunduar përshkrimin e fotove dhe përcaktimin e periudhës historike të tyre, ata, nën kujdesin e mësuesit, lexojnë si kanë përshkruar fotot.

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Në këtë fazë të mësimit, nxënësit duhet t'i përgjigjen këtyre pyetjeve, të cilat gjejnë lehtësisht përgjigje duke shfrytëzuar hartën e koncepteve:
**1.** Si bëhej ndarja e punëve të dy gjinive për të siguruar ushqimin?
**2.** Cili ishte roli i gruas në paleolit?
**3.** Po në neolit?

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxenësit mbështetet në pergjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Kërkoni të dhëna për kuptimin e fjalës barazi gjinore. Më pas, shkruani katër fjali për barazinë gjinore në parahistori dhe sot.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: II | Klasa: V |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore:** Gjuha, arti, besimi dhe kultura në komunitetet e para njerëzore | **Situata e të nxënit:**<br>**Kultura** përmbledh të gjitha **mjetet dhe modelet e sjelljes** së një shoqërie (banesa, vegla, armë, zbukurime dhe mënyra se si punojnë, çfarë besojnë, si e kanë zhvilluar artin, shkencën etj.) të krijuara në një vend e kohë të caktuar. Ajo trashëgohet nga njëri brez në tjetrin. |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Njeh** zhvillimin e mendimit, të besimit e të artit të komuniteteve të para njerëzore, si pikënisje e qytetërimeve botërore.<br>**2. Përshkruan** kulturën në komunitetet e para njerëzore. | **Fjalë kyçe**:gjuha, Venusi, besimi, shumë perëndi, kutura |
| **Burimet dhe mjetet mësimore:**<br>teksti mësimor, album arkeologjik, interneti, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"etj.*** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Qytetaria, temat mësimore të tekstit, të cilat trajtojnë periudhat historike dhe jetën e komuniteteve në parahistori, Gjuha shqipe, Arti figurativ |

**Metodolologjia:** Hartë konceptesh, punë në çift, vrojtim i pavarur i fotove të temës mësimore.

**Organizimi i orës së mësimit:**

Faza e parë e orës së mësimit fillon me situatën e të nxënit, të cilën e lexon mësuesi/ja:

**Kultura** përmbledh të gjitha **mjetet dhe modelet e sjelljes** së një shoqërie (*banesa, vegla, armë, zbukurime dhe mënyra se si punojnë, çfarë besojnë, si e kanë zhvilluar artin, shkencën etj.*) të krijuara në një vend e në një kohë të caktuar. Ajo trashëgohet nga njëri brez në tjetrin.

Pasi lexohet interpretimi i konceptit kulturë, diskutohet me nxënësit për kuptimin e saj, duke e konkretizuar me kulturën vendase të qytetit ose fshatit ku ata jetojnë. Për ta konkretizuar, përmendin banesat, mënyrën si punojnë, besimin fetar, artistët, shkencëtarët shqiptarë etj.

Faza e dytë e orës së mësimit vazhdon me leximin në mënyrë të pavarur në tri grupe:

**Grupi i parë:**

Gjuha, mendimi dhe arti

**Grupi i dytë:**

Besimi

**Grupi i tretë:**

Kultura në komunitetet e para

Pasi nxënësit kanë lexuar në mënyrë të pavarur sipas grupit të leximit, ata diskutojnë në çift ndërmjet tyre për tematikën e grupit, si i kanë kuptuar konceptet gjuhë, të menduar, art, besim dhe kulturë.

Në këtë fazë mësuesi/ja ndërton në tabelë hartën e koncepteve me mendimet e nxënësve, duke shkruar veçoritë e gjuhës, artit, besimit dhe kulturës në komunitetet e para njerëzore.

| Gjuha, Arti | Besimi | Kultura |
|---|---|---|
| Në fundin e paleolitit dhe fillimin e neolitit lindën dhe u zhvilluan fjalët e para.<br>Të folurit dhe mendimi i dalloi njerëzit nga kafshët e tjera.<br>Tri format kryesore të artit ishin: gdhendja në gur, përshtatja e fiturave, piktura e shpellave. | Ka linduar tek njerëzit e parë në Afrikë në fund të paleolitit.<br>Njerëzit e parë besonin në shumë perëndi.<br>Për nder të perëndive organizonin edhe festa.<br>Ata u kushtonin perëndive ushqime, dhe u bënin flijime. | Të gjitha mjetet e kohës së gurit nuk ishin vetëm prej guri (kockat, fildishi, druri).<br>Njerzit e parë përdornin enë balte për të gatuar ushqim.<br>Ushqimi i tyre ndryshonte me kalimin e kohës, nga rajoni në rajon.<br>Veshjet e tyre të para ishin lëkurët e kafshëve dhe në neolit u shtuan dhe veshje të krijuara në tezgjah. Në varret e tyre janë gjetur objekte guri, dhe kocke. |

Në fazën e tretë të procesit të të nxënit, nxënësit lejohen të punojnë në çift për të vrojtuar fotot e temës mësimore dhe të diskutojnë mes tyre për kuptimin e fotos duke e përshkruar atë. Në vazhdim, nxënësit lexojnë fjalinë ku kanë përshkruar foton duke diskutuar mbi to nën drejtimin e mësuesit.

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Në këtë fazë të konsolidimit të të nxënit, nxënësit do t'u përgjigjen pyetjeve të mëposhtme duke u mbështetur në hartën e koncepteve dhe përshkrimin e fotove.

1. Në ç'mënyrë lindi gjuha dhe mendimi te njerëzit e parë?
2. Si u zhvillua arti?
3. Cila është mënyra e jetesës në komunitetet e para njerëzore?

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.

**Detyra dhe punë e pavarur** Vlerësoni dhe shkruani: Cilat janë ngjashmëritë në kulturë midis komuniteteve të para njerëzore dhe shoqërisë sot?

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore: Veprimtari praktike Nr. 2**<br>Fotomontazh për zhvillimin e banesave dhe veshjeve nga parahistoria deri sot | | **Situata e të nxënit:**<br>Shtëpitë tona kanë ndryshuar në vazhdimësi. Ne, shpesh, bëjmë ndryshime në mjediset tona për t'i bërë ato sa më të rehatshme e funksionale. Ju ka ndodhur që të ndryshoni pamjen e shtëpisë suaj apo të vendoseni në një banesë tjetër? Përse? | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Tregon** ndryshimet që kanë pësuar banesat nga parahistoria deri sot.<br>**2. Rendit** disa prej kushteve historike që kanë diktuar ndryshimin e banesave në kohë dhe hapësirë.<br>**3. Pregatit** në mënyrë digjitale një zhvillim kronologjik të funksionit dhe rëndësisë së banesave. | | **Fjalë kyçe:** shpella, kasolle, palafite, banesa të fortifikuara, banesat qytetare | |
| **Mjetet dhe burimet:** letër, lapsa me ngjyra, ngjitës, kompjuter, videoprojektor | | **Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK | |
| **Metodologjia:** Diskutim, punë në grupe, prezantim. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

**Hapi I:** Nisur nga situata e të nxënit, diskutohet me nxënësit duke risjellë në kujtesë evoluimin e banesave nga e shkuara e deri sot.



| |
|---|
| **Hapi II**: Mësuesja ndan klasën në grupe pune për realizimin e veprimtarisë:<br><br>**Grupi 1**- Gjen foto, vizatime të banesave, veshjeve, vegla pune si dhe materiale të shkruara për to.<br><br>**Grupi 2**- Ndërton linjën kronologjike sipas gjetjeve të grupit të parë.<br><br>**Grupi 3**- Ndërton një fotomontazh duke respektuar kriterin kronologjik. Në pamundësi të përdorimit të videoprojektorit, paraprakisht udhëzohen nxënësit që materialet e gjetura t'i sistemojnë duke i ngjitur në një tabak.<br><br>**Hapi III:** Paraqitja e punës përpara klasës me videoprojektor. Në pamundësi të përdorimit të videoprojektorit, prezantimi i punës në një tabak, ku nxënësit ngjisin materialet e gjetura duke i renditur kronologjikisht. |
| **Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për burimet që shfrytëzojnë, materialin që përzgjedhin dhe mënyrën e shfrytëzimit të materialit duke u bazuar në kërkesat e dhëna. |
| **Detyra dhe punë e pavarur:** Nuk parashikohen. |

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore: Projekt kërkimor. Ora e dytë. Shqyrtimi i materialeve te gjetura për temën:**<br>Familja nga antikiteti deri sot | **Situata e të nxënit:** Shohim një album fotosh ose librin e bebes të një shoku/shoqeje në klasë nga fëmijëria. Disktutojmë si ka evoluar familja. | | |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Njeh** mënyrat e shqyrtimit dhe të përzgjedhjes së materialeve per t'iu përgjigjur kërkesave të temës.<br>**2. Vlerëson** ndryshimet e familjes nga antikiteti deri sot. | **Fjalë kyçe:** tradita kulturore, shqyrtim materialesh, përzgjedhje materialesh |
| **Mjetet dhe burimet:** teksti, burime historike, histori personale, enciklopedi për fëmijë | **Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK |
| **Metodologjia:** Diskutim, punë në grupe, sugjerime. | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

**Hapi I:** Si fillim, shqyrtohen materialet e gjetura nga secili nxënës dhe vlerësohet rëndësia e tyre. Më pas, bëhet një përzgjedhje e këtyre materialeve, duke mos rënë në përsëritje ose duke mos ngarkuar me informacion të papërshtashëm me moshën e fëmijëve.
**Hapi II:** Ndaj klasën në grupe pune:

**Grupi A**- Punon për çështjen "Roli i gruas, burrit dhe fëmijëve në familje në shoqërinë antike deri sot".
**Grupi B**- Punon për çështjen "Traditat kulturore të familjes në shoqërinë antike deri sot".

Anëtarët e secilit grup shqyrtojnë materialet e sjella dhe përzgjedhin ato që i përgjigjen detyrës së kërkuar.

**Hapi III:** Mësuesja sugjeron nxënësit për disa kritere që duhet të ndjekin gjatë prezantimit të punës së tyre, por duke mos diktuar në zgjedhjen e tyre.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për burimet që shfrytëzojnë, materialin që përzgjedhin dhe mënyrën e shfrytëzimit të materialit duke u bazuar në kërkesat e dhëna.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Pregatitja e projektit me PowerPoint.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Koha dhe vendet ku lindën qytetërimet antike | **Situata e të nxënit:**<br>**Qytetërimi** është periudha në të cilën njerëzit kaluan nga organizimi fisnor në jetën qytetare: krijuan qytetet dhe shtetet e para, shkruajtën ligjet, filloi të shkruhej historia etj. | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Përcakton** konceptin qytetërim.<br>**2. Tregon** në hartë vendodhjen e qytetërimeve antike.<br>**3. Përcakton** kohën dhe faktorët që çuan në lindjen e qytetërimeve antike. | **Fjalë kyçe:** qytetërimi, arkeologjia, Gjysmëhëna Pjellore, lumi Nil, lumenjtë Tigër dhe Eufrat, sumerët, lumenjtë Ind dhe Gang, lumi Mekong | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore**:<br>Teksti mësimor, album arkeologjik, interneti, hartë, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Temat e trajtuara më parë të mësimit: periudhat historike dhe kronologjia; rëndësia e hartës historike; linja dhe llogaritja e kohës. | | |
| **Metodolologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:** Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore, punë me hartë. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Mësuesi/ja e nis orën e mësimit duke lexuar situatën e të nxënit:

**Qytetërimi** *është periudha në të cilën njerëzit kaluan nga organizimi fisnor në jetën qytetare: krijuan qytetet dhe shtetet e para, shkruan ligjet, filloi të shkruhej historia etj.*

Pasi nxënësit kanë kuptuar konceptin "qytetërim", mësuesi udhëzon nxënësit të realizojnë lidhjen ndërmjet numrave në hartë dhe qytetërimeve përkatëse në fletoren e tyre të klasës, në mënyrë të pavarur. Në përfundim të veprimtarisë, do të plotësohet tabela e mëposhtme duke shënuar të dhënat identifikuese të secilit qytetërim.

| **Numri në hartën e tekstit** | **Qytetërimi** | **Vendndodhja** |
|---|---|---|
| **1** | i popullsisë maja | Amerika Qendrore (Meksikë) |
| **2** | Actek | Amerika Qendrore (Meksikë) |
| **3** | Inkas | Amerika Jugore (Peru) |
| **4** | Sumer | Gjysmëhëna Pjellore; Azi; lumenjtë Tigër dhe Eufrat (Irak, Kuvajt) |
| **5** | Babilonas | Gjysmëhëna Pjellore; Azi; lumenjtë Tigër dhe Eufrat (Irak, Kuvajt) |
| **6** | Egjiptian | Gjysmëhëna Pjellore; Afrikë; lumi NIl (Egjipt) |
| **7** | i popujve Arianë | Azi; Luginat e lumenjve Ind dhe Gang (Indi) |
| **8** | Khmer | Azia Juglindore; lumi Mekong (Laosi, Kamboxhia) |

| | | |
|---|---|---|
| **9** | Kinez | Azi; lumenjtë Huan He e Jan Ce (Kinë) |
| **10** | Fenikas | Azi; brigjet juglindore të Detit Mesdhe (Liban) |
| **11** | Helen | Europë dhe Azi; në jug të Gadishullit të Ballkanit |
| **12** | Ilir | Europë; Ballkanin Perëndimor |
| **13** | Romak | Europë; Gadishulli Apenin (Italia) |

Pasi nxënësit kanë ndërtuar së bashku me mësuesin/en tabelën e qytetërimeve, ata do të lexojnë në mënyrë individuale veçoritë e qytetërimeve të hershme për të ndërtuar një hartë konceptesh mbështetur në faktorët e lindjes së qyteteve, artin, jetëgjatësinë, kohën e lindjes së tyre.




Plotësimi i hartës së koncepteve do të mbështetet në shembuj konkretë të përmendur në tekst.

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Në këtë fazë të procesit mësimor nxënësit do t'u përgjigjen disa pyetjeve për të mundësuar përforcimin dhe konsolidimin e të nxënit.

**1.** Ku lindën qytetërimet e para ose ato antike të hershme?
**2.** Cilët ishin faktorët që çuan në lindjen e qytetërimeve të hershme antike.

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.

**Detyra dhe punë e pavarur** Shkruani dy elemente të përbashkëta të qytetërimit të sotëm me atë të qytetërimeve antike.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Tipare të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të qytetërimeve antike | **Situata e të nxënit:** ***Sumerët e Babilonisë*** ishin ndoshta të parët që ndërtuan një kalendar. Ata përdorën fazat e hënës duke numëruar 12 muaj hënorë, të cilët përbënin një vit. Për të bërë diferencën midis vitit hënor dhe vitin e stinëve, ata shtuan një muaj tjetër në kalendar, çdo katër vjet. Egjiptianë e hershëm, grekët dhe popujt semitikë kopjuan këtë kalendar. Më vonë egjiptianët përshtatën një kalendar që përkon pothuaj saktësisht me stinët. | | |

| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:** | **Fjalë kyçe:** qytetërim antik, qytet shtet, faraon, egjiptian, sumer, diga, kanale kulluese, piramida e shoqërisë egjiptiane, politeist |
|---|---|
| **Nxënësi:**<br>1. **Përcakton** tiparet e përbashkëta të zhvillimit shoqëror në qytetërimet antike.<br>2. **Përshkruan** tiparet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të qytetërimeve antike.<br>3. **Ndërton** piramidën e shoqërisë egjiptiane. | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore:**<br>harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Gjuhët dhe komunikimi, TIK |

**Metodolologjia:** Hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore, punë me hartë.

**Organizimi i orës së mësimit:**

Mësuesi/ja në fillim të orës së mësimit lexon dhe diskuton situatën e të nxënit:

***Sumerët e Babilonisë*** *ishin ndoshta të parët që ndërtuan një kalendar. Ata përdorën fazat e hënës, duke numëruar 12 muaj hënorë, të cilët përbënin një vit. Për të bërë diferencën midis vitit hënor dhe vitit të stinëve, ata shtuan një muaj tjetër në kalendar, çdo katër vjet.*

*Egjiptianët e hershëm, grekët dhe popujt semitikë kopjuan këtë kalendar. Më vonë, egjiptianët përshtatën një kalendar që përkon pothuaj saktësisht me stinët.*

Nxënësit në këtë fazë të mësimit kanë mundësi të kenë një njohuri për arritjet astronomike në për llogaritjen e kohës kalendarike, e cila u mundësonte përshtatjen me kushtet klimaterike të lidhura ngushtësisht me bujqësinë.

Në fazën e dytë mësuesi/ja rendit në tabelë tiparet e përbashkëta të qytetërimeve antike:

1. Furnizimi i qëndrueshëm i qytetit me ushqim
2. Krijimi i organeve të qeverisjes
3. Ndarja e shoqërisë në grupe të ndryshme
4. Krijimi i besimeve fetare dhe i gjuhës së shkruar
5. Zhvillimi i artit, teknologjisë dhe shkencës

Më pas, nxënësit ndahen në pesë grupe, ku secili grup punon në mënyrë individuale, të pavarur me tekstin dhe më pas në çift duke duke diskutuar për tiparin e përbashkët. Në këtë fazë mësuesi/ja, për secilin tipar, ndërton një tabelë, në të cilën nxënësit renditin elementet përcaktuese të secilit tipar për qytetërimet antike.

| Nr. | Tipare të përbashkëta të zhvillimit shoqëror | Elementet përcaktuese të secilit tipar |
|---|---|---|
| 1 | Furnizimi i qëndrueshëm i qytetit me ushqim. | Qytetet, rezultat i zhvillimit të bujqësisë dhe rritjes së popullsisë. Qytet – shtetet përbëheshin nga qyteti dhe tokat rrethuese përreth tij. |
| 2 | Krijimi i organeve të qeverisjes. | Qytet – shteti drejtohej nga mbreti, i cili krijonte ushtrinë. Në qytetërimet e mëvonshme shteti përfshinte disa qytete. Në qytetërime të ndryshme kishte institucione të ndryshme që drejtonin. |
| 3 | Ndarja e shoqërisë në grupe të ndryshme. | Shoqëria ishte e ndarë mbështetur në gjendjen ekonomike. Ndarja më e strukturuar është ajo egjiptiane. |
| 4 | Krijimi i besimeve fetare dhe i gjuhës së shkruar. | Shoqëritë antike kanë patur besime të ndryshme fetare. Njerëzit besonin në shumë perëndi (politeist). Shkrimi u përdor për përmirësimin e komunikimit, mbajtjen e të dhënave dhe shprehjen e veprimtarisë krijuese. Libri i parë i shkruar është Epi i Gilgameshit. |
| 5 | Zhvillimi i artit, teknologjisë dhe shkencës | Tregon aspekte të jetës së përditshme, sundimtarëve, perëndive. Ndërtuan teatro, stadiume, tempuj, piramida. U zhvillua astronomia, kimia, mjekësia, matematika, të cilat mundësuan arritjet e sipërpërmendura. |

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Mbështetur në njohuritë e marra nga tema mësimore, nxënësit ndërtojnë në fletoren e tyre në mënyrë individuale piramidën e shoqërisë egjiptiane sipas modelit skicë të mëposhtëm të ndërtuar nga mësuesi/ja.




**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Përdorni në fjali fjalët: diga, qytet - shtete, priftërinj, skllevër, matematikë.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt. ________________________**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: II | Klasa: V |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Ilirët dhe fqinjët e tyre | **Situata e të nxënit:**<br>*... Stërgjyshi i fisit ilir ishte Kadmasi– themelues legjendar i Tebës, gruaja e tij ishte Harmonia. AI në formën e gjarpërit u shpërngul e shkoi më vonë në krahinën e fisit ilir të Enkelejve, në lindje të Bokës dhe Kotorrit. Djali i tyre është quajtur Ilirikos...* (shkëputur nga Leksikon fq. 692) | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Tregon** në hartë vendndodhjen dhe shtrirjen e fiseve ilire.<br>**2. Përshkruan** karakteristikat e trojeve ilire, qeverisjen dhe fqinjët e ilirëve. | **Fjalë kyçe**: trojet ilire, pellazgët, Iliri, dardanët, ardianët, enkelejtë, liburnët, taulantët, molosët, thesprotët | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore**:<br>harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Gjuhët dhe komunikimi, Qytetaria | | |
| **Metodolologjia:** hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore, punë me hartë. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Në fillim të procesit mësimor, mësuesi/ja lexon legjendën e ilirëve, i shkëputur nga Libri Leksikon fragment, që ka për qëllim të rritë interesimin duke u shpjeguar nxënësve se materiali është një legjendë.

*"... Stërgjyshi i fisit ilir ishte Kadmasi– themelues legjendar i Tebës, gruaja e tij ishte Harmonia. AI në formën e gjarpërit u shpërngul e shkoi më vonë në krahinën e fisit ilir të Enkelejve, në lindje të Bokës dhe Kotorrit. Djali i tyre është quajtur Ilirikos......"*

Pas hyrjes dhe çtensionimit që përcjell kjo legjendë për popullsinë ilire, nxënësit orientohen të punojnë në mënyrë të pavarur duke punuar njëkohësisht në tekst dhe në hartë. Ata në mënyrë individuale do të gjejnë në hartë fiset e përmendura sipas renditjes numerike.

Në këtë fazë mësuesi/ja ndërton një tabelë për t'u plotësuar nga nxënësit.

| Nr. | Fiset ilire | Shtrirja gjeografike e tyre |
|---|---|---|
| 1 | Japodët, liburnët, dalmatët, desidatët, ardianët | Jetonin në atje ku sot gjenden Sllovenia, Kroacia, Bosnje dhe Hercegovina. |
| 2 | Dardanët | Kosovë |
| 3 | Penestët | Lugina e Drinit të Zi |
| 4 | Paionët | Luginën e lumit Vardar |
| 5 | Diokleatët | Mali i Zi |
| 6 | Labeatët | Rreth liqenit të Shkodrës |
| 7 | Taulantët | Midis lumenjve Mat e Vjosë |

| | | |
|---|---|---|
| **8** | Albanët | Rreth Krujës |
| **9** | Enkelejtë | Në fushën e Korçës dhe Devollit |
| **10** | Kaonët | Përtej maleve të Kudhësit dhe Llogarasë |
| **11** | Thesprotët | Çamëri |
| **12** | Molosët | Rreth Janinës |
| **13** | Japigët, mesapët | Italia e jugut |

Mbështetur në hartën në tekst, nxënësit ftohen të përcaktojnë fqinjët e ilirëve:

**1.** maqedonasit dhe trakët në Lindje;

**2.** helenët në Juglindje;

**3.** italikët në Perëndim në Itali.

Më pas, nxënësit pyeten nëse kanë vizituar Apoloninë dhe Durrësin dhe u shpjegohet se këto qendra në antikitet ishin qytete tregtare të krijuara nga grekët.

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Në këtë fazë të mësimit do të përgjigjen mbështetur në njohuritë e mësuara gjatë orës me këtë pyetje:

Lexoni "Trojet ilire" dhe gjeni:

**1.** Cili fis ilir ka jetuar në vendbanimin tuaj?

**2.** Cilat fise ilire kanë jetuar në territorin e fqinjëve të vendbanimit tuaj?

**3.** Cilat fise ilire kanë banuar jashtë territorit të sotëm të Shqipërisë?

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Kërkoni të dhëna. Shkruani tri fjali për qeverisjen e vendbanimit tuaj në kohën e ilirëve.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Kultura Ilire | **Situata e të nxënit:**<br>Dalmatika është një petk i gjatë e i gjerë, me rrip të vendosur në ije. Mbi këtë petk hidhej krahëve një copë si shall. Petku kapej në krahun e majtë, ndërkohë që krahu i djathë mbetej i pambuluar. | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Përcakton** shtresëzimin e shoqërisë ilire dhe evolucionin shoqëror të saj.<br>**2. Përshkruan** mënyrën e jetesës së Ilirëve.<br>**3. Tregon** arritjet e artit ilir nëpërmjet objekteve arkeologjike. | **Fjalë kyçe:** shoqëria ilire, familja ilire, fisi, Bylisi, dalmatika, mbretëresha Teuta | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore**:<br>harta, teksti mësimor, internet, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi “Historia 5”*** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Gjuhët dhe komunikimi, Qytetaria, TIK | | |
| **Metodolologjia:** hartë konceptesh, punë në çift, studimi i pavarur i fotove të temës mësimore, punë me hartë. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Në fillimin e orës së mësimit, nxënësve u lexohet situata e të nxënit:

*“Dalmatika është një petk i gjatë e i gjerë, me rrip të vendosur në ije. Mbi këtë petk hidhej krahëve një copë si shall. Petku kapej në krahun e majtë, ndërkohë që krahu i djathë mbetej i pambuluar.”*

Mësuesi/ja tregon se si kjo veshje gjeti përhapje në të gjithë Perandorinë Romake duke ruajtur dhe emrin e origjinës së saj.

Mësuesi/ja sugjerohet që të parapërgatitë nxënësit një orë më parë që ata përgatitin materiale dhe në formë skedash, ku të jenë bashkëngjitur foto dhe tekst. Skedat e sugjeruara:

**Skeda 1**

Foto nga vendbanimet ilire dhe përshkrim i evoluimit të shoqërisë ilire deri në shtetformim.

**Skeda 2**

Vendbanimi i Bylisit, i treguar me një foto ilustruese të monumenteve arkeologjike dhe përshkrimi i tij për ndërtesat publike, banesat, muret rrethuesese dyqanet etj.

**Skeda 3**

Veshja ilire duke e ilustruar me foto të veshjes dalmatike e të fustanellës dhe përshkrimi i tyre për të treguar ndikimin në antikitet, por dhe në traditën e sotme popullore.

**Skeda 4**

**Ushqimi.** Mësuesi/ja mund të përdorë informacion mbështetur në përshkrimet e autorëve antikë për prodhimet e popullsisë ilire. Ndër to duhet t’i kushtohet rëndësi e veçantë produkteve blegtorale, bletarisë, pemës së ullirit, prodhimit të verës etj.

**Skeda 5**

Arti ilir ilustrohet me foto nga skulpturat, stolitë, mozikët, enët e zbukuruara. Teksti duhet të përmbajë një përshkrim të shkurtër për mënyrën si realizoheshin këto objekte dhe për qendrat kryesore të prodhimit të tyre.

**Skeda 6**

Arsimi. Në këtë skedë mësuesi mund të përfshijë informacion për arsimimin e të rinjve në Apoloni, ku vlen të përmendet dhe rasti që perandori Oktavian është arsimuar në këtë qytet. Në të duhet të përmendet edhe mbreti ilir Genti, i cili u shqua në studimin e bimëve mjekësore.

**Skeda 7**

Gjuha. Në këtë skedë mësuesi/ja përzgjedh fjalë me origjinë ilire, të cilat gjejnë përdorim edhe sot në gjuhën e folur të popullit tonë (emra njerëzish, perëndish, lumenjsh, qytetesh etj).

Klasa ndahet në 7 grupe të vogla, ku secili grup përzgjedh një skedë, të cilën e lexojnë në grupin e tyre dhe e diskutojnë. Në fund secili grup zgjedh një përfaqësues për të prezantuar skedën.

Mësuesi/ja shënon në tabelë emërtimin e secilës skedë.

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Në këtë fazë nxënësit duhet t'i përgjigjen pyetjeve:

1. Përshkruani me fjalët tuaja vendbanimet ilire.
2. Cilat ishin veshjet ilire që ruhen deri në ditët e sotme në kulturën popullore?
3. Në cilën moshë fëmijët fillonin të shkonin në shkolla në Iliri?
4. Përmend tri emra njerëzish, të cilët e kanë origjinën që në periudhën ilire.

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxenësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.

**Detyra dhe punë e pavarur**

Pyesni të rriturit dhe shkruani emra ilirë të vendbanimeve dhe njerëzve. Në klasë pyesni mësuesin/en se cili prej jush e ka emrin me origjinë ilire.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Trashëgimia e qytetërimeve antike | **Situata e të nxënit:**<br>Shoqëritë e qytetërimeve antike kanë lënë një trashëgimi të pasur kulturore, që shërben për të kuptuar si është zhvilluar shoqëria njerëzore. | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**Nxënësi:**<br>1. **Përcakton** kuptimin e termit monument kulturor dhe UNESCO.<br>2. **Tregon** disa monumente të rëndësishme kulturore të antikitetit, si pjesë e trashëgimisë kulturore botërore sot.<br>3. **Përshrkuan** monumente të qytetërimit ilir, të cilat gjenden në vendin tonë. | **Fjalë kyçe**: monument kulturor, UNESKO, Sfinksi, piramida, Parthenoni, Koloseu | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore**:<br>harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Gjuhët dhe komunikimi, Arti figurativ | | |
| **Metodolologjia:** Punë në grupe, diskutim, shpjegim termash dhe konceptesh, tabelë konceptesh. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Në fillim të orës mësimore, mësuesi/ja lexon dhe shpjegon trashëgiminë kulturore e në tekst:

*Shoqëritë e qytetërimeve antike kanë lënë një trashëgimi të pasur kulturore, që shërben për të kuptuar si është zhvilluar shoqëria njerëzore.*

Gjatë kësaj faze, mësuesi, duke përdorur fjalorin, trajton dhe shpjegon termat "monument kulturor" dhe "UNESKO", me të cilat nxënësi do të ndeshet në temën mësimore.

Në fazën e përvetësimit të monumenteve kulturore rekomandohet të përdoret një tabelë, pasi nxënësit ndahen në gjashtë grupe sipas monumenteve të trajtuara në tekst.

**Grupi i parë:** Piramidat dhe Sfinksi

**Grupi i dytë:** Muri i Madh Kinez

**Grupi i tretë:** Qytetërimi në Meksikë dhe Peru

**Grupi i katërt:** Parthenoni

**Grupi i pestë:** Koloseu

**Grupi i gjashtë:** Qyteti i Bylisit

Pasi nxënësit kanë punuar në mënyrë individuale dhe diskutim në grup, ata rendisin të gjitha monumentet dhe qyetërimet në tabelën e ndërtuar nga mësuesi.

| Nr. | Monumenti kulturor | Përshkrimi |
|---|---|---|
| 1 | Piramidat<br><br>Sfinksi | U ndërtuan nga faraonët egjiptianë rreth 5 mijë vjet më parë. Më e madhja është piramida e faraonit Keops në Giza, Egjipt.<br>Me kokën e perandorit dhe trupin e luanit, u ndërtua për të “mbrojtur” faraonin pas vdekjes. |
| 2 | Muri i Madh Kinez | Filloi të ndërtohej në shek VII p.e.s. për të mbrojtur vendin nga pushtimet. |
| 3. | Qytetërimi në Meksikë dhe Peru | Ky qytetërim la pas vepra arti, arkitekture, matematike, kalendarin dhe njohuri astronomike. |
| 4 | Parthenoni | U ndërtua në një kodër të qytet – shtetit të Athinës. Filloi të ndërtohej në shek. XIII p.e.s. Parthenoni u ngrit në nderim të perëndeshës mbrojtëse të qytetit, Athinasë. |
| 5 | Koloseu | Monumenti më i rëndësishëm i qytetërimit romak. Qëllimi i ndërtimi të tij ishte organizimi i lojrave për argëtim në nder të perëndive. |
| 6 | Qyteti i Bylisit | Simbol i qytetërimit ilir. Ky qytet e ka zanafillën në shek VIII p.e.s., por lulëzoi duke filluar nga shek VII p.e.s. e në vazhdim. |

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Në këtë fazë, nxënësit do të përgjigjen duke plotësuar fjalitë e mëposhtme:

**a.** Parthenoni njihet si simbol i ____________________________________

**b.** Simbol i qytetërimit antik romak është ____________________________________

**c.** Qyteti i Bylisit, simbol i qytetërimit antik ____________________________________

**d.** Piramidat egjiptiane u ndërtuan ____________________________________

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Kërkoni të dhëna në internet në këtë adresë: https:/whc.unesco.org/en/list/ dhe gjeni monumente antike në vendin tonë, të mbrojtura nga UNESKO.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt. ______________________**

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: II | Klasa: V |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Arritjet e qytetërimeve antike në shkencë | **Situata e të nxënit:**<br>**Parimi i Arkimedit**<br>Mendohet të ketë zbuluar parimin e dendësisë dhe pluskimit, i njohur si "Parimi i Arkimedit", që sipas gojëdhënës, e zbuloi ndërsa ai po lahej në vaskë (doli jashtë nëpër rrugë duke bërtitut "Eureka" (e gjeta). | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Rendit** arritjet në shkencën natyrore të qytetërimeve antike.<br>**2. Përshkruan** format e arritjeve të shkencave shoqërore.<br>**3. Vlerëson** arritjet e shkencës në zhvillimin e qytetërimeve botërore. | **Fjalë kyçe:** shkenca, balsamimi, sumerët, egjiptianët, Pitagora, Tukiditi, filozofia | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore:** harta, teksti mësimor, internet, album fotografish të qytetërimeve antike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, Matematika | | |
| **Metodolologjia:** Hartë konceptesh, shpjegim termash, diskutim. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Lexohet në klasë situata e të nxënit si më poshtë dhe diskutohet nëse nxënësit kanë dëgjuar më parë për arritjet shkencore të njerëzve në lashtësi.

***Parimi i Arkimedit***

*Mendohet të ketë zbuluar parimin e dendësisë dhe pluskimit, i njohur si "Parimi i Arkimedit", që sipas gojëdhënës, e zbuloi ndërsa ai po lahej në vaskë (doli jashtë nëpër rrugë duke bërtitut "Eureka" (e gjeta).*

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë në mënyrë të pavarur këto çështje, mbështetur në këto pyetje:

Cilat ishin arritjet e sumerëve?

Përse tek egjiptianët kalendari ishte shumë i rëndësishëm?

Përse dallohen grekët e antikitetit në arritjet e tyre shkencore?

Përse shkrimi është një arritje shumë e rëndësishme për shkencat shoqërore?

Cilat ishin format e shkrimit që u zhvilluan në antikitet?

| | | |
|---|---|---|
| Shkenca në antikitet | Shkencat shoqërore | **Sumerët** krijuan dijet e para të astronomisë.<br>**Egjiptianët** hartuan kalendarin e parë diellor. Zhvilluan matematikën, kiminë, mjekësinë. Ata balsamosnin të vdekurit.<br>**Grekët antikë** shpjeguan në mënyrë shkencore dukuritë natyrore. |
| | Shkencat natyrore | **Shpikja e shkrimit** për nevojat e mbajtjes së shënimeve. Kanë përdorur shenja (simbole) ku veçojmë atë kuneinform dhe hieroglif.<br>**Historia** lindi në Greqi. Herodoti konsiderohet "babai i historisë". Tukiditi i shpjegon ngjarjet duke u mbështetur në dokumente e dëshmi.<br>**Filozofia** përpiqej të shpjegonte çfarë ndodhte në botë. Sokrati është filozofi më i njohur i antikitetit. |

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):** Situata duhet realizuar nga nxënësi/ja.
**1.** Tregoni dy arritje të qytetërimeve antike.
**2.** Përmendni dy forma të shkrimit në antikitet.
**3.** Ku dallojnë Herodoti dhe Tukiditi në të shkruarit të historisë?

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.

**Detyra dhe punë e pavarur**
Kërkoni të dhëna duke pyetur më të rriturit ose në internet dhe mësoni për Herodotin. Shkruani pesë fjali për të.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore:**<br>Figura historike të qytetërimeve antike | **Situata e të nxënit:**<br>Figurat historike të qytetërimeve antike janë të shumta. Ju do të mësoni disa prej tyre. | | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit:**<br>**Nxënësi:**<br>1. **Përmend** disa nga figurat më të njohura historike të lashtësisë.<br>2. **Përshkruan** kontributin e figurave historike në qytetërimin e antikitetit.<br>3. **Vlerëson** veprimtarinë e figurave historike. | **Fjalë kyçe:** Hamurabi, Buda, Konfuci, Homeri, Pitagora, Perikliu, Platoni, Aristoteli, Aleksandri i Madh, Pirro i Epirit, Virgjili, Ciceroni, Oktavian Augusti | | |
| **Burimet dhe mjetet mësimore**:<br>harta, teksti mësimor, interneti, album fotografish të qytetërimeve antike dhe figurave historike, ***Fletore pune vetëvlerësimi "Historia 5"*** | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>Gjuhët dhe komunikimi, Arti figurativ, Qytetaria, TIK | | |
| **Metodolologjia:** Shpjegim, tabela e koncepteve, lexim i drejtuar. | | | |

**Organizimi i orës së mësimit:**

Mësuesi/ja u tregon nxënësve se figurat historike janë të shumta dhe në temën e sotme ata do të mësojnë disa prej tyre. Ai/ajo udhëzon nxënësit që të bëjnë lidhjen e figurave të tekstit mësimor me tekstet ku ata përshkruhen.

Për të mundësuar dhe qartësuar më mirë figurat historike, rekomandohet të ndërtohet një tabelë përshkruese për figurat.

Në këtë fazë, mësuesi, pasi ndërton tabelën e mëposhtme, pyet nxënësit të ndërlidhin fotot e vendosura me figurën historike.

| **Figura historike** | **Kontributi i tij historik në qyetërimin e antikitetit** |
|---|---|
| **Hamurabi** | Mbreti i Babilonisë. Është i njohur në histori për hartimin e ligjeve që njihen si Kodi i Hamurabit. Kodi ishte një përpjekje e rëndësishme për të vendosur rregulla të sjelljes në shoqëri. Ai përbëhej nga 282 ligje, të gdhendura në pllaka argjile. Ligjet e shoqërive të sotme bazohen në Kodin e Hamurabit. |
| **Buda** | Njeriu i "ndriçuar" i qytetërimit antik indian. Njihet si krijues i budizmit, besim fetar që mori emrin e tij. Buda kuptoi se jeta e njeriut nuk duhet të jetë as në luks dhe as në varfëri. |
| **Konfuci** | Mendimtari më i shquar i qytetërimit antik kinez. Njihet si politikan, qeveritar, mësues dhe filozof. Ai mendonte se njerëzit duhet të shpërbleheshin sipas aftësive të tyre. |

| | |
|---|---|
| **Homeri** | Njihet si shkrimtari më i shquar i Greqisë antike. Ai ka shkruar dy libra të famshëm: "Iliadën" dhe "Odisenë". Ato janë histori të mrekullueshme, që ende lexohen edhe sot. |
| **Pitagora** | Matematikan dhe mendimtar i Greqisë antike. Njihet për krijimin e teoremës së trekëndshave këndrejtë. |
| **Perikliu** | Drejtues i shquar i qytet – shtetit të Athinës antike dhe gjeneral. Shquhet në histori se kërkoi një demokraci, ku shumica e qytetarëve të vendoste për qeverisjen. Ai vendosi për ndërtimin e Parthenonit dhe e shndërroi Athinën në qendrën politike dhe kulturore të Greqisë antike. |
| **Platoni dhe Aristoteli** | Ishin filozofë të shquar të Greqisë antike. Platoni themeloi Akademinë e famshme të Athinës. Aristoteli pohonte se Toka rrotullohej rreth Diellit dhe jo Dielli rreth Tokës. |
| **Aleksandri i Madh** | Mbret i Maqedonisë antike. Përhapi kulturën helene në Azi dhe Afrikë. Ai themeloi qytete, ku më i famshmi ishte qyteti i Aleksandrisë në Egjipt. Ishte një ushtarak i zoti dhe nuk humbi asnjë betejë. |
| **Pirro i Epirit** | Mbret i Epirit. Ishte një nga udhëheqësit ushtarakë më të shquar të qytetërimit ilir. Ai mbante një përkrenare me dy brirë cjapi. |
| **Ciceroni** | Shkrimtar, politikan dhe orator i njohur i Romës antike. La të shkruara shumë prej fjalimeve të tij, që ende lexohen edhe sot. |
| **Virgjili** | Shkrimtar i shquar i Romës antike. U bë i njohur për poemën e tij "Eneida", e cila tregon se si filloi qytetërimi antik romak. |
| **Oktavian Augusti** | U bë perandori i parë i Perandorisë Romake. Me sundimin e tij fillon periudha që njihet si "Paqja Romake". Muaji gusht ka marrë emrin e tij. |

**Përforcimi (konsolidimi i të nxënit):**
**1.** Vlerësoni një prej figurave më të shquara historike të qytetërimeve të hershme antike.
**2.** Vlerësoni një prej figurave më të shquara historike të qytetërimeve të reja antike.

**Vlerësimi:** Vlerësimi i nxënësit mbështetet në përgjigjet e dhëna dhe aktivizimin në orën e mësimit.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Zgjidhni një cilësi të një figure të shquar historike të përshkruar në mësim. Shkruani pse e pëlqeni.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore: Veprimtari praktike Nr. 3**<br>Lindja dhe përdorimi i kalendarit | | **Situata e të nxënit:**<br>Çdo familje sot e përdor kalendarin. Po edhe ju vetë e përdorni atë. Për çfarë ju ndihmon kalendari? | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Kërkon, përshkruan** dhe **krahason** lloje të kalendarëve, që janë hartuar nga popuj të ndryshëm gjatë historisë.<br>**2. Paraqet** me anë të fotografive, posterave punën për kalendarët.<br>**3. Mbledh** kuriozitete për nevojën që kishin njerëzit për të ndryshuar kalendarët. | | **Fjalë kyçe:** kalendar, kalendari i actekëve, kalendari gregorian, egjiptianët, majatë | |
| **Mjetet dhe burimet:**<br>letër, lapsa me ngjyra, ngjitës, interneti, fjalorë | | **Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK | |

**Metodologjia:** Brainstorming, punë në grupe, diagrama e Venit.

**Organizimi i orës së mësimit:**

**Hapi I:** Mësuesi/ja pyet nxënësit: Sa lloje të kalendarëve njihni? Shkruan në tabelë të gjitha përgjigjet e mundshme të nxënësve

**Hapi II**: Mësuesi/ja ndan klasën në 3 grupe pune për realizimin e veprimtarisë:

Secili grup do të ketë katër kalendarë, tre të popujve antikë dhe kalendarin që përdorim sot.

Udhëzon nxënësit të diskutojnë në grup për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve:

**1.** Pse u krijua kalendari?
**2.** Cilat janë llojet e ndryshme të kalendarëve?
**3.** Pse quhet gusht muaji i tetë i vitit?
**4.** Cili qytetërim e shpiku kalendarin që përdorim sot?
**5.** Pse ndryshuan kalendarët?

**Hapi III:**

| **Të veçantat e çdo kalendari** | **Të përbashkëtat** |
|---|---|
| | |

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për burimet që shfrytëzojnë, materialin që përzgjedhin dhe mënyrën e shfrytëzimit të materialit duke u bazuar në kërkesat e dhëna.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Nuk parashikohen.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori</td><td>Shkalla: II</td><td>Klasa: V</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Veprimtari praktike Nr. 4<br>Qyteterimi ilir</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Cili prej jush ka vizituar një qytet ilir? Çfarë veçorish ka ai?</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>Nxënësi:<br>1. Përshkruan pamjen dhe historinë e një qyteti.<br>2. Përshkruan festimet, lojërat, veshjet, stolitë, traditat dhe ritualet e ndryshme, që janë zhvilluar në kohët e qytetërimit ilir dhe që i praktikojmë dhe sot.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe: monument historik, ilir, Iliri, mbretëri ilire etj.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Mjetet dhe burimet:<br>plastelinë, letër, lapsa me ngjyra, kompjuter, videoprojektor</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi, TIK</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia: Brainstorming, punë në grupe, diskutim.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Organizimi i orës së mësimit:<br>Hapi I: A ka qenë një vendbanim ilir qyteti ynë? Çfarë dini ju për këtë?<br>Hapi II: Mësuesi/ ja ndan klasën në grupe pune për realizimin e veprimtarisë:<br><br>Grupi 1 - Secili anëtar i grupit rikrijon pamjen e qytetit Ilir më të afërt me vendndodhjen e shkollës në formën e një maketi me plastelinë. Më pas, shkruan një informacion të shkurtër në maket (emri i qyetit, koha e krijimit, vendndodhja).<br>Grupi 2- Secili anëtar i grupit zgjedh të përshkruajë një festë, një lojë ilire që praktikohet edhe sot.<br>Grupi 3- Secili anëtar i grupit zgjedh të vizatojë një veshje, stoli ilire.<br><br>Hapi III: Pasi nxënësit kanë punuar pikat sipas grupit respektiv, fillojnë të diskutojnë idetë e tyre, të shkëmbejnë mendime, ide, sugjerime se çfarë mësuan të re dhe çfarë njohurish zotëronin.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për burimet që shfrytëzojnë, materialin që përzgjedhin dhe mënyrën e shfrytëzimit të materialit duke u bazuar në kërkesat e dhëna.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyra dhe punë e pavarur: Nuk parashikohen.</td></tr>
</table>

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ______________________

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori | Shkalla: II | Klasa: V |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **Tema mësimore: Veprimtari praktike Nr. 5**<br>Qytetërimet antike botërore | **Situata e të nxënit:**<br>Nëse dikush do t'ju kërkonte t'i sugjeronit për të vizituar një qytetërim të vjetër, cilin do t'i sugjeronit dhe përse? |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Mbledh** të dhëna për mënyrën e jetesës (veshjet, ndërtimet, veprat e artit) në qytetërimet antike.<br>**2. Përshkruan** ndarjen e shoqërive antike në bazë të faktorëve ekonomikë dhe politikë. | **Fjalë kyçe:** qytetërim antik, kuneiform, hieroglife |
| **Mjetet dhe burimet:**<br>letër, teksti, fjalor enciklopedik | **Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK |

**Metodologjia:** Parashikim me terma paraprake, punë në grupe, diagrami i Venit.

**Organizimi i orës së mësimit:**

**Hapi I:** Do të ndalemi te qytetërimi egjiptian dhe ai i Mesopotamisë. Mësuesi/ ja shkruan në tabelë të dy termat dhe kërkon nga nxënësi t'i plotësojnë ato sipas udhëzimeve më poshtë.

**Hapi II**: Mësuesi/ ja ndan klasën në grupe pune për realizimin e veprimtarisë:

**Grupi 1**- Ndërton shtresëzimin politik dhe social për të dy qytetërimet.

**Grupi 2**- Gjen foto, vizatime për ndërtimet, veshjet si dhe materiale të shkruara për to.

**Grupi 3**- Vizaton si e përfytyron një të varfër dhe një të pasur në një qytetërim të caktuar antik dhe e emërton atë.

**Grupi 4**- Krijon një poster ose album me të dhënat e mbledhura.

**Hapi III:** Udhëzoj nxënësit të plotësojnë Diagramin e Venit për këto dy qytetërime, duke evidentuar të përbashkëtat dhe të veçantat.



**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për burimet që shfrytëzojnë, materialin që përzgjedhin dhe mënyrën e shfrytëzimit të materialit duke u bazuar në kërkesat e dhëna.

**Detyra dhe punë e pavarur:** Të kërkojnë të dhëna për qytetërimin grek dhe romak.

**Planifikimi i orës mësimore** **Dt.** ________________________

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori** | **Shkalla: II** | **Klasa: V** |
|---|---|---|---|
| **Tema mësimore: Projekt kërkimor. Ora e tretë.**<br>**Paraqitja e rezultateve për temën:**<br>Familja nga antikiteti deri sot | | **Situata e të nxënit:**<br>Bashkëbisedim, shkëmbim eksperiencash**.** | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës** | | **Fjalë kyçe:** tradita kulturore, shqyrtim materialesh, përzgjedhje materialesh | |

| | |
|---|---|
| **Sipas temës mësimore:**<br>**Nxënësi:**<br>**1. Paraqet** rezultatet e punës në mënyrë të saktë dhe bindëse para klasës, shkollës, mësuesve dhe prindërve.<br>**2. Është** i përpiktë me kohën në paraqitjen e projektit. | **Lidhja me fushat e tjera dhe me tema ndërkurrikulare:** Gjuhët dhe komunikimi, TIK |
| **Mjetet dhe burimet:** kompjuter, laptop, videoprojektor | |
| **Metodologjia:** Prezantim paraprak, punë në grupe, diskutim. | |
| **Organizimi i orës së mësimit:**<br>**Hapi I:** Gjatë zhvillimit të orës së fundit të projektit, prezantoj paraprakisht përpara nxënësve, mësueve, prindërve qëllimin dhe fazat e ndjekura për realizimin e tij dhe sugjeroj nxënësit që punimet e kryera në formë posterash, albumesh, ekspozitash, raportesh t'i paraqesin në një kënd të dukshëm në klasë. Ndërsa grupet e nxënësve që kanë punuar me videoprojektor, fillojnë me prezantimin.<br>**Hapi II:** Nxënësit individualisht ose me përfaqësues grupi(nëse puna është bërë në grup),fillojnë paraqitjen e rezultateve, sipas një rradhe koordinimi të vendosur në fillim të orës mësimore.<br>**Hapi III**: Të ftuarit, por jo vetëm, mund të shfaqin interes për të bërë pyetje të ndryshme lidhur me mënyrën e përzgjedhjes së materialeve, burimet e përdorura, histori konkrete familjare etj.<br><br>Nxënësit duhet të jenë të gatshëm t'u përgjigjen në çdo moment dhe të ofrojnë bashkëpunim në diskutim. | |
| **Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për burimet që shfrytëzojnë, materialin që përzgjedhin dhe mënyrën e shfrytëzimi të materialit duke u bazuar në kërkesat e dhëna. Vlerësim me notë dhe fjalë motivuese. | |
| **Detyra dhe punë e pavarur:** Nuk parashikohen. | |

<table>
<tr><td colspan="2">Vlerësimi i porfolit për periudhën ___________________<br>Emri i mësuesit ___________________________________<br>Emri i nxënësit:__________________________________</td><td>Data</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lënda: Histori V</td><td></td></tr>
<tr><td>Elementi përbërës i portofolit</td><td>Afati i përfundimit nga nxënësi</td><td>Pesha e secilit element</td></tr>
<tr><td>PUNË HULUMTUESE</td><td></td><td>25 pikë</td></tr>
<tr><td>DETYRË KLASE</td><td></td><td>25 pikë</td></tr>
<tr><td>PUNË KRIJUESE</td><td></td><td>25 pikë</td></tr>
<tr><td>DETYRE SHTËPIE</td><td></td><td>25 pikë</td></tr>
</table>

**Emri i mësuesit:**_______________________________

**Data:**___/____/______

**Lënda: Histori V**

**Kriteret për vlerësimin e "Portofoli i të nxënit - Historia 5"**

| |
|---|
| **1.** Përpjekja (Nxënësi shpenzon kohë dhe energji për ta bërë portofolin të rregullt, tërheqës, krijues.) |
| **2.** Rritja/progresi (Detyrat e nxënësit prezantojnë progres në përmbushjen e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve.) |
| **3.** Plotësimi (Puna e nxënësve reflekton produkte të përfunduara.) |
| **4.** Organizimi (Nxënësit e organizojnë përmbajtjen e portofolit në mënyrë sistematike.) |
| **5.** Saktësia (Puna e nxënësve demonstron përvetësimin e aftësive të lëndës.) |
| **6.** Përdorimi i gjuhë së saktë dhe pa gabime në të shkruar. |
| **7.** Integrimi me TIK |
| **8.** Origjinaliteti për detyrat krijuese dhe projektet |
| **9.** Zbatimi i udhëzimeve të mësuesit për numrin e detyrave në portofol dhe realizimin e tyre. |
| **10.** Respektimi i afateve kohore (Nxënësi plotëson dhe dorëzon në kohë portofolin e plotësuar, sipas afatit të përcaktuar.) |
| **11.** Rezultatet e të nxënit (Nxënësit përmbushin rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyçe të përcaktuara në kurrikul.) |
| **12.** Prezantimi i produktit përfundimtar (Nxënësi realizon prezantimin e portofolit dhe argumenton përgjigjet për detyrat e realizuara. |

**Emri i mësuesit:**______________________

**Data:**______/______/____________

**Emri i nxënësit:**______________________

**Lënda: Histori V**

**Vlerësimi i portofolit të të nxënit për periudhën** _________________________

| Komponenti që vlerësohet | N.1 Nota 4 | N.2 Nota 5-6 | N.3 Nota 7-8 | N.4 Nota 9-10 | Komente |
|---|---|---|---|---|---|
| Detyra hulumtuese | | | | | |
| Detyrë klase | | | | | |
| Puna krijuese | | | | | |
| Detyrat e shtëpisë | | | | | |

**Totali i pikëve:**______________________________________________________

**Pika të forta:**______________________________________________________

**Pika të dobëta:**______________________________________________________

**Rekomandime:**______________________________________________________

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË**

**DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE__________**

**SHKOLLA – 9 VJEÇARE "            "**

PUNË ME PROJEKT

Klasa V

Viti shkollor___________

**Punoi: Mësuesi/ja** **Miratoi: Drejtor/e**

_________________________ _________________________

**Punë me projekt**

**Tema:** Familja nga antikiteti deri sot

**Synimi**

· Të njihen nxënësit me një përbërës të rëndësishëm të shoqërisë sonë nga fillesat e familjes deri tek evoluimi në ditët e sotme.
· Të rendisin kronologjikisht ndryshimet më thelbësore që ka pësuar familja në periudha të ndryshme (Antikitet, Mesjetë, Kohët Moderne).
· Të japin mendimin e tyre lidhur me rëndësinë që ka familja për një shoqëri.
· Të shkruajnë ese, poezi, proza të ndryshme për rëndësinë e familjes si koncept shoqëror.
· Të vizatojnë momente të rëndësishme nga koha e tyre e fëmijërisë dhe rritjes ose të pjesëtarëve të familjes se tyre në vite.

**Qëllimi**

· Të aktivizohen nxënësit për të bërë projekt.
· Të zhvillojnë konkurse midis tyre.
· Të mësojnë nxënësit të menaxhojnë një veprimtari.
· Të menaxhojnë buxhetin e një veprimtarie.

**Orë në dispozicion: 3 orë**

**Objektivat e projektit**
**Çdo nxënës të arrijë:**

· Të ndërtojë në mënyrë kronologjike zhvillimin e familjes që nga Antikiteti e deri sot.
· Të japë argumente të arsyetura rreth kushteve që kanë ndikuar për ndryshimin e vazhdueshëm të rëndësisë së familjes.
· Të arrijë të bëjë ndryshimin e familjes patriarkale me atë matriarkale.
· Të njohë dhe zbërthejë konceptin “familje e hapur”, “familje e mbyllur”.
· Të ndërtojë pemën gjenealogjike të familjes së tij/saj.
· Të pregatitë një kënd me foto të spikatura të familjes së tij.
· Të shkruajë ese.
· Të ekspozojë punimet e veta përpara nxënësve të tjerë.
· Të shfaqë me projektor punimin e kryer.

**Përshkrimi i punës**

Nxënësit ndahen në grupe pune dhe çdo grup do të ketë detyra të caktuara, të cilat do të zgjidhen nga objektivat e projektit.

**Literatura e rekomanduar dhe shfrytëzuar**

· Teksti shkollor
· Materiale të trashëguara nga familjarët
· Muzeu Kombëtar
· Muzeu Etnografik
· Histori gojore

**Plani i veprimtarive**
**Kohëzgjatja e projektit Tetor-Maj**

**Tetor –** Miratohet projekti dhe ndahen detyrat për çdo grup. Puna drejtohet nga një grup, në të cilin bën pjesë mësuesi.

**Nentor –** Konsultë me grupet e punës. Grupi i punës informohet nga kryetari i çdo grupi për materialet që kanë grumbulluar, për pengesat që kanë hasur dhe merr detyra për të ardhmen.

**Dhjeto**r **–** Diskutohet rreth materialeve të grumbulluara për çdo grup. Orientohen për vazhdimin e punës kërkimore në bibliotekë, internet, muze, rrëfimet personale etj.

**Janar –** Vazhdon puna sistemuese e materialeve të grumbulluara.

**Shkurt –** Grupet mund të krijojnë albume me pamje të familjes nga Lashtësia, Mesjeta, Rilindja dhe Koha Moderne. Sjellin vizatime, poezi, ese, vlerësime të tyre për punët e bëra. Nxënësit nxiten që ta pasurojnë punën e tyre me punime specifike për temën, në mënyrë që kur të bashkojnë të gjitha materialet, projekti të jetë i plotësuar.

**Mars –** Secili grup përcakton detyrat brenda grupit. Ata vlerësojnë punimet e njëri – tjetrit, të cilave mund t'u përgjigjen ose t'i përgatitin përgjigjen brenda një afati që i lënë njëri – tjetrit për të dorëzuar draftin përfundimtar.

**Prill –** Nxënësit kanë sistemuar dhe hedhur në draftet e tyre përfundimtare të gjitha materialet, si: harta, pamje filmike, foto, vizatime, ese, poezi, materiale orgjinale. Përcaktohet dita ceremoniale e promovimit të projektit dhe hartohet një plan masash për të ndjekur të gjitha hapat që duhet.

**Maj –** Dita e promovimit të projektit. Kjo ditë merr vlera festive. Ftohen nxënës nga klasat e tjera, mësues, prindër nga komuniteti. Kjo ceremoni do të organizohet sipas programit, ku mund përfshihen:

**1-** Ekspozitë me punimet e nxënësve
**2-** Konkurse midis klasave
**3-** "Konferencë shkencore" ku nxënësit do të paraqesin punimet e tyre
**4-** Interpretimi i projektit me anë të video-projektorit

**Buxheti**

Për zhvillimin me sukses të këtij projekti, kërkohet një buxhet, prandaj që në fillim llogariten nevojat dhe se si do të përballohen ato.

Puna dhe kontributi i nxënësve llogariten me buxhet si vlerë.

Për këtë:

**1-** Çdo grup evidenton veprimtaritë që do të bëjë dhe llogaritë, koston për shpenzimet që kërkon çdo veprimtari.

**2-** Llogariten shpenzimet për letër, bojë, fotokopje, kartona, internet etj.

**Prezantimi i projektit:**

**Materialet që do të përdoren:** Për prezantimin e punimeve duhet të sigurohet baza materiale, si: video-projektorit, DVD etj.

**Hapi I:** Konferencë shkencore, ku nxënësit prezantojnë punimin e projektit.

**Hapi II:** Përdorimi i videoprojektorit me materialet e grumbulluara që lidhen me këtë projekt.

**Hapi III:** Vlerësimet e pjesëmarrësve.

**Test 1** **Grupi A**

Emër Mbiemër ___________________________________

Data ___________________________________

Klasa ___________________________________

**1. Përkufizoni konceptet kyçe.**

**a.** Histori______________________________________________(1 **pikë)**

**b.** Historian____________________________________________(1 **pikë)**

**c.** Hartë historike_______________________________________(1 **pikë)**

**d.** Dekadë_____________________________________________(1 **pikë)**

**e.** Para erës sonë (p.e.s.)________________________________(1 **pikë)**

**2. Plotësoni tabelën e mëposhtme.** **(6 pikë)**

| **Përkufizoni** | **Burime parësore** | **Burime dytësore** |
|---|---|---|
| **Karakteristikat** | | |
| **Shembuj** | | |

**3. Plotësoni boshtin numerik sipas linjës kronologjike (p.e.s - e.s).** **(5 pikë)**

| **Viti 20 p.e.s.** | | **e.s.** | **Viti 20** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| **0** | | | |

**4. Plotësoni fjalinë.** **(4 pikë)**

**a.** Historiani, për të shkruar historinë e së shkuarës, mbështetet ____________________________

______________________________________________________________________________

**b.** Portreti origjinal i Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, gjendet ______________

______________________________________________________________________________

**5. Formoni një pesëvargësh për FAMILJEN.** **(5 pikë)**

________________________

_____________________ _______________________

____________________ ________________________ ______________________

__________________________________________________________________

_________________________

| **Pyetje** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 5 | 6 | 5 | 4 | 5 |

| **Nota** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |

**Test 1** **Grupi B**

Emër Mbiemër ________________________________

Data ________________________________

Klasa ________________________________

**1. Përkufizoni konceptet kyçe.**

**a.** Linjë kohore________________________________(1 **pikë)**

**b.** Shekull________________________________(1 **pikë)**

**c.** Burim historik________________________________(1 **pikë)**

**d.** Mijëvjeçar________________________________(1 **pikë)**

**e.** Pas erës sonë (p.e.s)________________________________(1 **pikë)**

**2. Plotësoni tabelën e mëposhtme me vitet dhe shekujt përkatës** *para erës sonë* **dhe** *erës sonë***.**

**(6 pikë)**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Shek. I ( - ) p.e.s. | Shek. I ( - ) e.s. | Shek. II ( - ) p.e.s. | Shek. VII ( - ) e.s. |
| Shek. IV ( - ) p.e.s. | Shek. VI ( - ) p.e.s. | Shek. X ( - )e.s. | Shek. XX ( - ) e.s. |

**3. Plotësoni tabelën më të dhëna për burimet historike.** **(5 pikë)**



**4. Plotësoni fjalinë.** **(4 pikë)**

**a.** Burimet historike bëhen prova kur ________________________________________________

**b.** Parahistoria filloi ______________________________ milionë vjet më parë dhe përfundoi rreth ________________________

**c.** Ne jetojmë në fillim të mijëvjeçarit të ______________________________

**5. Ndërtoni dhe plotësoni një tabelë për periudhat historike nga parahsitoria deri në periudhën bashkëkohore.** **(5 pikë)**

| Pyetje | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|
| Pikët | 5 | 6 | 5 | 4 | 5 |

| Nota | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pikët | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |

**Test 2** **Grupi A**

Emër Mbiemër ___________________________________

Data ___________________________________

Klasa ___________________________________

**1. Përkufizoni konceptet kyçe.**

**a.** Australopitekë ___________________________________ **(1pikë)**

**b.** Homo erectus ___________________________________ **(1pikë)**

**c.** Nomadë___________________________________ **(1pikë)**

**d.** Matriarkat___________________________________ **(1pikë)**

**e.** Kulturë___________________________________ **(1pikë)**

**f.** Pellazgë___________________________________ **(1pikë)**

**2. Plotësoni tabelën e mëposhtme.** **(5 pikë)**

Evidentoni tiparet e shoqërisë njerëzore në:

| | |
|---|---|
| **Paleolit** | |
| **Neolit** | |
| **Koha e metaleve** | |

**3. Plotësoni fjalinë.** **(4 pikë)**

**a.** Njerëzit e parë u shfaqën pikërisht në ____________________ ku klima ishte e ngrohtë dhe ushqim i bollshëm.

**b.** Skelete të homosapiensit janë gjetur në shpellën e ______________________ në jug të Francës dhe të ____________________

**c.** Vendbanimet më të hershme të qyteterimit Ilir gjenden në _______________________________

**4. Plotësoni Diagramin e Venit.** **(5 pikë)**




**5. Listoni vendbanimet e kohës së gurit në truallin shqiptar.** **(5 pikë)**

| Pyetje | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|
| Pikët | 6 | 5 | 4 | 5 | 5 |

| Nota | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pikët | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |

**Test 2** **Grupi B**

Emër Mbiemër ____________________________________

Data ____________________________________________

Klasa ___________________________________________

**1. Përkufizoni konceptet kyçe:**

**a.** Homo ergaster ______________________________________________________________**(1pikë)**

**b.** Homo sapiens ______________________________________________________________**(1pikë)**

**c.** Paleolit ___________________________________________________________________**(1pikë)**

**d.** Koha e metaleve_____________________________________________________________**(1pikë)**

**e.** Patriarkat_________________________________________________________________**(1pikë)**

**f.** Kulturë____________________________________________________________________**(1pikë)**

**2. Plotësoni tabelën, duke përshkruar rolin e gruas në:** **(5 pikë)**

| | |
|---|---|
| **Paleolit** | |
| **Neolit** | |
| **Koha e metaleve** | |

**3. Plotësoni fjalinë.** **(4 pikë)**

**a.** Periudha e akullnajave mori fund në _____________________, kur klima filloi _______________

**b.** Me ___________________________________, njerëzit filluan të merreshin me punë të caktuara.

**c.** Koha kur mjetet kryesore të punës u bënë prej metali, u quajt _________________________, çoi në lindjen e qytetërimit.

**4. Plotësoni Diagramin e Venit.** **(5 pikë)**




**6. Listo vendbanimet e kohës së gurit në truallin shqiptar.** **(5 pikë)**

| Pyetje | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|
| Pikët | 6 | 5 | 4 | 5 | 5 |

| Nota | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pikët | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |

**Test 3** **Grupi A**

Emër Mbiemër ____________________________________

Data ______________________________________________

Klasa _____________________________________________

**1. Përkufizoni konceptet kyçe:**

**a.** Qytetërim_______________________________________________**(1pikë)**
**b.** Tigër dhe Eufrat ________________________________________**(1pikë)**
**c.** Qytet-shtete ___________________________________________**(1pikë)**
**d.** Hieroglife_____________________________________________**(1pikë)**
**e.** Balsamim ______________________________________________**(1pikë)**
**f.** Kodi i Hamurabit________________________________________**(1pikë)**

**2. Plotësoni fjalinë.** **(4 pikë)**

**a.** Monumentet më të rëndësishme janë _____________ të ndërtuara nga _________________, rreth 5 mijë vjet më parë.

**b.** Monumenti më i rëndësishëm i qytetërimit romak është ___________________________________ ________________________

**3. Plotësoni tabelën.** **(6 pikë)**

| | **Vendi ku lindi dhe u zhvillua** | **Koha** | **Arritjet më të rëndësishme** | **Figura historike që kanë dhënë kontribut** |
|---|---|---|---|---|
| Qytetërimi i Mesopotamisë | | | | |
| Qytetërimi egjiptian | | | | |

**4. Ndërtoni piramidën e shoqërisë egjiptiane.** **(4 pikë)**



**5. Renditni disa prej fiseve ilire që krijuan mbretëritë e tyre, duke evidentuar mbretërit e tyre dhe shtrirjen gjeografike. (5 pikë)**

| **Pyetje** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 5 | 6 | 5 | 4 | 5 |

| **Nota** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |

**Test 3** **Grupi B**

Emër Mbiemër ________________________________

Data ________________________________________

Klasa _______________________________________

**1. Përkufizoni konceptet kyçe:**

**a.** Faraoni__________________________________________________________________**(1pikë)**

**b.** Shkrimi kuneiform _______________________________________________________**(1pikë)**

**c.** Koloseu_________________________________________________________________ **(1pikë)**

**d.** Tuma___________________________________________________________________**(1pikë)**

**e.** Monumenti i kulturës _____________________________________________________**(1pikë)**

**f.** Kalendari_______________________________________________________________**(1pikë)**

**2. Plotësoni fjalinë.** **(3 pikë)**

**a.** Monumentet më të rëndësishme janë piramidat e ndërtuara nga ________________________ rreth ______________ vjet me parë.

**b.** _______________ filloi të ndërtohej në shek. VII p.e.s për të mbrojtur vendin nga pushtimet.

**c.**________________, mbret i Babilonisë, është i njohur në histori për hartimin e _____________ . Kodi përbëhej nga _______________ ligje, të gdhendura ______________________

**3. Plotësoni tabelën.** **(6 pikë)**

| | Vendi ku lindi dhe u zhvillua | Koha | Arritjet më të rëndësishme | Figura historike që kanë dhënë kontribut |
|---|---|---|---|---|
| Qytetërimi antik grek | | | | |
| Qytetërimi antik romak | | | | |

**4. Listoni veçoritë e qytetërimeve më të hershme. (5 pikë)**

**a.** ______________________________

**b.**______________________________

**c.**______________________________

**d.**______________________________

**e.** ______________________________

**5. Argumentoni rëndësinë që kishte arsimimi dhe edukimi i fëmijëve në qytetërimin ilir. (5 pikë)**

______________________________
______________________________
______________________________
______________________________
______________________________
______________________________
______________________________
______________________________
______________________________

| **Pyetje** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 6 | 3 | 6 | 5 | 5 |

| **Nota** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |

**Test 1- Çelësi i përgjigjes**
**Grupi A**

**1- Përkufizoni konceptet kyçe. (5 pikë)**

**a. Historia është** shkenca që studion jetën e njerëzve në të shkuarën, e cila përdor tregimin për të zbuluar dhe analizuar kohën kur kanë ndodhur ngjarjet, vendin, shkaqet dhe pasojat e tyre. Ajo kërkon të shpjegojë se si jeta e njerëzve ka ndryshuar, por edhe se si ajo ka mbetur e njëjtë.

**b. Historiani** është një njeri që bën kërkime historike dhe shkruan për të kaluarën e njerëzimit, duke shpjeguar ngjarjet e të sotmes.

**c. Harta historike** pasqyron një situatë ose një ngjarje historike. Ajo tregon vendet ku kanë ndodhur ngjarjet në një periudhë të caktuar. Në një hartë historike gjejmë edhe elemente të veçorive natyrore të vendeve ku janë zhvilluar ngjarjet.

**d. Dekada** është një periudhë kohore prej 10 vitesh.

**e. Para erës sonë (p.e.s.)** përdoret për të treguar periudhën kohore para vitit 1.

**2- Plotësoni tabelën e mëposhtme. (6 pikë)**

| **Përkufizoni** | **Burime parësore** | **Burime dytësore** |
|---|---|---|
| **Karakteristikat** | Dokument apo objekt fizik që është shkruar ose është krijuar gjatë kohës që e shqyrton historiani. Ato janë krijuar nga dëshmitarë që kanë qenë pjesëmarrës në ngjarje. | Dokument apo objekt fizik që është shkruar dhe është krijuar duke u mbështetur në burime parësore apo origjinale. Burimet dytësore mbështeten në burimet parësore për të shkruar historinë. |
| **Shembuj** | Autobiografitë, kujtimet, ditarët, dokumentet, vendbanimet, monedhat etj. | Libra, revista, gazeta, tekste të historisë, biografi, filma etj. |

**3- Plotësoni boshtin numerik sipas linjës kronologjike (p.e.s. - e.s.). (5 pikë)**

| **Viti 20** | **p.e.s.** | | | | | | | **e.s.** | **Viti 20** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | |

**4- Plotësoni fjalinë. (4 pikë)**

**a.** Historiani, për të shkruar historinë e së shkuarës, mbështetet në dokumente dhe fakte origjinale.

**b.** Portreti origjinal i Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, gjendet në muzeun Uffizi në Firence.

**5- Formoni një pesëvargësh për FAMILJEN. (5 pikë)**

Familja

E dashur e çmuar

Dua respektoj adhuroj

Familja është streha më e ngrohtë

Njerëzit më të shtrenjtë

| **Pyetje** | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pikë** | 5 | 6 | 5 | 4 | 5 |

| **Nota** | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |

**Test 1 - Çelësi i përgjigjes**

**Grupi B**

**1- Përkufizoni konceptet kyçe.** **(5 pikë)**

**a. Linja kohore** është paraqitja grafike, në një radhë kronologjike, e një sërë ngjarjesh të rëndësishme të historisë së shoqërisë njerëzore, historisë së një vendi apo të historisë së jetës vetjake të një njeriu.

**b. Shekulli është** njësi matëse e kohës në histori që përfshin 100 vite.

**c. Burimi historik** është një burim që është i rëndësishëm për historinë e një vendi, për një komunitet të caktuar etj.

**d. Mijëvjeçari është** njësi matëse e kohës në histori që përfshin 1000 vite.

**e. Pas erës sonë (p.e.s.)** përdoret për të treguar periudhën kohore pas vitit 1.

**2- Plotësoni tabelën e mëposhtme me vitet dhe shekujt përkatës para erës sonë dhe pas erës sonë.** **(6 pikë)**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Shek. I<br>( 1 -  100) p.s. | Shek. I<br>( 100-  1) p.e.s. | Shek. II<br>(101 - 200) p.s. | Shek. VII<br>(601-700)  p.s. |
| Shek. IV<br>( 401 - 300)p.e.s. | Shek. VI<br>( 601-500)p.e.s. | Shek. X<br>( 901- 1000 ) p.s. | Shek. XX<br>( 1901- 2000) p.s. |

**3- Plotësoni tabelën më të dhëna për burimet historike.** **(5 pikë)**




**4- Plotësoni fjalinë.** **(4 pikë)**

**a.** Burimet historike bëhen prova kur me to merret historiani.

**b.** Parahistoria filloi  3 milionë vjet më parë dhe përfundoi përgjithësisht rreth 3500 vjet p.e.s.

**c.** Ne jetojmë në fillim të mijëvjeçarit të dytë.

**5- Ndërtoni dhe plotësoni tabelën për periudhat historike nga parahistoria deri në periudhën bashkëkohore. (5 pikë)**

| **Koha e Gurit Paleoliti-Mezoliti-Neoliti** | **Antikiteti** | **Mesjeta** | **Periudha moderne** | **Periudha bashkëkohore** |
|---|---|---|---|---|
| Paleoliti- 2 milionë -100.000 vjet p.e.s.<br>Mezoliti- 200.000-10.000 vjet p.e.s.<br>Neoliti- 10.000-4000 vjet p.e.s. | 3500 vjet p.e.s. -viti 476<br><br>3500 vjet shpikja e shkrimit nga sumerët | Viti 476-1492<br><br>v.476 rënia e Perandorisë Romake të Perëndimit | Viti 1492-1789<br><br>v. 1492 Krisotofor Kolombi zbuloi Amerikën | Viti 1789-sot<br><br>v.1789 filloi Revolucioni Francez |

| **Pyetje** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pikë** | 5 | 6 | 5 | 4 | 5 |

| **Nota** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |

**Test 2 - Çelësi i përgjigjeve**

**Grupi A**

**1. Përkufizoni konceptet kyçe.** **(6 pikë)**

**a. Australopiteku** është njeriu i parë, më i njohuri, skeletet e të cilit u zbuluan në Afrikë.

**b. Homo erectusi** është një lloj hominidi që mësoi të ecte drejt. Ai u largua i pari nga Afrika se nuk u përshtat dot në savanë.

**c. Nomadë quheshin** njerëzit e parë që lëvizën nga Afrika në vendet e tjera për të gjetur ushqim dhe kushte më të mira jetese.

**d. Matriarkati** është periudha kur gruaja ishte e rëndësishme në jetën e komunitetit ku jetonte.

**e. Kultura** përmbledh të gjitha mjetet dhe modelet e sjelljes së një shoqërie të krijuara në një vend e kohë të caktuar. Ajo trashëgohet nga njëri brez në tjetrin.

**f. Pellazgë** janë quajtur banorët që jetuan në kohën e neolitit dhe u forcuan si shoqëri në kohën e bronzit në gadishullin Ilirik dhe më gjerë (sot gadishulli I Ballkanit). Ata mendohet të jenë paraardhësit e ilirëve.

**2. Plotësoni tabelën e mëposhtme.** **(5 pikë)**

**Evidentoni tiparet e shoqërise njerëzore në:**

| | |
|---|---|
| **Paleolit** | Njerëzit jetonin në grupe. Bashkoheshin dhe ndaheshin sipas rrethanave. Lëviznin shpesh në kërkim të ushqimit. Bënin jetë nomade. Në këtë mënyrë, formuan komunitetet e para. |
| **Neolit** | Njerëzit kaluan nga gjuetia në zbutjen dhe shumimin e kafshëve. Lindi bujqësia dhe blegtoria dhe njerëzit filluan të merreshin me punë të caktuara. Krijuan vendbanimet e para, fshatrat. Filluan të shkëmbenin prodhime me njëri-tjetrin dhe lindi tregtia. |
| **Koha e metaleve** | U rrit prodhimi bujqësor dhe blegtoral në mënyrë të shpejtë. Vendbanimet u bënë të qëndrueshme. Njerëzit u grupuan në numër më të madh dhe ndërtuan qytete. Në krye të komuniteteve u vunë mbretërit. Koha e metaleve çoi në lindjen e qytetërimit. |

**3. Plotësoni fjalinë.** **(4 pikë)**

**a.** Njerëzit e parë u shfaqën pikërisht në Afrikë, ku klima ishte e ngrohtë dhe ushqimi i bollshëm.

**b.** Skelete të homo sapiensit janë gjetur në shpellën e Kromanjonit, në jug të Francës; në Neandertal (lugina e lumit Neander, afër Duseldorfit, Gjermani) etj.

**c.** Vendbanimet më të hershme të qytetërimit Ilir gjenden në Gajtan (Shkodër), në malin e Dajtit, në Xarë dhe Konispol(Sarandë), në Tren (Devoll) etj.

**4. Plotësoni diagramin e Venit.** **(5 pikë)**




**5. Listoni vendbanimet e kohës së gurit në truallin shqiptar**. **(5 pikë)**

Trualli i banuar sot nga shqiptarët filloi të popullohej që në kohën e paleolitit (mbi 100.000 vjet më parë). Vendbanimet më të hershme janë: Gajtan (Shkodër), malin e Dajtit, Xarë (Sarandë), Konispol etj.

Shpella të paleolitit në vendin tonë janë:

Lepenicë (Vlorë)

Tren (Devoll)

Konispol (Sarandë)

| **Pyetja** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 6 | 5 | 4 | 5 | 5 |

| **Nota** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pikët | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |

**Test 2 Çelësi**

**Grupi B**

**1. Përkufizo konceptet kyçe: (6 pikë)**

**a**. **Homo ergaster** janë quajtur hominidët që i mbijetuan savanës dhe që jetuan 1.5 milion vjet më parë.

**b. Homo sapiens** janë quajtur qeniet e para njerëzore më të zgjuara.

**c. Paleoliti** është quajtur periudha kohore e gurit të vjetër ose gurit të pagdhendur.

**d. Koha e metaleve** është quajtur periudha kohore kur njerëzit përdorën hekurin si burim parësor për prodhimin e veglave të punës dhe që daton rreth 4000 vjet p.e.s. Është koha kur lindën qytetërimet e para.

**e. Patriarkat** është quajtur periudha kohore kur pozitat drejtuese në familje dhe komunitet i kishte kryesisht burri.

**f. Kultura** përmbledh të gjitha mjetet dhe modelet e sjelljes së një shoqërie të krijuara në një vend e kohë të caktuar. Ajo trashëgohet nga njëri brez në tjetrin.

**2. Plotësoni tabelën, duke përshkruar rolin e gruas në: (5 pikë)**

| | |
|---|---|
| **Paleolit** | Si femrat, dhe meshkujt shkonin bashkë për gjueti kafshësh, peshkim apo punë të tjera. Femrat kujdeseshin për të vegjlit. |
| **Neolit** | Rolet gjinore ndryshuan. Gratë krahas punëve afër vendbanimit, merreshin edhe me bujqësi. Roli i tyre në komunitet u forcua. Kjo periudhë është quajtur matriarkat. |
| **Koha e metaleve** | Rolet gjinore ndryshuan. Meshkujt siguronin ushqimin kryesor në komunitet dhe kjo periudhë quhet patriarkat. Gratë iu përkushtuan më shumë familjës dhe punëve shtëpiake. |

**3. Plotëso fjalinë. (4 pikë)**

**a.** Periudha e akullnajave mori fund rreth 10.000 vjet më parë, kur klima filloi të ngrohej.

**b.** Me lindjen e bujqësisë dhe blegtorisë, njerëzit filluan të merreshin me punë të caktuara.

**c.** Koha kur mjetet kryesore të punës u bënë prej metali, u quajt koha e metaleve, çoi në lindjen e qytetërimit.

**4. Plotësoni diagramin e Venit.** **(5 pikë)**




**5. Listoni vendbanimet e kohës së gurit në truallin shqiptar.** **(5 pikë)**

Trualli, i banuar sot nga shqiptarët, filloi të popullohej që në kohën e paleolitit (mbi 100.000 vjet më parë). Vendbanimet më të hershme janë: Gajtan (Shkodër), mali i Dajtit, Xarë e Konispol (Sarandë) etj.

Shpella të paleolitit në vendin tonë janë:

Lepenicë (Vlorë)

Tren (Devoll)

Konispol (Sarandë)

| **Pyetja** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 6 | 5 | 4 | 5 | 5 |

| **Nota** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |

**Test 3 - Çelësi i përgjigjeve**

**Grupi A**

**1. Përkufizoni konceptet kyçe.** **(6 pikë)**

**a. Qytetërim** është quajtur periudha në të cilën njerëzit kaluan nga organizimi fisnor në jetën qytetare. Në këtë periudhë, ata krijuan qytetet dhe shtetet e para, shkruan ligjet, filloi të shkruhej historia etj.

**b. Tigër dhe Eufrat** janë lumenjtë, në të cilët lindi dhe u zhvillua qytetërimi i Mesopotamisë.

**c. Qytet-shtet** është një koncept që përshkruan organizimin qytetar në antikitet. Qytet-shteti përbëhej prej qytetit dhe tokave përreth tij, që vetëqeveriseshin.

**d. Hieroglife** është lloji i shkrimit që u zhvillua në qytetërimin egjiptian.

**e. Balsamim**i është një mënyrë për të ruajtur një trup pa jetë siç ishte në momentin e vdekjes. Ky lloj trupi quhet mumje.

**f. Kodi i Hamurabit** është një përmbledhje ligjesh (gjithsej 282), të hartuara nga mbreti Hamurab. Ato u shkruajtën në pllaka argjili.

**2. Plotësoni fjalinë.** **(4 pikë)**

**a.** Monumentet më të rëndësishme janë piramidat, të ndërtuara nga faraonët egjiptianë, rreth 5 mijë vjet më parë.

**b.** Monumenti më i rëndësishëm i qytetërimit romak është Koloseu ose amfiteatri i Romës.

**3. Plotësoni tabelën.** **(6 pikë)**

| | **Vendi ku lindi dhe u zhvillua** | **Koha** | **Arritjet më të rëndësishme** | **Figura historike që kanë dhënë kontribut** |
|---|---|---|---|---|
| **Mesopotamisë** | Pranë lumenjve Tigër dhe Eufrat | 3000 vjet p.e.s | **1.** Shkrimi kuneiform<br>**2.** Kanë përdorur për herë të parë rrotën.<br>**3.** Zbuluan matematikën dhe gjeometrinë. | Hamurabi -Babiloni |
| **Qytetërimi egjiptian** | Pranë lumit Nil | 3400 vjet p.e.s-30 p.e.s | **1.** Shkrimi me hieroglife<br>**2.** Piramidat<br>**3.** Balsamosja | Faraoni në krye të shoqërisë |

**4. Ndërtoni piramidën e shoqërisë egjiptiane.** **(4 pikë)**




**5. Renditni disa prej fiseve ilire që krijuan mbretëri. Evidentoni shtrirjen gjeografike të mbretërive dhe mbretërit e tyre.** **(5 pikë)**

Fise të caktura ilire krijuan mbretëri. Të tillë ishin: fisi i enkelejve, taulantëve, ardianëve, molosëve etj. Fiset ilire që krijuan mbretëri qeveriseshin nga mbretër. Të tillë përmendim: Bardhylin, Pirron e Epirit, Agronin, Teutën, Gentin etj.

| **Pyetje** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pikë** | 6 | 4 | 6 | 4 | 5 |

| **Nota** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |

**Test 3 – Çelësi i përgjigjeve**

**Grupi B**

**1. Përkufizoni konceptet kyçe.** **(6 pikë)**

**a. Faraoni** është drejtuesi më i lartë i shoqërisë egjiptiane.

**b. Shkrimi kuneiform** është shkrimi që u shpik dhe u përdor në Mesopotami.

**c. Koloseu** është monumenti më i rëndësishëm i qytetërimit romak.

**d. Tuma** është mënyrë varrimi e njerëzve në territorin ilir në kodër, prandaj ku vend është quajtur kodërvarre tumulare.

**e. Monumenti i kulturës** është një ndërtesë, objekt apo vend me rëndësi historike.

**f. Kalendari** është mënyra e llogaritjes së ditëve, javëve, muajve dhe viteve për të organizuar veprimtaritë e përditshme.

**2. Plotësoni fjalinë.** **(3 pikë)**

**a.** Monumentet më të rëndësishme janë piramidat, të ndërtuara nga faraonët egjiptianë rreth 5 mijë vjet më parë.

**b.** Muri i Madh Kinez filloi të ndërtohej në shek. VII p.e.s. për të mbrojtur vendin nga pushtimet.

**c.** Hamurabi, mbret i Babilonisë, është i njohur në histori për hartimin e Kodit të Hamurabit. Kodi përbëhej nga 282 ligje, të gdhendura në pllaka argjili.

**3. Plotësoni tabelën.** **(6 pikë)**

| | **Vendi ku lindi dhe u zhvillua** | **Arritjet më të rëndësishme** | **Figura historike që kanë dhënë kontribut** |
|---|---|---|---|
| **Qytetërimi antik grek** | Pranë brigjeve të Detit Mesdhe | Grekët qenë të parët që shpjeguan në mënyrë shkencore dukuritë natyrore si: rrufenë, tërmetet etj.<br>Parthenoni i Greqisë antike | Pitagora, Herodoti |
| **Qytetërimi antik romak** | Pranë brigjeve të Detit Mesdhe | Koloseu i Romës | Ciceroni, Virgjili<br>Oktavian Augusti |

**4. Listoni veçoritë e qytetërimeve më të hershme.** **(5 pikë)**

**1.** Në krijimin dhe zhvillimin e qytetërimeve antike kanë ndikuar faktorë si: klima, pjelloria e tokës, vendndodhja pranë lumenjve dhe liqeneve.

**2.** Shoqëritë antike ndërtuan qytete dhe shpikën format e shkrimit.

**3.** Secili qytetërim kishte stilin e vet të zhvillimit të artit, ndërtimit të monumenteve.

**4.** Qytetërimet antike nuk u zhvilluan pa ndërprerje.

**5.** Qytetërimet lindën dhe u zhvilluan në kohë të ndryshme.

**5. Argumentoni rëndësinë që kishte arsimimi dhe edukimi i fëmijëve në qytetërimin Ilir. (5 pikë)**

Arsimimi dhe edukimi i fëmijëve bëhej në qytete, si: në Apoloni, Butrint, Dyrrah, Skodër, Bylis etj. Edukimin e parë fëmijët e merrnin në familje. Në moshën 7-vjeçare shkonin në shkollë. Ata mësonin të shkruanin dhe të lexonin në tabela të vogla prej druri të lyera me dyllë. Për penë përdorej kocka me majë të hollë. Në moshën 15 vjeç shkonin në gjimnaz.

| **Pyetje** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Pikë** | 6 | 3 | 6 | 5 | 5 |

| **Nota** | **4** | **5** | **6** | **7** | **8** | **9** | **10** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikët** | 0-4 | 5-8 | 9-12 | 13-16 | 17-20 | 21-23 | 24-25 |